

**PROGRAMI I PUNËS SË QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË VERIUT (2024-2028)**

Mandator

prof.dr. Hristijan Mickoski

qershor, 2024

HYRJE

Bazuar në vullnetin e shprehur fuqishëm të qytetarëve të Maqedonisë në Zgjedhjet Parlamentare të vitit 2024, qëllimi kryesor strategjik i Qeverisë së ardhshme është që Maqedonia të jetë anëtare e plotfuqishme e Bashkimit Evropian.

Në kushtet e sfidave historike dhe zhgënjimit të gjerë, qytetarët e Maqedonisë shprehën pa mëdyshje dëshirën e tyre të madhe për ndryshim dhe na besuan mandatin për ta drejtuar kombin tonë drejt një të ardhmeje më të ndritur.

Ky Program i Punës i Qeverisë, që përfshin periudhën 2024-2028, është një udhërrëfyes gjithëpërfshirës i krijuar për t'iu përgjigjur çështjeve më urgjente dhe për të ofruar përmirësime të prekshme në jetën e qytetarëve tanë.

Krijojmë një Qeveri e cila është e përkushtuar që Maqedoninë ta kthejë në vendin e duhur si një demokraci e begatë, e drejtë dhe dinamike.

Qëllimi ynë kryesor është të rivendosim besimin në institucionet e qeverisjes shtetërore, të eliminojmë korrupsionin dhe të sigurojmë sundimin e së drejtës.

Po fillojmë të realizojmë vizionin tonë për Maqedoninë, i cili është sërish në duart e popullit, ku çdo qytetar ka mundësi të përparojë dhe të jetojë një jetë dinjitoze.

Në qendër të misionit tonë jetësor është ringjallja ekonomike e vendit tonë. Do të fillojmë një cikël të ri të fortë të rritjes ekonomike, të nxitur nga financat publike të qëndrueshme, mbështetja për një sektor privat konkurrues dhe investime të rëndësishme në inovacionet dhe teknologjinë e informacionit. Qëllimi ynë është të krijojmë vende pune produktive dhe mirë të paguara, të ulim papunësinë dhe të nxisim një mjedis ku bizneset mund të lulëzojnë. Përmes investimeve strategjike në infrastrukturë dhe energjetikë, do të përmirësojmë cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve të Maqedonisë dhe do të sigurojmë zhvillim të qëndrueshëm.

Arsimi dhe shëndetësia janë në qendër të agjendës sonë. Do të zbatojmë reforma për të përmirësuar cilësinë dhe disponueshmërinë e arsimit, duke përgatitur qytetarët për sfidat e botës bashkëkohore. Sistemi ynë shëndetësor do të forcohet për të ofruar kujdes të sigurt dhe cilësor për çdo qytetar. Ne do të përqendrohemi gjithashtu në kohezionin social, mbështetjen e familjeve, promovimin e mundësive të barabarta dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të gjithë individëve.

Përkushtimi ynë për integrimin evropian mbetet i fortë. Do të punojmë me zell për të harmonizuar politikat tona me standardet evropiane, duke çuar përpara synimin tonë për anëtarësim të plotfuqishëm në Bashkimin Evropian. Kjo qasje do të sjell stabilitet, rritje ekonomike dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, duke siguruar një të ardhme më të mirë për Maqedoninë.

Kultura dhe turizmi kanë rëndësi qenësore për identitetin tonë nacional dhe prosperitetin ekonomik. Do të investojmë në zhvillimin e infrastrukturës kulturore, do të mbështesim artin dhe do të promovojmë trashëgiminë e pasur të Maqedonisë, si në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Duke përmirësuar ofertat tona turistike dhe duke përmirësuar përvojën e vizitorëve, ne do të tërheqim më shumë turistë, do të forcojmë ekonomitë lokale dhe do të shfaqim bukurinë dhe diversitetin e vendit tonë.

Zhvillimi i sportit është vendimtar për nxitjen e krenarisë nacionale dhe promovimin e një mënyre jetese të shëndetshme. Qeveria jonë do të investojë në objekte sportive, do të mbështesë sportistët dhe do të inkurajojë pjesëmarrjen në aktivitete fizike të të gjitha grupmoshave. Sporti do të jetë një element kyç në ndërtimin e frymës së komunitetit dhe ofrimin e mundësive për të rinjtë tanë.

Të rinjtë janë e ardhmja e Maqedonisë dhe ne jemi të përkushtuar në krijimin e një mjedisi ku ata mund të përparojnë. Do të krijojmë mundësi për arsim, punësim dhe ndërmarrësi, duke siguruar që të rinjtë të kenë aftësitë dhe mbështetjen që u nevojiten për të pasur sukses në këtë botë të globalizuar që ndryshon me shpejtësi. Me përfshirjen e të rinjëve dhe me inkorporimin e perspektivave të tyre në politikëbërje, do të ndërtojmë një shoqëri më gjithëpërfshirëse dhe më dinamike.

Kujdesi për pensionistët tanë është prioritet. Ne do të sigurojmë që ata që kanë kontribuar në shoqërinë tonë gjatë jetës së tyre të fitojnë mbështetjen dhe dinjitetin që meritojnë në vitet e tyre të mëvonshme. Kjo përfshin rritjen e pensioneve, përmirësimin e shërbimeve shëndetësore dhe ofrimin e programeve sociale që përmirësojnë cilësinë e jetës së qytetarëve tanë të moshuar.

Ndërtimi i marrëdhënieve të mira me fqinjët tanë ka rëndësi thelbësore për stabilitetin dhe prosperitetin rajonal. Ne jemi të përkushtuar për të kultivuar marrëdhënie pozitive dhe konstruktive me të gjitha vendet fqinje, bazuar në respektin dhe bashkëpunimin reciprok. Nëpërmjet përpjekjeve diplomatike dhe nismave rajonale, do të punojmë për të zgjidhur mosmarrveshjet, për të përmirësuar tregtinë dhe për të avancuar shkëmbimin kulturor.

Zhvillimi i marrëdhënieve ndëretnike është pjesë themelore e vizionit tonë për Maqedoninë, i cili është sërish në duart e popullit. Ne do të promovojmë politika që nxisin mirëkuptimin, respektin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjitha grupeve etnike. Duke

festuar diversitetin tonë dhe duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë, do të ndërtojmë një shoqëri më të fortë dhe më kohezive.

Në çdo aspekt të qeverisjes sonë, transparenca dhe llogaridhënia do të jenë më të rëndësishme. Do të sigurojmë që mjetet publike të përdoren në mënyrë efikase dhe përfitimet e politikave tona ti ndejnë të gjithë qytetarët. Duke pranuar transformimin digjital dhe qasjet inovative, do të modernizojmë shërbimet publike dhe do t'i bëjmë ato më të qasshme.

Të nderuar qytetarë të Maqedonisë,

Ky program pune nuk është vetëm një plan, por një premtim personal dhe një fjalë e dhënë. Ai pasqyron vizionin strategjik të pushtetit të ri politik dhe aspiratat kolektive të kombit tonë krenar.

Angazhimi ynë është që ta transformojmë Maqedoninë në një komb ku do të dëgjohet zëri i çdo qytetari dhe do të realizohet potenciali i tij.

Së bashku do ta kthejmë shtetin nga ata që e tradhtuan besimin e popullit.

Do të vazhdojmë përpara me krenari dhe vendosmëri, duke rindërtuar Maqedoninë e cila është sërish e juaja – një Maqedoni ku transparenca dhe llogaridhënia nuk janë thjesht ideale, por realitet.

Fuqia e ndryshimit është në duart tuaja.

Me mbështetjen tuaj do ta bëjmë Maqedoninë vend të prosperitetit, drejtësisë dhe shpresës për të gjithë. Shtetin t'ia kthejmë popullit. Maqedonia për ty, për çdonjërin prej jush.

Me respekt,

prof.dr. Hristijan Mickovski

PROGRAMI I PUNËS SË QEVERISË 2024-2028

I STANDARD I CILËSISË TË JETËS – CIKLI I RI I RRRITJES EKONOMIKE .. 7

o FINANCAT PUBLIKE TË QËNDRUESHME	7
o MBËSHTETJE PËR SEKTORIN PRIVAT KONKURRUES	11
o MBËSHTETJE PËR INOVACIONET DHE SEKTORIN E TIK-ut	15
o VENDE PUNE PRODUKTIVE DHE TË PAGUARA MIRË	18
o PLANI NACIONAL PËR DEMOGRAFI	19
o SEKTORI ENERGETIK NË SHËRBIM TË MAQEDONISË	22
o BUJQËSIA E ZHVILLUAR	26
o INFRASTRUKTURA E ZHVILLUAR DHE FUNKSIONALE	30
II FRONT KUNDËR KORRUPSIONIT	34
o REFORMA E SISTEMIT GJYQËSOR	34
o LUFTA SISTEMIKE KUNDËR KORRUPSIONIT	39
III SUNDIMI I SË DREJTËS NË INSTITUCIONET	41
o REFORMAT NË SISTEMIN POLITIK	41
o SMART MAQEDONIA – SHËRBIMET PUBLIKE TË DISPONUESHME	42
o REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE	43
o VETËQEVERISJE VENDORE TË ZHVILLUARA DHE ZHVILLIM I BALANCUR RAJONAL	44
IV SISTEMI INSTITUCIONAL FUNKSIONAL	45
o SISTEMI SHËNDETËSOR CILËSOR	45
o EDUKIMI PËR TË ARDHMEN	49
o MJEDISI I PASTËR JETËSOR	53
o KUJDESI SOCIAL	55
o KUJDESI I DEDIKUAR PËR PENSIONISTËT	56
V PRIORITETET NACIONALE	57
o PRIORITETET NË POLITIKËN E JASHTME	57
o SIGURIA DHE MBROJTJA	61

o KULTURA - SHTYLLA E SHTETIT	66
o KULTURA - SHTYLLA E SHTETIT	66
o TURIZMI I ZHVILLUAR	69
o SPORTI: KRENARI NACIONALE	70
VI TË DREJTAT DHE LIRITË	72
o GRUAJA NË QENDËR TË SHOQËRISË MAQEDONASE	72
o TË RINJT NË FOKUS	73
o TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIE E QEVERISË	75
o MEDIAT E LIRA DHE E PAVARURA	75
o MBËSHTETJA E SEKTORIT CIVIL	77

I STANDARD I CILËSISË TË JETËS – CIKËL I RI I RRIJTJES EKONOMIKE

o FINANCA PUBLIKE TË QËNDRUESHME

Synimi prioritar i Qeverisë, në periudhën 2024 - 2028, do të jetë krijimi i parakushteve për një cikël të ri të rritjes ekonomike. Ai do të bazohet në nxitjen e lirisë ekonomike të

investitorëve me anë të krijimit të kushteve të drejta për të gjitha subjektet afariste. Realizimi i një sasive të madhe investimesh kapitale publike, aktiviteti investues më i fuqishëm dhe i mbështetur financiarisht i kompanive prodhuese vendase, hyrja e kompanive të huaja dhe stabilizimi i mjedisit të jashtëm do të jenë nxitësit kryesorë të rritjes ekonomike. Nëse nuk ndodhin ndërprerje të paparashikuara politike dhe ekonomike në nivel global dhe rajonal, ekzistojnë kushte që nga viti 2025 që rritja e PBB-së të shkojë nga 3.0% në 5.0%.

Politika fiskale në periudhën 2024 - 2028 do të orientohet drejt kthimit të stabilitetit makroekonomik dhe mbështetjen e aktivitetit ekonomik nëpërmjet konsolidimit gradual fiskal, përmirësimit të menaxhimit të financave publike dhe mbajtjes së një niveli të lartë të shpenzimeve kapitale. Politika fiskale aktive dhe e përgjegjshme do të jetë në funksion të rritjes ekonomike në një nivel të arsyeshëm dhe të qëndrueshëm deficitit dhe borxhi. Të vetëdijshëm për barrën e rëndë fiskale dhe dëmtimin e qëndrueshmërisë fiskale nga Qeveria e mëparshme (borxhi publik në fund të vitit 2023 arriti një rekord 62.1% të PBB-së, dhe në pesë vitet e ardhshme ne kemi mbetur me pagesa të mëdha vetëm me interes prej 1.8 miliardë euro), në periudhën e ardhshme Qeveria do të marrë masa për konsolidim fiskal për ta rikthyer vendin në rrugën e një niveli të moderuar të borxhit.

Planifikohet një reduktim gradual i deficitit buxhetor në një nivel nën 3.0% të PBB-së. Do të ndërlihet me investime më të larta kapitale për projekte infrastrukturore, në radhë të parë për ndërtimin e infrastrukturës transportuese dhe komunale, investime në kapacitete energjetike dhe investime në infrastrukturën arsimore dhe shëndetësore.

Qeveria, gjatë mosekzistencës të goditjeve të jashtme shtesë, pret që norma mesatare e inflacionit të jetë 2.0% - 2.5% në vit në periudhën 2025 - 2028. Qeveria do të respektojë pavarësinë e Bankës Popullore, me pritshmëri që me masa dhe aktivitete në kohë të mbaj inflacionin e ulët, stabilitetin e kursit të këmbimit dhe do të kujdeset për një sektor financiar efikas.

Përsheptimi i pritshëm i rritjes ekonomike, i punësimit dhe i pagave, si dhe ambienti më i qëndrueshëm i jashtëm dhe i brendshëm, do të kontribuojnë në përsheptimin e rritjes së bazës së depozitave dhe mbështetjen e kredisë për kompanitë.

Qëllimi i Qeverisë është që deri në vitin 2028 të ulë nivelin e papunësisë në 7.5%. Kjo do të thotë se në katër vitet e ardhshme në Republikën e Maqedonisë do të krijohen rreth 55 mijë vende të reja pune. Papunësia do të ulët nëpërmjet arritjes së rritjes së lartë ekonomike; ruajtja e klimës së biznesit në një nivel ndër më të mirat në botë, e cila do të jep mbështetje të drejtpërdrejtë për kompanitë vendase për investime të reja dhe hapjen e vendeve të reja të punës; tërheqjen e investimeve të reja të huaja direkte; politikat dhe masat aktive përmes Agjencisë së Punësimit; mbështetje e rritur dhe e synuar për rendimente më të larta në

bujqësi; mbështetjen e mëtejshme të ndërtimit dhe aktiviteteve të ndërlidhura përmes një sasive më të madhe të investimeve kapitale; modernizimi i arsimit për të krijuar një fuqi punëtore më konkurruese.

Qëllimi primar dhe prioriteti i Qeverisë në periudhën 2024-2028 është ngritja e standardit jetësor të qytetarëve në Maqedoni. Për të arritur këtë qëllim, është e nevojshme të forcohet arkëtimi i të ardhurave, të përmirësohet efikasiteti i shpenzimit të parave publike, të zvogëlohet në zero korrupsioni në prokurimet publike, të zbatohen projekte të rëndësishme infrastrukturore dhe të kujdesemi për brezat e ardhshëm duke siguruar qëndrueshmërinë e borxhit publik. Me qëllim që një shkallë të lartë të realizimit të projekteve të mëdha infrastrukturore, është i nevojshëm planifikimi strategjik i tyre i lidhur me buxhetimin.

Në periudhën në vijim, një nga aktivitetet kryesore të Qeverisë do të orientohet drejt reduktimit të ekonomisë gri dhe rritjen e arkëtimit të mjeteve për buxhetin e shtetit. Rritja e bazës tatimore duke integruar grinë në ekonominë zyrtare do të mundësojë grumbullimin e më shumë të ardhurave në buxhet. Kjo do të mundësojë mbajtjen e normave të ulëta tatimore për taksat e tjera, dhe në të njëjtën kohë një sasi më të madhe të mjeteve për investime kapitale, lirime tatimore, subvencione dhe stimuj për funksionimin e sektorit privat vendas dhe qytetarëve.

Shpërndarja e fondeve buxhetore është po aq e rëndësishme. Përkundrajt shpenzimit joefikas të parasë publike, shkallës së lartë të korrupsionit në furnizimet publike dhe realizimit të ulët të shpenzimeve kapitale për projekte infrastrukturore në periudhën e kaluar, Qeveria obligohet për çrrënjosjen e korrupsionit në furnizimet publike dhe përmirësimin e dukshëm të efikasitetit dhe përshtatshmërisë në shpenzimin e parasë publike, me fokus kryesor realizimin e shpenzimeve kapitale.

Cilësia e shërbimeve publike duhet të përmirësohet. Për këtë qëllim, Qeveria do të bëjë digjitalizimin e plotë të shërbimeve të sektorit publik. Qeveria obligohet të ndërmarë aktivitete që synojnë rishikimin dhe racionalizimin e rregullimit të organeve të administratës shtetërore, me mundësinë e bashkimit ose shfuqizimit të organeve të caktuara shtetërore.

Për të përmirësuar standardin e jetesës së punonjësve arsimorë, shëndetësorë, kulturorë dhe socialë, punonjësve të drejtësisë, policisë dhe ushtrisë dhe të gjithë punësuarve në administratën publike, është planifikuar rritja e pagave me rritjen e ekonomisë. Qeveria do të kujdeset veçanërisht për prindërit e vetëm, familjet me shumë fëmijë, personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët. Ndihma sociale do të vazhdojë të rritet. Për pensionistët do të sigurojmë 5000 denarë më shumë për pensionet në vitin e parë

të mandatit. Me këtë do të kontribuojmë për një jetë më të mirë dhe më cilësore për qytetarët më të moshuar.

Qeveria është e përkushtuar të krijojë një mjedis të parashikueshëm tatimor dhe rregullator si një nga parakushtet më të rëndësishme për të bërë biznes. Gjithëpërfshirës do të jetë procesi i ndryshimeve rregullatore në të gjitha fushat e rëndësishme për funksionimin e biznesit dhe qytetarëve. Ne do të krijojmë një platformë për dialog publik-privat.

Qeveria do të sigurojë që Maqedonia të jetë ndër vendet me taksat më të ulëta për kompanitë dhe qytetarët. Kjo do të arrihet nëpërmjet: mbajtjes së taksës së sheshtë; tatimi mbi të ardhurat personale prej 10% nuk do të rritet; për të rinjtë e sapopunësuar deri në 29 vjeç parashikohet përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale; lehtësime tatimore në kuadër të tatimit mbi të ardhurat personale për freelancerat; ngritja e kufirit për regjistrim të TVSH-së nga dy në tre milionë denarë për qarkullim të konsoliduar të obligacioneve pronësore; parashihet një rimbursim i plotë i tatimit mbi të ardhurat personale për çdo grua të punësuar me një të porsalindur; tatimi mbi fitimin mbetet në masën 10%; fitimi i riinvestuar ende nuk do të tatohet; për të tërhequr kompanitë shumëkombëshe që kanë një fitim neto të lartë mbi 50 milionë euro, norma efektive e tatimit mbi fitimin do të jetë 5%. Parashikojmë kthimin e përfitimet tatimore për kompanitë (shpenzim i njohur) për shpërblimet e paguara për sigurimin vullnetar të jetës me qëllim mbajtjen dhe motivimin e punonjësve. Tarifat doganore gradualisht do të harmonizohen me tarifat doganore të BE-së. Tarifa doganore do të rishikohet, duke iu përshtatur nevojave për eksport-import të ekonomisë dhe shtetit. Do të bëhet revizion të Tarifës Doganore, përshtatur nevojave për eksport-import të ekonomisë dhe të shtetit.

Investimet kapitale janë faktori kyç për përmirësimin e konkurrencës së ekonomisë dhe cilësisë së jetës së qytetarëve. Qeveria në periudhën e ardhshme angazhohet për: investime kapitale ekskluzivisht për projekte produktive: projekte infrastrukturore dhe energjetike që do të jenë në funksion të sektorit afarist, dhe projekte kapitale nga infrastruktura komunale dhe të tjera lokale për përmirësimin e kushteve të përgjithshme të jetesës së qytetarëve të Maqedonisë ; një shumë e shtuar e investimeve kapitale prej të paktën 3 miliardë euro me një strukturë të përmirësuar dukshëm; shuma vjetore e transfertave kapitale deri në 250 milionë euro për komunitat, gjithsej 1 miliard euro gjatë mandatit; planifikimi strategjik i projekteve të mëdha të infrastrukturës të lidhura me buxhetimin.

Qeveria në periudhën gjatë këtij mandati do të fokusohet edhe në revizionit të sistemit të shpërndarjes së transfertave nga buxheti qendror për komunitat. Transferet nga buxheti qendror do të ndërlidhen me efikasitetin në mbledhjen e të hyrave burimore. Lidhja

e transfereve buxhetore me suksesin e komunave në mbledhjen e të hyrave burimore, do të nënkuptojë tatim të drejtë dhe transferim të mjeteve buxhetore deri te komunat.

Vizioni i Qeverisë është krijimi i një mjedisi më të mirë për tatimpaguesit dhe obliguesit tatimorë, bazuar në drejtësi, bashkëpunim, transparencë dhe besim të forcuar. Me transformimin digjital, qasjet inovative dhe aplikimin e teknologjive të reja, DAP do të mobilizojë të ardhurat nga taksat, të cilat janë një burim kyç i financave publike.

Gjithashtu do të vendosim një mekanizëm për kontrollin e pavarur dhe objektiv të zbatimit të rregullores tatimore në kontrolle specifike tatimore dhe procedura të tjera tatimore. Me këtë do të sigurojmë një marrëdhënie të drejt, siguri për tatimpaguesit, parandalimin e subjektivizmit në vendimmarrjen e inspektorëve tatimorë dhe uljen e mosmarrëveshjeve që zgjidhen në procese gjyqësore. Do të vendosim më shumë fleksibilitet për pagimin e borxhit tatimore të prapambetur, veçanërisht për tatimpaguesit me të ardhura të ulëta. Për më tepër, ne do të ridizajnojmë procedurën e rikthimit të TVSH-së dhe do të japim statusin e "kartonit jeshil" për një procedurë të thjeshtuar të rikthimit të TVSH-së. Në këtë mënyrë, procedura e rikthimit të TVSH-së do të jetë e shpejtë dhe efikase për tatimpaguesit që plotësojnë kriteret e besimit tatimor. Me këtë masë do të parandalojmë mashtrimet tatimore dhe do të sigurojmë siguri dhe objektivitet për tatimpaguesit.

Parashikohen aktivitete në drejtim të: krijimit të një sistemi të ri elektronik të integruar në DAP, të kompatibil me sistemet elektronike të institucioneve të tjera shtetërore; vendosja e mjeteve pa kontakt dhe qasje inovative për të kontaktuar tatimpaguesit; lëshimi elektronik i certifikatave dhe faturave dhe dokumenteve të tjera tatimore; një mënyrë e organizuar e informimit dhe komunikimit me grupet e synuara të tatimpaguesve për të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore; aranzhim bashkëpunuese me taksapaguesit e mëdhenj; listën e klasifikimit të tatimpaguesve me shpallje publike; vendosja e rregullores dhe procedurës për dhënien e licencës për inspektor tatimor. Parashikohet edhe vendosja e një faturë elektronike (E-invoice), e cila do të përshpejtojë punën ndërmjet subjekteve nga sektori privat dhe publik nëpërmjet sistemit elektronik të DAP.

Sa i përket modernizimit të Doganës, prioritet do të jetë digjitalizimi i Drejtorisë doganore, vendosja e shërbimeve të reja elektronike si dorëzimi elektronik dhe lëshimi i dokumenteve që aktualisht dorëzohen fizikisht dhe lëshohen në sportelet e Drejtorisë doganore. Ne do të punojmë për akreditimin e laboratorit doganor bazuar në shembujt e vendeve më moderne evropiane.

○ MBËSHTETJE PËR SEKTORIN PRIVAT KONKURRUES

Përmirësimi i kushteve për zhvillimin e një biznesi konkurrues dhe reformat lidhur me uljen e barrës administrative do të jenë në fokus të politikave të Qeverisë për krijimin e një klime të favorshme ekonomike për kompanitë.

Qeveria do të përkushtohet për një koncept zhvillimi të bazuar në industrializimin modern dhe përmirësimin e performancës eksportuese të kompanive, me anë të rritjes të numrit të produkteve të eksportit që kanë një nivel më të lartë të vlerës së shtuar, rritjen e numrit të kompanive eksportuese dhe numrin e tregjeve të eksportit.

Për këtë qëllim, mbështeten sistematikisht kapacitetet prodhuese vendase në përpjekjet për prodhimin, tekniko-teknologjik si dhe rikostruimin kadrovik – organizativ, me synimin për të ndërtuar konkurrencë më të madhe për hyrjen në tregjet botërore dhe mundësi më të mëdha për integrim në zinxhirët e furnizimit nacional, rajonal dhe global.

Njëkohësisht do të avancohet modeli i tërheqjes së investimeve të huaja, për të garantuar objektivitet në kriteret e përzgjedhjes së kompanive të besueshme, sukses të investimeve, vlerë më të madhe të shtuar, efekte më të mëdha për ekonominë vendase dhe krijimi i vendeve të punës me pagesë të lartë.

Reforma e rregullores ligjore do të përgatitet dhe zbatohet në bashkëpunim me sektorin privat dhe synimi i saj do të jetë reduktimi i barrierave ligjore, ligjeve të panevojshme, akteve nënligjore, rregullave dhe procedurave që vështirësojnë të udhëheqin biznes dhe i rrisin shpenzimet. Gjithashtu, parashikojmë heqjen e një numri të madh të detyrimeve parafiskale që rëndojnë kompanitë.

Për këto arsye, objektivat e programit për të mbështetur sektorin konkurrues privat të Qeverisë janë: norma më të larta të rritjes ekonomike të ekonomisë së përgjithshme; standard më i mirë i jetesës për qytetarët maqedonas; nivel më i lartë i produktivitetit të punëtorëve dhe zhvillimit teknologjik; krijimi i vendeve të reja të punës me pagesë të lartë, si dhe një standard më i mirë i punëtorëve; kthimi i ekonomisë si temë në fokus të gjithë shoqërisë; rritja e investimeve vendase dhe të huaja dhe rritja e eksporteve.

Krijimi i kushteve për konkurrencë më të lartë të sektorit privat vendas do të jetë në fokus të Qeverisë. Misioni ynë është të nxisim rritjen e investimeve private vendase nëpërmjet: taksimi i kompanive me norma të ulëta tatimore; mjedisi i parashikueshëm tatimor; sigurimi i mjeteve të favorshme financiare për investime në kapacitetet prodhuese; uljen e shpenzimeve nga tarifat parafiskale; sigurimi i një cilësie më të lartë të shërbimeve publike me theks në digjitalizimin; një gijotinë rregullatore për uljen e burokracisë; mbajtjen e punëtorëve në vend dhe përmirësimin e cilësisë së njohurive dhe aftësive të tyre; luftën kundër ekonomisë gri dhe përmirësimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë.

Qeveria në periudhën e ardhshme do të vazhdojë me mbështetjen financiare të investimeve për kompanitë vendase dhe të huaja, e cila është e rregulluar në Ligjin për mbështetjen financiare të investimeve. Ne planifikojmë të rishikojmë procedurën dhe kushtet për marrjen e saj, në drejtim të një mbështetje më të madhe për kompanitë vendase eksportuese dhe kompanitë nga sektorët me avantazh konkurrues.

Do të vendoset një regjistër i vetëm i ndihmës shtetërore të dhënë, për të parandaluar abuzimin e instrumenteve të mbështetjes financiare dhe përdorimin e dyfishtë të tyre.

Qeveria obligohet me qëllim që të nxisë një rritje të qëndrueshme të eksportit, përkaj përmissimit të infrastrukturës transportuese dhe energjetik, në reforma në politikën tregtare përmes:

riorganizimit dhe digjitalizimit të procedurave kufitare dhe forcimi i bashkërendimit ndërinstitucional për të reduktuar vonesat e zhdoganimit dhe shpenzimet e panevojshme tregtare me partnerët kryesorë tregtarë; krijimin e programeve të promovimit të eksportit duke mbështetur kompanitë e orientuara nga eksporti në procesin e ndërtimit të markave ndërkombëtare, mbështetjen e aktiviteteve të marketingut dhe pjesëmarrjen në panaire ndërkombëtare, organizimin e misioneve të blerjes dhe shitjes dhe ngjarje të tjera promovuese për kompanitë e orientuara nga eksporti; lidhja e marrëveshjeve të reja të tregtisë së lirë me qëllim rritjen e nivelit të tregtisë së lirë dhe mbulimin e një numri më të madh të produkteve që do të eksportoheshin.

Qeveria do të ndihmojë kompanitë e orientuara drejt eksportit në një vend për të marrë informacionin për dokumentacionin e nevojshëm për vendosjen e produktit në një treg të caktuar.

Në fokus të Qeverisë janë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (MVM) të cilat janë më në numër në ekonominë e vendit. Që të rritet qasja deri te financat për MVM, Qeveria do të sigurojë: Krijimin e një ekipe të re me kuadër profesional të Bankës për Zhvillim i cili do të lehtësoj qasjen e MVM-së në linjat kreditore me anë të përmissimit të planifikimit dhe raportimit të biznesit, për të cilat do të krijohen programe në bashkëpunim me shtëpi konsulente; do të rritet numri i bankave që marrin pjesë në linjat e kreditit nga BERZH, BEI dhe institucione të tjera financiare ndërkombëtare, me vendosjen e një norme interesi stimuluese (më të ulët) për bankat në varësi të sasisë së fondeve të investuara; dhe së bashku me Odat Ekonomike dhe Bankën për Zhvillim do të organizojmë forume të rregullta për menaxhmentin e mesëm të MVM-ve, me qëllim përmirësimin e cilësisë së përgatitjes së dokumentacionit të projektit dhe informimin për mundësitë ekzistuese të financimit.

Qeveria obligohet të zbatojë aktivitete të shumta për reformimin e sistemit aktual për tërheqjen e investimeve të huaja direkte nëpërmjet:

- - Krijimi i një Strategjie të reviduar për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta 2025 – 2035, si një platformë për aktivitet afatgjatë për investime të reja Greenfield dhe Brownfield, hartëzimi i industrive me fokus aktivitetet e teknologjisë së lartë, ndryshimet institucionale dhe ridizajnimi i sistemit të mbështetjes financiare;
- - Do të krijojmë një Agjenci unike për investimet dhe eksportet e huaja, përmes bashkimit dhe racionalizimit të agjencive ekzistuese. Agjencia do të ofrojë shërbime për investitorët sipas sistemit one-stop shop, si në drejtim të informacionit dhe këshillimit, ashtu edhe pas investimit, si aftercare.

- Mbështetja financiare do të bazohet në kritere objektive;
- Do të ofrojmë mbështetje të plotë infrastrukturore dhe logjistike në zonat industriale;
- Do të rinovojmë brendimin e Maqedonisë si destinacion i favorshëm për investime dhe do të ofrojmë promovim në mbarë botën;
- Me rastin e miratimit të një rregulloreje të re do të konsultohen investitorët e huaj dhe të gjitha odat përkatëse;
- Kriteret objektive dhe procedurat e parashikueshme për dhënien e lejeve të qëndrimit dhe punës për menaxhmentin e lartë, kuadrin profesional me arsim të lartë, ekspertë nga organizatat ndërkombëtare dhe pjesëtarë të diasporës maqedonase.

Detyrë e veçantë e Qeverisë do të jetë përfshirja më e lehtë e kompanive vendore në zinxhirin e furnizuesve të kompanive të huaja që kanë investuar në Maqedoni. Aktivitetet do të kontribuojnë në transferimin e teknologjive dhe know-how përmes bashkëpunimit të biznesit vendas me kompani shumëkombëshe, si dhe rritjen e punësimit.

Ekonomia gri dëmton seriozisht konkurrencën e kompanive që paguajnë rregullisht dhe në mënyrë të disiplinuar taksat, kontributet dhe të dhënat e tjera publike që financojnë të gjitha nevojat e buxhetit. Reduktimi i ekonomisë gri do të krijojë kushte të barabarta loje për kompanitë dhe konkurrencë më të madhe të tyre. Prandaj, në periudhën e ardhshme Qeveria obligohet:

- Të digjitalizojë dhe thjeshtojë regjistrimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla, si dhe regjistrimin e punëtorëve të punësuar në një afat më të shkurtër dhe sezonal, veçanërisht në veprimtaritë e tregtisë me pakicë, ndërtimtarisë dhe veprimtarive të tjera shërbimi;
- Të ngrit vetëdijen e opinionit për avantazhet e formalizimit të bizneseve dhe paraqitjen të punëtorëve për mbrojtjen më të madhe sociale të tyre dhe barazinë e të gjithëve para ligjeve;
- Të mbrojtë tregtinë elektronike nga tregtarët e paregjistruar duke ndryshuar legjislacionin dhe të garantojë pagesën e taksave.

Ne do të zbatojmë një gijotinë rregullatore për rregulloret e gjera që prekin qytetarët dhe kompanitë. Ai do të përfshijë një skanim të ligjeve dhe akteve nënligjore, procedurave dhe procedurave, me propozime për të shfuqizuar ose thjeshtuar ato që janë të panevojshme ose të gjera. Do të zbatojmë një gijotinë rregullatorë për rregullat vuliminoze që i prekin qytetarët dhe kompanitë. Ajo do të përfshijë një skanim të ligjeve dhe akteve nënligjore, procedurave dhe veprimeve, me propozime për të shfuqizuar ose thjeshtuar ato që janë të panevojshme ose vuliminoze. Për monitorimin dhe kontrollin e tarifave parafiskale, ne do të krijojmë një regjistër digjital në të cilin do të vendosen të gjitha tarifat parafiskale që paguhen në nivel qendror dhe lokal. Në kuadër të Gazetës Zyrtare do të krijohet një e-Regjistër i akteve ligjore dhe nënligjore sipas fushave. Këto mjete do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në drejtim të përmirësimit të klimës së biznesit, uljes së burokracisë dhe korrupsionit. Përmes një procesi gjithëpërfshirës presim mbështetje të madhe dhe aktive nga komuniteti i biznesit, institucionet, odat e tregtisë dhe qytetarët për zbulimin me sukses të rregulloreve problematike dhe realizimin më të mirë të këtij projekti.

Me integrimin e informacionit për të gjitha licencat dhe lejet në dispozicion të personave juridikë dhe fizikë në Maqedoni, do të inkurajohet siguria në sistemin e drejtësisë. Institucionet në procedura të ndryshme do ta marrin informacionin nga ky regjistër sipas detyrës zyrtare, në vend që ta kërkojnë atë nga palët në procedurë. Ky avantazh do të nënkuptojë edhe ndërgjegjësimin më të madh të qytetarëve dhe bashkëpunim më të madh të biznesit.

Regjistri tregtar do të lidhet plotësisht me Regjistrin qendror të popullsisë. Ndryshimet në të dhënat personale të personave fizik do të nënkuptojnë automatikisht ndryshim të të dhënave në regjistrin e kompanive. Në atë mënyrë do të zvogëlohet burokracia, përkatësisht do të zvogëlohen obligimet e raportimit, koha dhe shpenzimet për kompanitë.

Në funksion të mbrojtjes së konkurrencës do të rrisim kapacitetet administrative, personelin dhe mbështetjen buxhetore të Komisionit për mbrojtjen e konkurrencës për me qëllim avancimin e pavarësisë dhe funksionimin së saj.

Duhet të mbështetet fryma sipërmarrëse e të rinjve dhe e njerëzve me përvojë që kanë ide të reja për fillimin e një biznesi, sepse i njëjti krijon potencial për rritje ekonomike.

Qeveria obligohet për mbështetje të fuqishme për startup-et në Maqedoni përmes:

- Ndryshimet në rregulloren ligjore në drejtim të nxitjes dhe mbështetjes së nismave sipërmarrëse;
- Do të ketë qasje drejt promovimit, rishikimit dhe miratimit të rregulloreve ligjore për kapitalin formal të rrezikut (venture capital) dhe financimi i përbashkët (crowdfunding), në mënyrë që të rritet konkurrenca dhe aksesimi në financim për kompanitë fillestare;
- Objektet shtetërore që nuk janë në përdorim do të ridestinohen në ambiente biznesi që kompanitë startup do të mund t'i përdorin me një tarifë minimale.
- Do të mundësohen përfitime tatimore për të mbështetur kërkimin shkencor, kërkimin e aplikuar (industrial) dhe kërkimin eksperimental. Në kuadër të mbështetjes, si Qeveria do të ofrojë përfitime për të mbuluar shpenzimet operative dhe kapitale.

MBËSHTETJE PËR INOVACIONET DHE SEKTORIN E TIK

Krijimi i një ekonomie moderne digjitale do të jetë një nga prioritetet kryesore të Qeverisë. Afatgjatë, të planifikuar dhe sistematike - në vend të ad hoc - në bashkëpunim me komunitetin profesional, shkencor dhe sektorin joqeveritar, e veçanërisht me odat, do të punohet në krijimin dhe miratimin e politikave dhe strategjive moderne për zhvillimin e ekonomisë digjitale, sektori i TIK-ut, inteligjenca artificiale, inovacioni dhe ekosistemi startup.

Inovacionet teknologjike dhe aplikimi i teknologjive përçarëse si inteligjenca artificiale, cloud, të big data, IoT, blockchain, metaverse, VR/AR, RPA, sensorë, robotë, drone, qytete të zgjuara, 5G, ekonomia e platformës janë çelësi për transformimin e mëtejshëm të ekonomisë maqedonase - nga një ekonomi intensive e punës në një ekonomi të bazuar në njohuri.

Duke qenë se burimi kryesor i fuqisë punëtore të kualifikuar është arsimimi formal i TIK-ut, është e nevojshme të punohet në përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së "talentit teknologjik". Andaj planifikojmë të:

- - Ndryshimet në programin mësimor fillor dhe të mesëm lidhur me botën e re digjitale;

- - një modul trajnimi për nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët për të fituar aftësi digjitale të nivelit mesatar;
- Zgjerimi i kuotave të fakulteteve të TIK-ut, modernizimi i programeve, vendosja e programeve master në fushën e teknologjive përçarëse, mbështetje për prokurimin e infrastrukturës dhe zhvillimin e kompetencave;
- -Sistemi i mbështetjes me vauçer për studentët e diplomuar për të ndjekur trajnimin e certifikuar për IT në një nivel të avancuar;
- -Mbështetja e sektorit privat për trajnimin e avancuar të TIK të fuqisë punëtore;
- -Zgjerimi i vëllimit të programeve për rikualifikimin e fuqisë punëtore në fuqinë punëtore të TIK-ut;
- Trajnim me TIK të avancuar për personat e papunë - në bashkëpunim me provajderët (furnizuesit) privatë dhe universitetet shtetërore, përmes mbështetjes me vauçer;
- Trajtime për sigurinë kibernetike: në bashkëpunim me komunitetin akademik do të zhvillohen trajtime për sigurinë në internet, qëllimi i të cilave është rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve, prindërve dhe mësuesve të tyre për kërcënimet e mundshme të cenimit të privatësisë në internet.

Qeveria do të përgatisë një projekt zhvillimi dhe një studim për një park multifunksional teknologjiko-inovativ, në drejtim të tërheqjes së kompanive të teknologjisë së lartë dhe futjes dhe zhvillimit të teknologjive të reja.

Si Qeveri, ne do të ofrojmë mbështetje shtesë për ndërkombëtarizimin e kompanive vendase të TIK-ut, si dhe mbështetje për kompanitë e softuerit të orientuar drejt eksportit. Do të investojmë në konkurrencë më të madhe të produkteve dhe shërbimeve maqedonase në tregjet botërore, përmes stimulimeve shtesë dhe tatimeve lehtësuese, subvencionimit të trajnimeve dhe edukimit në fushën e teknologjive përçarëse.

Nëpërmjet financimit shtesë të shkencës së aplikuar dhe zhvillimit dhe kërkimit (R&D), ne do të ofrojmë mbështetje për hapjen e instituteve në fushën e teknologjive

përçarëse, krijimin e instrumenteve moderne dhe futjen e rregullave strikte për financimin e vetëm kompanive inovative dhe të teknologjisë së lartë. Ne do të mbështesim hapjen e parqeve teknologjike dhe programeve të inkubacionit dhe përshejtimit, duke ofruar stimuj shtesë tatimorë për të tërhequr investitorët dhe fondet e QV. Në atë mënyrë do të krijohet një mjedis i favorshëm për zhvillimin e inovacioneve maqedonase dhe krijimin e pronës intelektuale.

Qeveria do t'i japë mbështetje të fortë institucionale dhe ligjore nismave për implementimit më të madh dhe më të lehtë të teknologjive të reja në sferën financiare – fintek (FinTech). Qeveria e ardhshme do të punojë për të mundësuar funksionalitetin e plotë të platformave për transferimin elektronik të fondeve përmes internetit, që do të përfshijnë dërgimin dhe marrjen e fondeve. Do të bëhen përpjekje aktive për të mundësuar që procesorët global të pagesave të jenë të disponueshëm në Maqedoni.

Qeveria do të ofrojë mundësi ligjore për njohjen e kategorisë “freelancer”, si persona që punojnë në distancë në projekte përmes platformave digjitale, duke ndjekur shembullin e vendeve europiane që janë udhëheqës në këtë fushë. Për këta persona do të vihet në dispozicion një pako tatimore me përjashtime tatimore në varësi të shumës së të ardhurave të tyre mujore.

Parashikojmë vendosjen e një vize qëndrimi të rinovueshme për nomadët digjitalë, gjegjësisht për të huajt që dëshirojnë të kalojnë nga 3 deri në 12 muaj duke jetuar në Maqedoni, me kusht që të kenë siguruar punë në distancë me një punëdhënës të huaj dhe të ardhura të rregullta mujore.

Programet GovTech do të mbështeten për bashkëpunimin e institucioneve publike me startup-et dhe kompanitë inovative për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve në nivel qendror dhe lokal dhe zhvillimin e përgjithshëm të ekosistemit: përmbajtje online dhe aplikacione celulare, hackathone, mbështetje për pjesëmarrje në gara ndërkombëtare, Olimpiada dhe trajnime të specializuara të nxënësve dhe studentëve të talentuar, përmbajtje digjitale për fëmijë apo të rinj, aplikacione që përdorin të dhëna të hapura.

Pas rishikimit gjithëpërfshirës të funksionimit të mëparshëm të Fondit të Inovacionit, një fokus i rëndësishëm në fushën e inovacionit do të vendoset në programet për mbështetjen e sektorit të TIK-ut, zhvillimin teknologjik të kompanive vendase dhe inovacionin.

Në drejtim të mbështetjes së transformimit digjital të sektorit të biznesit, parashikohet mbështetje e fuqishme institucionale dhe financiare për: në bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë dhe sektorin privat, do të formohet një Qendër Digjitale e Inovacionit i cili në një vend do të ofrojë mbështetje për kompanitë që promovojnë përfitimet e transformimit digjital; furnizim i vendimeve dhe integrimi i tyre teknologjik;

përdorimi i teknologjive të gjelbra dhe praktikave "ekologjike"; zhvillimi i aftësive të punonjësve për aplikimin e teknologjive të reja (inteligjencë artificiale, cloud, të dhëna të mëdha, IoT, blockchain, metaverse, VR/AR, RPA, sensorë, robotë, drone, qytete inteligjente, 5G, ekonomi e platformës), punë me të dhëna , analiza dhe parashikimi i biznesit, metodologjitë e shkathëta, tregtia elektronike; dhe promovimi i inovacionit të hapur, pra bashkëpunimi me startup-et, kompanitë dhe institutet inovative.

o VENDE PUNE PRODUKTIVE DHE ME PAGESA TË LARTA

Qeveria do të punojë për rritjen e cilësisë së fuqisë punëtore përmes edukimit formal, trajnimeve të vazhdueshme, programeve për rikualifikim dhe trajnime shtesë, me qëllim rritjen e punësimit, produktivitetit dhe hapjen e vendeve të reja të punës me pagesë të lartë. Në një proces gjithëpërfshirës me përfaqësues të sektorit të biznesit, shkollave të mesme dhe fakulteteve, si dhe të gjitha institucioneve përkatëse shtetërore dhe sektorit joqeveritar, do t'i qasemi një analize gjithëpërfshirëse të tregut të punës, me qëllim zbulimin e dobësive dhe mangësive sistematike, si dhe mundësitë për modernizimin e tij.

Synimi ynë është që deri në fund të vitit 2028 të krijojmë 55,000 vende të reja pune. Nëpërmjet programeve të Agjencisë së Punësimit të orientuara drejt masave për punësimin e të rinjve, krijimin e aftësive dhe kualifikimeve, rikualifikimet dhe kualifikimet shtesë të kategorive të cenuara, trajnimet për aftësitë e nevojshme për tregun e punës, mbështetja e sipërmarrësisë, si dhe kofinancimin e trajnimeve për përdorimin e teknologjive të reja, do të sigurojmë buxhet prej 150 milionë euro.

Agjencia e Punësimit do të shndërrohet në një ndërmjetës efektiv midis punëdhënësve dhe punëtorëve. Aktivitetet e saj do të përfshijnë edhe ndërmjetësimin në punësimin, zbatimin e pakove të masave dhe shërbimeve të orientuara për të papunësuarit afatgjatë, gratë, të rinjtë, personat pa kualifikim dhe grupet e margjinalizuara. Për personat pa kualifikim që janë të papunë afatgjatë dhe personat që janë përfitues të asistencës minimale të garantuar, do t'u ofrohen programe për arsimim dhe aftësim profesional shtesë për fitimin e aftësive praktike, në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Do të bëjmë një reformë tërësore të masave aktive të tregut të punës për të arritur efektet reale. Zbatimi i këtyre masave do të jetë në një proces gjithëpërfshirës përmes ndërveprimit të komunitetit të biznesit dhe odave me Agjencinë e Punësimit. Do të reformohet edhe sistemi i ofrimit të shërbimeve të punësimit. Do të përcaktojmë numrin deficitar të vendeve të punës, për të cilat do të sigurojmë programe për rikualifikim të financuara nga shteti.

Në drejtim të përmirësimit të situatës do të parashikojmë:

- Shteti do t'u japë mundësinë personave të punësuar në sektorin publik që të gjejnë më lehtë punë në sektorin privat;

- Fleksibilitet më i madh i orarit të punës për prindërit e rinj në vitet e para të prindërimit (punë nga shtëpia, fleksibilitet në përdorimin e orarit të punës gjatë javës në përputhje me rregullimin e punës së punëdhënësit);

- Fleksibilitet më i madh i orarit të punës për ata punonjës që synojnë edukim dhe përsosje profesionale të mëtijshme;

- një periudhë prove për punonjësit e rinj ku punëdhënësit do të kishin fleksibilitetin për të vlerësuar në muajin e parë të punës;

- Do të bëjmë një ndryshim të tërësishëm të konceptit të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, i cili do të ketë në fokus parandalimin;

Do të bëjmë një klasifikim, sistemim dhe optimizmin e tërësishëm të akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën e politikës së punës dhe politikës së mbrojtjes sociale.

o PLANI NACIONAL DEMOGRAFIK

Qeveria është e obliguar që të vendosë në plan të parë zhvillimin demografik si një fushë me rëndësi vendimtare për zhvillimin ekonomik, stabilitetin e shtetit dhe sigurinë nacionale. Maqedonia po përballet me një problem në rritje të shpopullimit që është shkaktuar nga rritja natyrore afatgjatë, negative, si dhe nga numri në rritje i të rinjve dhe të arsimuarve që vendosin të largohen nga Maqedonia. Drejt kësaj, institucionalisht dhe programatikisht duhet të orientohen modelet për rinovim demografik, stimulimi për të qëndruar në Maqedoni dhe punësimi.

Për këto arsye, do të fokusohemi në mbrojtjen dhe mbështetjen e familjeve, veçanërisht atyre me disa fëmijë dhe do të adoptojmë një qasje të re ndaj të rinjve, e cila do t'u sigurojë arsim të përbalueshëm, standard të favorshëm jetese dhe dinjitet njerëzor, me qëllim të zvogëlimit të numrit të atyre që detyrohen të largohen nga Maqedonia. Një nga kushtet më të rëndësishme për përmirësimin e pasqyrës demografike të Maqedonisë është stabiliteti dhe siguria e vendeve të punës dhe mundësive të hapura të biznesit, veçanërisht për të rinjtë, me të ardhura që mund të mbulojnë shpenzimet e shportës mesatare të konsumatorit dhe shpenzimet për rritjen e fëmijëve.

E vetëdijshme për sfidat demografike me të cilat përballet Maqedonia dhe shkallës së përkeqësuar të lindshmërisë, Qeveria do të përmirësojë masat ekzistuese dhe do të vendosë masa të reja për mbështetjen e prindërve, përkatësisht:

- Mbështetjes financiare e rritur e njëfishtë për një fëmijë të parëlindur;

- Rritje drastike e mbështetjes financiare të njëfishtë për një fëmijë të dytë;

- Futja e mbështetjes financiare të njëfishtë për binjakë, të lindurit e tretë dhe çdo fëmijë të mëpasshëm të lindur.

Për nënat që janë të punësuar, ofrojmë mbështetje shtesë financiare pas përfundimit të pushimit të lehonisë, përkatësisht:

- një vit rimbursim të tatimit mbi të ardhurat personale të paguara për një fëmijë të parëlindur;

- dy vjet rimbursim të tatimit mbi të ardhurat personale të paguara për një fëmijë të lindur të dytë;

- rimbursim të tatimit mbi të ardhurat personale të paguara për të lindurit e tretë dhe çdo fëmijë pasardhës të lindur, i cili do të zgjasë deri në moshën madhore të fëmijës së parëlindur.

Për kompanitë që do të punësojnë nëna me tre ose më shumë fëmijë, ne parashikojmë lirim nga pagesa e kontributeve nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor në rast papunësie, si dhe tatimi mbi të ardhurat personale për një periudhë tre vjeçare nga dita e punësimit, me detyrimin që punëdhënësi ta mbajë nënën në vendin e punës për aq vite sa përdoret masa.

Do të vendosim mundësinë që çdo grua, pavarësisht gjendjes pronësore apo numrit të fëmijëve që ka, të bëjë deri në gjashtë fekondime in vitro falas.

Qeveria do të rivendosë dhe përmirësojë masën “Bli shtëpi për të rinjtë”, përmes: pagesës së subvencioneve me këst mujor për ndërtimin e një shtëpie ose pagesës së subvencioneve për pjesëmarrjen fillestare në marrjen e kredisë për ndërtimin e një shtëpie; për çiftet e reja që do të shpërngulen në fshat, do të përpilohet një program që do të sigurojë mbështetje financiare të njëfishtë për blerje, ndërtim ose zgjerim të një shtëpie; Parashikojmë shitjen e tokës së pandërtuar në pronësi shtetërore me një çmim preferencial për metër katror, si dhe disa lloje të projekteve pa pagesë të ndërtimit të shtëpive, që do të ulin më tej kostot e familjes dhe do të mbështesin rinovimin efikas energjetik të shtëpive të të rinjve.

Për Qeverinë do të jetë prioritet kryesor në mandat që të punojë në krijimin e kushteve për uljen e listës së pritjes për pranim në kopshtet e fëmijëve. Mungesa e kopshteve është një nga arsytet e nivelit të ulët të natalitetit dhe një rënie të theksuar të numrit të përgjithshëm të popullsisë në shtet. Për të arritur rezultate të shpejta, do të punojmë në ripërshtatjen e hapësirës së pashfrytëzuar në institucionet publike.

Zgjerimi i rrjetit të institucioneve për përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve të moshës parashkollore është prioriteti ynë, me qëllim të uljes së listës së pritjes për pranimin e fëmijëve në kopshtet për fëmijë, hapjen e bizneseve të reja dhe përfshirjen më të madhe të prindërve në tregun e punës. Ndihma financiare do të përfshijë lirim nga taksat deri në 30,000 euro për hapjen e një kopshti privat për fëmijë ose blerjen e pajisjeve, në varësi të kapacitetit të kujdesit dhe vendndodhjes.

Në mënyrë plotësuese, parashikojmë edhe shitjen e tokës ndërtimore me kushte të favorshme ose dhënie me qira të objekteve të pashfrytëzuara në pronësi shtetërore, dhe në bashkëpunim me komunitat do të parashikojmë dhe lirin nga tarifat komunale. Obligohemi të ofrojmë disa lloje projektesh të gatshme për ndërtimin e kopshteve për fëmijë me kapacitete të ndryshme, për të ulur kostot e hapjes së kopshteve të reja për fëmijë.

Shtesë e veçantë është kompensimi monetar që marrin fëmijët me aftësi të kufizuara deri në moshën 26 vjeç. Si Qeveri obligohemi që çdo vit të mandatit të rrisim tre llojet e mbështetjes për përfituesit në përputhje me rritjen e kostos së jetesës dhe në këtë mënyrë të ndihmojmë gjendjen financiare dhe kushtet e jetesës së grupeve më të rrezikuara të qytetarëve në shtetin tonë. Po fusim asistentë dhe bashkëpunëtorë profesionistë në kopshtet e fëmijëve si pjesë e procesit edukativo-arsimor që do të mundësojë pjesëmarrje aktive dhe të barabartë për të gjithë fëmijët. Në këtë mënyrë, do të ofrojmë mundësi për zhvillimin maksimal të potencialit të çdo fëmije.

Fëmijët që vihen nën kujdestari, zakonisht për shkak të vdekjes së prindërve, akomodohen në një familje të të afërmeve të tyre. Aktualisht këto familje nuk marrin asnjë kompensim. Për këto arsye, si Qeveri përgjegjëse do t'u mundësojmë këtyre familjeve të marrin kompensim për përkujdesjeje me të cilat do të mbulohen shpenzimet e fëmijëve, në lartësi të pagës minimale. Gjithashtu parashikojmë rritje të numrit të familjeve kujdestare me rritje të shtesës për një fëmijë kujdestar.

Qeveria do të përcaktojë një program sistematik dhe gjithëpërfshirës për mbështetjen e personave që do të kthehen nga jashtë. Për këtë qëllim parashikojmë:

- Kompanitë të lirohen nga pagesa e tatimit të të ardhurave personale për një periudhë prej një viti, për të gjithë personat që kanë jetuar së paku një vit jashtë vendit dhe do të kthehen të jetojnë në Maqedoni në kushte të paracaktuara;
- Nëse kthehet kuadri deficitar, i përcaktuar sipas një programi të veçantë, lirimi do të përfshijë edhe një pjesë të kontributeve të paguara nga kompanitë për personin;
- Masa për hapjen e kompanive të reja - grante dhe ndihmë për zhvillimin e biznesit të mërgimtarëve të kualifikuar që do të vendosin të hapin një kompani në Maqedoni;
- Lehtësimi i kushteve për blerjen e tokës për ndërtimin e shtëpisë tuaj;
- Lehtësimi i procedurave për marrjen e nënshtetësisë maqedonase për mërgimtarët nga Maqedonia.

Në kuadër të mbështetjes së re institucionale për përballimin e sfidave demografike do të parashikojmë mbështetje për hapjen e një instituti shkencor për kërkime demografike, migracion dhe politikë të popullsisë.

o SEKTORI ENERGETIK NË SHËRBIM TË MAQEDONISË

Vizioni i Qeverisë është një sistem energjetik ekologjik, konkurrues dhe i qëndrueshëm i cili bazohet në parimet e besueshmërisë, efikasitetit, qëndrueshmërisë dhe pavarësisë.

Parashikojmë investime serioze shumëvjeçare dhe afatgjata në infrastrukturën dhe kapacitetet energjetike që do të garantojnë stabilitetin energjetik dhe pavarësinë e shtetit, por edhe prodhimin vendor të energjisë, si garanci për konkurrencën e ekonomisë maqedonase.

Për arritjen e pavarësisë energjetike, Qeveria do të marrë masat në vijim:

- Prodhimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i energjisë elektrike;
- Rritja e shfrytëzimit të burimeve të rinovueshme të energjisë;
- Rritja e efikasitetit energjetik të ndërtesave publike dhe amvisërive;
- Gazifikimi i amvisërive, ekonomisë dhe sektorit publik në Maqedoni;
- Sistemi funksional dhe efikas i transmetimit të energjisë elektrike;
- Përmirësimi i cilësisë së sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- Zhvillimi shtesë i sistemeve të ngrohjes;
- Politikat për zhvillimin e energjetikës dhe
- Politikat për zhvillimin e kapaciteteve të minierave dhe burimeve minerale.

Qeveria do të nisë rishikimin e sistemit tarifor të furnizimit me energji elektrike dhe do të propozojë heqjen e tarifës së qasjes në rrjet.

Parashikojmë një program për grante dhe kredi të favorshme për 150 mijë amvisëri në një mandat për pronarët e shtëpive dhe apartamenteve private.

Mbështetja do t'i referohet instalimit të fasadave, dritareve dhe dyerve të reja efikase energjetike, si dhe subvencione për qytetarët deri në 50% të çmimit për blerjen dhe instalim të pajisjeve me efikasitet energjetik: kolektorë diellorë, pompa nxehtësie, si dhe termocentralet fotovoltaike (FEC) për prodhimin e energjisë elektrike për nevojat e veta.

Amvisëritë do të kenë mundësinë të shesin tepricën e energjisë elektrike të prodhuar, në kushte më të mira, duke ndryshuar rregulloren ekzistuese. Parashikojmë ndryshime në mënyrën e llogaritjes për pagesën e energjisë së tepërt të prodhuar të shitur.

Do të përgatisim dokumentacionin projektues dhe teknik për ndërrimin e derivateve dhe përdorimin e derivateve të pastra dhe teknologjive për ngrohjen e objekteve publike në Maqedoni. Gjithashtu, do të investojmë në ndryshimin e sistemeve të ngrohjes së ndërtesave publike në sisteme me emetim zero të grimcave të ngurta.

Do t'i qasemi zhvillimit të rrjeteve të shpërndarjes së gazit natyror, të cilat do të mundësojnë që gazi të jetë drejtpërdrejt në dispozicion të amvisërive, objekteve industriale, ekonomike dhe institucioneve publike. Me qëllim të përsheptimit të mëtejshëm të procesit të gazifikimit, në vendbanimet që ndodhen në një distancë më të madhe nga tubacionet kryesore të gazit do të fillojë ndërtimi i platformave të përshtatshme për gaz natyror. Me sisteme të tilla, është e mundur që gazi natyror të arrijë në rrjetet e shpërndarjes së gazit në zonat e banuara dhe të jetë i disponueshëm për këdo që dëshiron ta përdorë atë. Në kuadër të kësaj mase parashikohet subvencionimi i lidhjes me rrjetin e shpërndarjes për të siguruar gaz natyror për çdo amvisëri.

Qeveria parasheh investime në **Kombinatin** e minierave dhe energjetikës (REK) "Manastir". Me qëllim të zgjatjes së jetëgjatësisë së termocentraleve në REK "Manastir", është planifikuar hapja e minierave të reja "Zhivojno" Me sasi të reja të thëngjillit garantohe funksionimi i qëndrueshëm i REK Manastir në periudhën e ardhshme duke shfrytëzuar resurset vendore si prioritet në vend të rritjes së importeve të qymyrit nga jashtë.

Do të bëjmë rivitalizimin dhe modernizimin e REK Manastir, i cili do të japë efekte më pozitive:

- Reduktimi i emetimit dhe misionit të SO_x dhe pluhurit në vlerat kufitare sipas direktivave dhe legjislacionit evropian;

- Përmirësimi i ajrit të ambientit në afërsi të REK Manastirit dhe qytetit të Manastirit;

- Ndikimi pozitiv në ndryshimet klimatike;

- Reduktimi i zhurmës së impianteve;

- Prodhimi i gipsit dhe vendosja e mundshme e tij në treg;

- Aspektet socio-ekonomike dhe kushte më të mira për të punësuarit dhe popullatën që jeton rreth REK Manastir;

- Reduktimi i sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kostove të jashtme (zvogëlimi i mungesës në punë, rritja e shpenzimeve të barnave).

Qeveria do të shqyrtojë mundësitë që do të zgjasin jetëgjatësinë e REK Oslomej përmes modernizimit të tij. Qasja nënkupton rritjen e efikasitetit të bllokut dhe reduktimin e emetimeve të CO₂, SO_x, NO_x dhe pluhurit në përputhje me vlerat kufitare të lejuara të emetimeve në BE.

Qeveria do të planifikojë gazifikimin e REK “Negotino” dhe zgjatjen e jetëgjatësisë së kapacitetit energjetik.

Qeveria parasheh një central elektrik me standarde të larta ekologjik që do të jetë një objekt prodhues energjetik në Manastir që do të fillonte tranzicionin energjetik të REK Manastir.

Qeveria do të shqyrtojë mundësitë për financimin dhe planifikimin e një kompleksi të energjive dhe minierave në Maqedoninë Lindore.

Me aktivitet gjithëpërfshirëse, Qeveria do të realizoj projekt për ngrohje qendrore në Manastir, Mogila dhe Novaci.

Me qëllim të zvogëlimit të emetimit të gazrave të dëmshëm dhe ndotjes, është planifikuar që në rrethinën e Shkupit të ndërtohet një impiant i kogjenerimit të gazit për fitimin e energjisë elektrike dhe termike, në mënyrë që të mund të planifikohet zhvillimi i rrjetit shpërndarës të energjisë termike. Parashikojmë zgjerim të rrjetit shpërndarës për energji termike në një pjesë më të madhe të qytetit të Shkupit.

Të udhëhequr nga përvoja e publikut profesionist dhe si rezultat i të gjithë tenderëve të pasuksesshëm të deritanishëm, ne do të krijojmë një studim të ri fizibiliteti, i cili do të japë mundësinë për të optimizuar dhe përzgjedhur projektin më të mirë për përdorimin e pellgut të lumit Crna nga HEC Tikveshit në urën e Rasimbegut.

Parashikojmë ndërtimin e një tuneli për devijimin e ujërave nga lumi Vardar në lumin Treska dhe shfrytëzimin maksimal të tyre të energjisë në tre hidrocentralet Kozjak, Sv. Petka (Shën Petka) dhe Matka. Qeveria do të nisë krijimin e një konstruksioni financiar në bashkëpunim me institucionet financiare ndërkombëtare për përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe ndërtimit.

Parashikojmë ndërtimin e gjashtë hidrocentraleve të vogla përgjatë rrjedhës së lumit Zletovica, pranë digës së Knezhevës dhe dy në afërsi të komunave Probishtip dhe Kratovë.

Qeveria do të punojë në mënyrë aktive për diversifikimin e burimeve për prodhimin e energjisë elektrike, nëpërmjet:

- përfundimi i parkut me erë të Bogdancit;
- mbështetje për investime në një park të ri me erë në drejtimit drejt Shtipit, Radovishit dhe Karbincit;
- Parku me erë Miravci;
- Parku me erë në masivin malor Ilinska, Plakenska dhe Bigla;
- Qeveria në periudhën e ardhshme me dinamikë intensive do t'i qaset realizimit të këtyre projekteve të gazifikimit: ndërtimi i gazsjellësit magjstral Gostivar - Kërçovë; ndërtimi i gazsjellësit magjstral Sveti Nikolla – Veles; përgatitja e projektit për gazsjellësin kryesor Manastir – Resnjë – Ohër – Strugë; ndërtimi i degëzimit për TEC Negotinë.
- Gazsjellësi ndërlidhës me Greqinë, Serbinë dhe Kosovën.

Qeveria do të punojë për rindërtimin dhe kompletimin e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike në të gjithë shtetin për të siguruar një transmetim cilësor të energjisë elektrike.

Qeveria do të punojë në një sistem për ruajtjen e energjisë në bateri.

Do ta përmirësojmë rregulloren duke miratuar Ligjin për kërkimet gjeologjike dhe Ligjin për minierat, të cilat do të rregullojnë kërkimet gjeologjike dhe eksploatimin e lëndëve të para minerale, në përputhje me parimin e shfrytëzimit racional dhe të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit. Ne do të zhvillojmë një Strategji për shfrytëzimin e qëndrueshëm të lëndëve të para minerale, si dhe i zbatimin e kadastrës së lokaliteteve dhe të lëndëve të para minerale.

Do të rregullojmë eksploatimin e rërës nga shtretërit e lumenjve për të ruajtur qëndrueshmërinë e lumenjve dhe për të krijuar kushte të barabarta për subjektet që mirëmbajnë shtretërit e lumenjve.

Në periudhën e ardhshme, qeveria do të përpiqet të hapë miniera në afërsi të Stogovës, Tajmishtes, Plavicës (Crn Vrv) dhe Llojanit.

o BUJQËSIA E ZHVILLUAR

Në mandatin e ardhshëm katërvjeçar, Qeveria ka një plan dhe vizion për rivitalizimin e politikave bujqësore. Ne po planifikojmë reforma që në thelb do të merren për të zgjidhur çështjet dhe sfidat më thelbësore që rëndojnë bujqit. Angazhimi ynë është që duke rritur konkurrencën deri në përshtatjen e politikës bujqësore të Maqedonisë me atë të Bashkimit Evropian.

Kushtet më të mira të jetesës në zonat rurale do të sigurohen nëpërmjet masave aktive për ndalimin e procesit të shpopullimit në këto zona. Nëpërmjet një marrëdhënieje aktive të të gjithë aktorëve shoqëror dhe kryesisht të vetë bujqve, do t'u mundësojmë që të jenë në qendër të krijimit të masave dhe instrumenteve për mbështetjen e tyre. Misioni themelor i politikave tona do të jetë ndërtimi i një sektori të qëndrueshëm bujqësor dhe ushqimor që do të sigurojë të ardhura adekuata për bujqit dhe prodhim të mjaftueshëm ushqimor me çmime të përballueshme për popullatën e Maqedonisë.

Për këto arsye, fokusi ynë do të jetë në tre qëllimet kryesore:

- Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i të ardhurave të bujqit;
- Vendosja e teknologjive dhe inovacioneve të reja që do të zvogëlojnë ndikimin e ndryshimeve të pafavorshme klimatike;
- Zhvillimi i zonave rurale për të mbajtur popullsinë, veçanërisht të rinjtë, përmes investimeve në infrastrukturë dhe investimeve për vende të reja pune në këto zona.

Obligohemi për një reformë në mënyrën e ndarjes së burimeve financiare, me të cilën fokusi ynë do të jetë në ofrimin e mbështetjes që u dedikohet bujqve aktivë. Duke siguruar disa lloje të mbështetjes financiare, shumata maksimale e të cilave do të ishte deri në 180 milionë euro në vit, planifikojmë të ndikojmë në rritjen e përqindjes së programit të zhvillimit rural.

Planifikojmë të forcojmë kapacitetet për përdorimin e fondeve të para-anëtarësimit nga BE-IPARD si mjete shtesë për të mbështetur investimet dhe zhvillimin rural.

Masat e pagesës direkte do të ndihmojnë bujqit të sigurojnë një nivel të qëndrueshëm të të ardhurave.

Me qëllim që të zbatojmë plotësimin e masave të politikës së zhvillimit rural do të prezantohet një program buxhetor shumëvjeçar për zhvillimin rural, në të cilin buxheti i përgjithshëm do të përcaktohet në fillim të programit dhe do të zbatohet në vazhdimësi. Kjo

do të bëhet për një periudhë më të gjatë kohore si dhe për periudhën e IPARD-it, i cili do të arrijë përputhshmërinë e plotë në objektivat e programit nacional me instrumentin e BE-së dhe njëkohësisht do të përshpejtojë dinamikën e zhvillimit.

Me qëllim të ndërtimit të një sektori bujqësor të qëndrueshëm dhe konkurrues, me prodhues të kënaqur që fitojnë të ardhura adekuate, që do të përmirësojë cilësinë e jetës në fshatrat e Maqedonisë, politikat bujqësore do të zbatohen me masa për mbështetjen e të ardhurave dhe masat për mbështetjen e investimeve në programin e zhvillimit rural.

Pagesat direkte do të jenë masa bazë e mbështetjes së të ardhurave për bujqit. Ato do të jenë lënda e analizave të detajuara në mënyrë që fondet nga masat të arrijnë deri te bujqit aktivë dhe sektorët që kanë pësuar dëme të konsiderueshme në të kaluarën. Në drejtim të transformimit të masës dhe drejtim të zhvillimit të saj, do të bëhet një rajonalizimi i ri i prodhimit bujqësor dhe mbështetja e prodhimit të përshtatshëm sipas rajoneve. Do t'i qasemi zhvillimit të dinamikës së transformimit të masës për ta harmonizuar atë me masat e politikës së përbashkët bujqësore të BE-së, duke mbartur llogari se ky proces nuk dëmton asnjë sektor.

Fokusi do të jetë në degët tradicionale të blegtorisë, mbi të gjitha në blegtori, i dhive dhe gjedhëtarisë. Në këto degë do të rrisim ndjeshëm mbështetjen deri në 50%, me theks të veçantë në prodhimin e brojlerëve. Do të rrisim mbështetjen edhe në prodhimin e mishit, qumështit dhe vezëve.

Në prodhimin bimor do të mbajmë pagesat për sipërfaqe, duke ulur numrin e nënmasave me qëllim për tu lehtësuar bujqve procesin e aplikimit. Do të krijohen pagesa shtesë për prodhimin e dorëzuar për produkte individuale strategjike, dhe me qëllim forcimin e mëtejshëm të konkurrencës së këtyre sektorëve në këtë periudhë tranzitore.

Investimet janë kyçe për rritjen e konkurrencës dhe përmirësimin e të ardhurave të fermerëve. Synimi ynë është mbështetja intensive e projekteve investuese të ekonomive bujqësore. Me pjesëmarrjen e fondeve të pakthyeshme në masën më shumë se 50% (varësisht nga lloji i projekteve), do të mbështeten ato projekte që do të rrisin dhe modernizojnë ekonomitë bujqësore, do të vendosin standarde prodhimi, të cilat do të kontribuojnë në cilësinë e produkteve.

Me qëllim të përmirësimit të konkurrencës së prodhuesve bujqësorë në treg, dhe përmirësimit të plasmanit të produkteve bujqësore, do të ndahen mjete të konsiderueshme për investime me të cilat bujqit do t'i shtojnë vlerën produkteve primare. Gjithashtu, me këto investime do të mundësohet shtyrja e produkteve për të shmangur pikun e ofertës dhe uljet e çmimeve dhe do të kontribuojë në ruajtjen e disa përpunimeve tradicional.

Si një Qeveri përgjegjëse, ne do të fokusohemi gjithashtu në mbështetjen e futjes së teknologjive dhe inovacioneve të reja që do të reduktojnë ndikimin e ndryshimeve të pafavorshme klimatike. Për të garantuar qëndrueshmërinë e sektorit bujqësor dhe prodhimit të ushqimit, angazhimi ynë themelor është të zbatojmë rekomandimet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm të OKB-së, si dhe strategjinë e BE-së "nga ferma deri në pirun", e cila pozicionohet në zemër të "Marrëveshjes së Gjelbër". Një objektiv domethënës i strategjisë " nga ferma deri në pirun " është arritja e prodhimit bujqësor organik në një sipërfaqe prej 25% të sipërfaqes totale të punueshme.

Me qëllim të rritjes së konkurrencës së përpunimit bujqësor në drejtim të sigurimit të vendosjes së besueshme të produkteve bujqësore parësore në një kohë të ofertës së shtuar në treg, ne do të investojmë në vazhdimësi në objektet përpunuese.

Qeveria do të marrë masa për të ndihmuar rifillimin e objekteve të prodhimit të verës. Për përmirësimin e aktivitetit dhe zbatimin efikas të programeve do të miratohen zgjidhje të reja ligjore për harmonizimin e kompetencave të ndërmarrjeve të ekonomisë së ujërave dhe institucioneve të tjera nga veprimtaria. Do të bëhen përpjekje për të përmirësuar kapacitetin e inspektorëve shtetërorë të ekonomisë së ujërave.

Qeveria do të intensifikojë planin e veprimit për rikonstrukcionin ekzistues dhe ndërtimin e sistemeve të reja të ujitjes dhe infrastrukturës së ekonomisë së ujërave, në mënyrë që bujqit të përballojnë me sukses pasojat e ngrohjes globale dhe ndryshimet klimatike.

Do të bëhen plane zhvillimi për çdo hidrosistem me bilanc ujor, kultura dhe do të përcaktohen nevojat për rehabilitimin, modernizimin, digjitalizimin dhe shfaqjen hapësinore të objekteve të menaxhimit të ujit, zonave të ujitura dhe të dhënat e përdoruesve të ujit. Stacionet e pompimit do të modernizohen, do të prokurohen të reja aty ku është e nevojshme, por sistemet e informacionit të ekonomisë së ujërave do të lidhen edhe me sistemet e tjera të krijuara në Ministri.

Jemi duke planifikuar investime në infrastrukturën ekzistuese të ekonomisë së ujërave në hidrosistemet: Ujësjellësi Sveti Nikole, S.H.M. "Bregalnica" - Koçani, S.H.M. "Tikvesh" - Kavadar, S.H.M. "Likovë" - Kumanovë, S.H.M. "Turia" - Strumicë, Ekonomizimi i ujërave "Pollog" - Gostivar. Parashikojmë zbatimin e fazës së dytë dhe të tretë të Hidrosistemit "Zletovica" për ujitjen e 4500 hektarëve tokë bujqësore, si dhe zbatimin e ujëmbledhësit të lumit Plavajë afër fshatit. Podaresh, Radovishko me qëllime të shumta: furnizim me ujë, vaditje dhe shfrytëzim të energjisë.

Në luftën kundër ndryshimeve klimatike, ruajtja e drunjëve dhe pyjeve në Maqedoni është prioritet kryesor. Për këto arsye, ne do të ofrojmë një qasje të re në zhvillimin e

aktiviteteve pyjore, e cila do të sjellë futjen e teknologjive të reja të informacionit si dhe ngritjen e një sistemi modern të informacionit pyjor.

Për të mbajtur popullsinë që jeton në zonat rurale, veçanërisht të rinjtë, ne parashikojmë investime sistematike dhe strukturore në infrastrukturë dhe vende të reja pune në këto zona.

Në këtë mënyrë do të reduktojmë emigracionin dhe do t'u japim mundësi banorëve të kthehen në zonat rurale. Ne parashikojmë masat e mëposhtme: mjete pa kthim për bujqit e rinj; mbështetje e projekteve për femra- bujk ; mbështetje për kooperativat bujqësore në zonat rurale dhe mbështetje për formimin e organizatave të prodhuesve dhe organizatave ndërsektoriale; mbështetje financiare për çiftet e reja të martuara që do të kthehen në zonat rurale dhe do të fillojnë një biznes; investime në projekte për përmirësimin e infrastrukturës në fshatra; mbështetje e grupeve lokale të veprimit për projekte në zonat rurale; mbështetje për ruajtjen e zonave rurale dhe karakteristikave të tyre tradicionale.

Lidhja në një sistem të vetëm të ministrisë dhe institucioneve të tjera të obliguara për zbatimin e politikave bujqësore është veçanërisht e rëndësishme. Kjo do të sigurojë që të mos ketë ndalesë në zbatimin e masave dhe instrumenteve. Në këtë mënyrë bujqit do të lirohen plotësisht nga detyrimet për të shkuar në institucione për të siguruar dokumente të ndryshme. Kjo do të kontribuojë në informimin e shpejtë për kushtet e tregut dhe plasimin e produkteve, si një nga problemet më serioze të bujqve.

Shfrytëzimi dhe menaxhimi i tokës bujqësore është gjithashtu dobësia kryesore sistematike e sektorit. Qëllimi ynë është të përmirësojmë politikat për menaxhim më efikas të tokës bujqësore. Do të intensifikojmë edhe procesin e konsolidimit dhe ndarjes së tokës shtetërore. Qeveria parashikon formimin e një Agjencie për menaxhimin e tokës bujqësore, e cila do të ndërmarrë të gjitha aktivitetet për menaxhimin e plotë dhe efikas të tokës bujqësore dhe kullotave. Synimi është suksesi i procesit të konsolidimit dhe vënia në funksion e plotë e tokës bujqësore.

Qeveria do të sigurojë një instrument që do të mundësojë akses më të lehtë në kapital për blerësit, duke garantuar kështu pagesën e prodhuesve bujqësorë.

Prioriteti ynë kryesor do të jetë ruajtja e një niveli të lartë të shëndetit publik të qytetarëve duke forcuar sistemin e integruar të sigurisë ushqimore. Për këtë qëllim, do të forcohen kontrollet e cilësisë së pesticideve, plehrave artificiale, farërave dhe materialit fidanor për të mbrojtur bujqit nga produktet me cilësi të ulët.

Ne planifikojmë mbështetje efektive të peshkimit dhe akuakulturës përmes një programi të veçantë që do të mbulojë prodhimin e peshkut dhe mbrojtjen e rezervave të peshkut në Maqedoni.

o INFRASTRUKTURË E ZHVILLUAR DHE FUNKSIONALE

Qeveria do të nisë zbatimin e projekteve për ndërtimin e infrastrukturës moderne dhe funksionale që do të kontribuojë në qarkullimin më të mirë të mallrave dhe shërbimeve. Do të krijojmë një infrastrukturë që do të lehtësojë lëvizjen e pasagjerëve në të gjithë vendin në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal dhe do të rrisë sigurinë e të gjithë pjesëmarrësve të rrugës.

Ne do të investojmë në infrastrukturën rrugore duke ndërtuar autostrada, eksprese, magjistrale, rrugë rajonale dhe lokale. Fokusi i investimeve do të jetë edhe infrastruktura komunale nëpërmjet ndërtimit të ujësjellësve, kanalizimeve atmosferike dhe fekale në të gjitha vendbanimet në të gjithë vendin. Ne do të investojmë në infrastrukturën hekurudhore përmes ndërtimit dhe rindërtimit të linjave hekurudhore dhe blerjes së trenave.

Synimi dhe vizioni ynë është të sjellim përtëritje dhe rritje të zhvillimit ekonomik, duke ecur përpara dhe përfundimin e plotë të të gjitha projekteve të prapambetura, të cilave do t'u japim një impuls dhe cilësi të re, si dhe do të ofrojmë dhe zbatojmë projekte të reja që do të nënkuptojnë një përmirësim të cilësisë të jetës së qytetarëve maqedonas.

Qeveria merr përsipër të realizoj autostradat e mëposhtme:

- Përfundimi i ndërtimit të autostradës Kërçovë - Ohër.
- Përfundimi i ndërtimit të autostradës Shkup - Bllacë.
- Autostrada Kërçovë – Bukojčan

Qeveria do të ndërmarrë hapa seriozë për të optimizuar dhe racionalizuar shpenzimet, afatet, dinamikën, prioritetin dhe kushtet për ndërtimin e seksioneve të miratuara të korridoreve 8 dhe 10D.

Ne jemi të përkushtuar për ndërtimin dhe projektimin e autostradave të mëposhtme:

- Përfundimi i ndërtimit të autostradës nga Gradsko në Prilep;
- Përfundimi i ndërtimit të autostradës nga Rankovca në Kriva Pallankë;
- Ndërtimi i rrugës eksprese qarkorja Manastir deri në pikën kufitare (Mexhitlia) - kufiri me Greqinë;
- Përgatitja e dokumentacionit për ndërtimin të rrugës shtetërore të qarkorja Resnjë;
- Përgatitja e studimit dhe dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Veles – Çashkë – Prilep;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Strumicë – Novo Sellë – vendkalimi kufitar Novo Sellë kufi me Bullgarinë;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Strumicë – Valandovë – Smokvicë;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Manastir – Resnjë;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Resnjë – Ohër;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Kavadar – Negotinë (lidhja në korridorin 10);
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për rrugën eksprese Koçan – Vinicë – Dellçevë;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për zgjerimin e rrugës Radovish - Strumicë.

Me punë të angazhuar parashikojmë projektimin, ndërtimin dhe rikonstruksionin e rrugëve të shumta rajonale në të gjitha anët e vendit, duke i kushtuar vëmendje zhvillimit rajonal.

Është i nevojshëm projektimi dhe ndërtimi i qarkoreve rreth bërthamave urbane të disa qyteteve në të gjithë vendin. Me këtë qasje, përveç lehtësimit dhe shkurtimit të seksioneve rrugore, do të ndihmojë në mbrojtjen e trafikut dhe mjedisit në qendrat urbane.

Për këtë qëllim në mandatin e ardhshëm do të punohet në projektimin, ndërtimin ose përfundimin e ndërtimit (në varësi të mundësive dhe shkallës së zhvillimit të projektit) të qarkoreve në qytetet në vijim: Tetovë, Shtip, Prilep, Veles, Manastir, Kavadar, Resnjë dhe Ohër. Rehabilitimi dhe rikonstrukcioni i autostradave, rrugëve kryesore dhe rajonale në të gjithë vendin do të jetë në fokus të punës së Qeverisë. Do të punohet intensivisht për rindërtimin e urave, rehabilitimin e rrëshqitjeve, muret mbajtëse, tunele dhe struktura të tjera rrugore. Rrugët kryesore dhe rajonale do të mirëmbahen dhe mbrohen vazhdimisht.

Do të mundësojmë pagesën elektronike në të gjitha rrugët me pagesë në Maqedoni, që do të rezultojë në qarkullim shumë më të madh në rrugë dhe ulje të korrupsionit.

Qeveria do të punojë në rindërtimin dhe rehabilitimin e korridorit hekurudhor 10. Do të përgatisim një projekt konceptual me studim fizibiliteti dhe renovim të hekurudhës në Korridorin 10 (Tabanovc - Gjevgjeli), si hekurudha më e shpeshtë me rëndësi të madhe për Republika e Maqedonisë, do të kryhet.

Parashikojmë edhe përfundimin e ndërtimit të hekurudhës Kumanovë - Deve Bair kufitar me Bullgarinë. Ky projekt parashikon punë të vazhdueshme deri në përfundimin e plotë të hekurudhës drejt Bullgarisë. Me këtë përfundimisht do të lidhemi me Bullgarinë me hekurudhë si pjesë e korridorit 8. Përfitimet e këtij projekti janë të mëdha për sa i përket trafikut hekurudhor të pasagjerëve dhe mallrave.

Qeveria do të punojë në rindërtimin, rehabilitimin dhe elektrifikimin e pjesëve hekurudhore: Shkup - Kërçovë si pjesë e Korridorit 8, Veles - Manastir si pjesë e Korridorit 10d, Veles - Koçan, zhvillimin e një projekti konceptual dhe studimin e fizibilitetit për ndërtimin e Linja e re hekurudhore Shtip - Strumicë dhe Republika e Bullgarisë, ndërtimi i degës hekurudhore Ilinden - Aeroporti Ndërkombëtar i Shkupit.

Qeveria do të parashikojë furnizimin e trenave elektrikë, trenave me naftë, remontin e përgjithshëm me modernizimin e trenave, vagonëve dhe lokomotivave ekzistuese. Do të zbatohet një riorganizim i funksionimit të kompanisë. Qëllimi është të sigurohet transporti hekurudhor më efikas, të përmirësohen kushtet e udhëtimit dhe të rritet numri i linjave.

Qeveria parasheh rindërtimin, rehabilitimin dhe ndërtimin e porteve ekzistuese në liqenet në Maqedoni. Puna ndërtimore është planifikuar për forcimin dhe kompletimin e porteve, si dhe rritjen e thellësisë në atë pjesë të liqenit me qëllim përmirësimin e kushteve

dhe rritjen e numrit të anijeve që do të përdorin shërbimet e porteve. Këto aktivitete do të ndërmerren në koordinim me pushtetin vendor, shoqatat mjedisore dhe UNESCO-n.

Në fushën e urbanistikës dhe ndërtimit do të kemi një qasje sistematike për reformimin e kësaj fushe. Reforma do të nënkuptojë aplikimin e mjeteve softuerike që do të mundësojnë zero korrupsion dhe një mënyrë të shpejtë, transparente, efikase dhe të lirë të miratimit të planeve urbanistike.

Në pjesën e ndërtimit do të aplikojmë teknologjinë më moderne BIM, e cila do të shkurtojë në mënyrë drastike kohën e marrjes së lejeve të ndërtimit dhe do të përjashtojë plotësisht faktorin njerëzor në procesin e vendimmarrjes.

Qeveria parasheh miratimin e Ligjit të ri për planifikim urban që do të mundësojë digjitalizimin dhe standardizimin e plotë të të dhënave në të gjitha institucionet kompetente, të cilat do të jenë në dispozicion pa pagesë përmes gjeoportalit qeveritar për urbanizëm dhe planifikim hapësinor. Gjeoportali do të jetë i disponueshëm për të gjitha shtëpitë projektuese, qytetarët dhe palët e interesuara. Kjo mënyrë do të mundësojë zero korrupsion dhe një mënyrë të shpejtë, transparente, efikase dhe të lirë të miratimit të planeve urbanistike.

Me ndryshimet e duhura ligjore, Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme do të mund të kryejë transformimin e të drejtës së shfrytëzimit të pronarëve të mëparshëm të tokës sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës. Me këtë zgjidhje të propozuar do të reduktoheshin ndjeshëm kostot e vetë qytetarëve dhe do të shkurtohej e gjithë procedura me rastin e fitimit të së drejtës së pronësisë së tokës ndërtimore që ata realisht e kanë në pronësi dhe në shfrytëzim.

Në të njëjtën kohë, do t'u mundësojmë pronarëve të pjesëve të veçanta të objekteve banesore kolektive që ndodhen në tokë në pronësi të Maqedonisë, me fuqinë e ligjit, të bëhen pronarë të një pjese ideale të parcelës ndërtimore. Në këtë mënyrë do të mundësojmë përfundimin e një numri të madh procedurash administrative afatgjata në të cilat një numër i madh qytetarësh kërkojnë fitimin e pronës, në truallin që është në funksion të objektit në të cilin janë pronarë të një pjese të veçantë.

Qeveria do të përafrojë të gjithë legjislacionin e BE-së për sa i përket planifikimit hapësinor dhe do të përdorim praktikën më të mira nga SHBA-ja dhe Japonia, për digjitalizimin e proceseve. Institucionet në këtë fushë do të lidhen vertikalisht dhe horizontalisht në një sistem të përbashkët. Të dhënat digjitale do të jenë plotësisht falas, të cilat do të ndihmojnë qytetarët, institucionet dhe bizneset.

Në bashkëpunim mes Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve Agjencia e Kadastrës së Pasurive të Paluajtshme dhe Qytetit të Shkupit, do të hartohet projekt-program për ndërtimin e Panairit të Shkupit. Panairi do të përmbajë një godinë administrative, një sallë shumëfunktionale, zyra komunale,

parking dhe pika të unifikuara ushqimore. Një model financimi do të zgjidhet nga dy alternativa, pra financimi shtetëror si opsioni i parë ose financimi nëpërmjet një tenderi të partneritetit publik-privat.

II FRONT KUNDËR KORRUPSIONIT

o REFORMA E SISTEMIT GJYQËSOR

Qeveria do t'i përkushtohet objektivave të mëposhtme për reformat në sistemin e drejtësisë:

- Zgjidhjet sistematike për transformimin e autoriteteve gjyqësore në entitete efikase vërtet të pavarura, transparente dhe të përgjegjshme;
- Futja e standardeve dhe vlerave europiane në tekstin e të gjitha ligjeve sipas parimit europian "Rule of law check list";
- Drejtësia duhet të vijë në Maqedoni për të dënuarit padrejtësisht në rastet e montuara politikisht;
- Mbrojtja nga konflikti i interesave dhe nepotizmi në sistemin gjyqësor dhe prokurorial;
- Përgjegjësi për të gjithë ata që kanë bërë gabim para Kushtetutës dhe ligjeve në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht për ata që janë pasuruar ilegalisht në kurrizin e qytetarëve;
- Procedura administrative efektive në interes të qytetarëve, të cilat do të mundësojnë drejtësi efektive dhe efikase për të gjithë edhe në këto procese;
- Ne do t'i përkushtohemi mbrojtjes së qytetarëve nga kostot joreale dhe joproportionale, dhe njëkohësisht do të angazhohemi për ndërtimin e një politikë kundërvajtëse ekskluzivisht në interes të qytetarëve.

Ne do të udhëhiqemi nga parimet e mëposhtme:

- Themelet e sistem i së drejtës dhe shoqërisë maqedonase duhet të jenë demokracia, zbatimi pa kompromis i parimit të sundimit të së drejtës dhe forcimi i vetëdijes qytetare dhe politike për nevojën që ligji të sundojë njësoj për të gjithë;
- Qeveria angazhohet për punë të ligjshme, të ndershme dhe të përkushtuar;
- Ligjet në Republikën e Maqedonisë do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, fetare, gjinore dhe përkatësia tjetër. Sundimi i së drejtës si një imperativ në një shtet demokratik evropian nënkupton shumë më tepër sesa thjesht një angazhim deklarativ për respektimin e ligjeve. Do të thotë gjithashtu një ndërgjegjësim i zhvilluar për nevojën e një shoqërie në të cilën ligjet do të respektohen dhe zbatohen, por mbi të gjitha do të jenë të drejta dhe zbatimi i tyre do të jetë efikas dhe jo selektiv.

Qeveria do të ofrojë zgjidhje të reja sistematike për t'i shndërruar organet gjyqësore në vërtet të pavarura, transparente, të përgjegjshme dhe efikase, që janë themeli i një shoqërie normale demokratike.

Qeveria do t'i përkushtohet lirimit të gjyqësorit nga kufizimet e pushtetit ekzekutiv dhe zbatimit të politikave për të zbardhur konfliktin e interesave në gjyqësor, nepotizmin

aktual, dhe miqësinë të vendosen kriteret ligjore për renditjen e kandidatëve për gjyqtarë dhe kryetarë gjykatash dhe do të rregullohen procedurat për marrjen dhe transferimin e gjyqtarëve në gjykata të tjera.

Përmes një reforme gjithëpërfshirëse do të kufizohet përzgjedhja e gjyqtarëve nga kandidatët e rangut më të ulët që vijnë nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Këshilli Gjyqësor do të duhet të japë një arsyetim specifik për përzgjedhjen përfundimtare. Ne do të respektojmë rekomandimet e misioneve vlerësuese dhe të Bashkimit Evropian në lidhje me kushtet për përzgjedhjen e gjyqtarëve në të gjitha nivelet e gjyqësorit, të cilat do të bazohen në rregulla dhe kriteret të qarta, të ngulitura në një sistem meritash.

Ne parashikojmë shpërbërjen dhe reformën ligjore të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Në një periudhë kalimtare, qeveria do të iniciojë ndryshime ligjore që do të vendosin kriteret strikte dhe objektivist të matshme që duhet të plotësojnë anëtarët e rinj, të zgjedhur me propozimin e Kuvendit dhe Presidentit të Shtetit. Procedura do të jetë transparente dhe publike, e cila do të garantojë integritetin dhe cilësinë e kandidatëve të përzgjedhur. Qeveria do të nisë edhe një proces të ndryshimit të Kushtetutës në pjesën e rregullimit të përbërjes së Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, ku do të propozojë zgjidhje për përzgjedhjen e anëtarëve nga vetë gjyqtarët dhe prokurorët publikë, ku kandidatët do të duhet të plotësojnë kriteret të larta personale dhe profesionale.

Gjatë procesit të reformës ligjore të Këshillit Gjyqësor, do të kemi parasysh të gjitha rekomandimet e Bashkimit Evropian dhe praktikën e mira evropiane.

Me ndryshimin e rregullores ligjore, Këshilli Gjyqësor do të obligohet që pas marrjes së vendimit për shkarkimin e gjyqtarit, të dorëzojë raport për procedurën e shkarkimit të gjyqtarit, me gjithë dokumentacionin e bashkëngjitur, në prokurorinë publike kompetente, me qëllim të kontrollit të shkeljeve të mundshme të kodit penal.

Në rast të ekzistimit të aktvendimeve të ndryshme gjyqësore, nga e njëjta gjykatë apo gjykatë e ndryshme, dhe në lidhje me gjendjen e njëjtë apo të ngjashme faktike, përmes ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat, do të parashihet dispozitë që Gjykata Supreme të miratojë një qëndrim parimor në rastet e zbatimit të pabarabartë të ligjeve.

Ligji do të parashikojë fillimin e një procedure për përgjegjësinë e një gjyqtari, vendimet ose gjykimet e të cilit për çdo shkelje të konstatuar të të drejtave dhe lirive të njeriut nga gjykata në Strasburg. Për të garantuar nivelin më të lartë të të drejtave të njeriut, ne do të parashikojmë me ligj që kryetari i çdo gjykate të caktojë një komisioner për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga radhët e gjyqtarëve. Obligimet dhe mënyrat e veprimit

të gjyqtarit – komisionerit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut do të parashikohen me ndryshimet në Ligjin për Gjykatat.

Ndryshimet ligjore do të parashikojnë edhe detyrimin e Këshillit Gjyqësor që të njoftojë qytetarët që kanë paraqitur kërkesë për të përcaktuar përgjegjësinë e gjyqtarit për vendimin e marrë. Nëse, pas ankesës së një qytetari, gjyqtari shpallet përgjegjës për kryerjen joprofesionale dhe të pakujdesshme të detyrës, Këshilli Gjyqësor do të informojë detyrimisht qytetarin për të drejtën e tij për të kërkuar shpërblimin e dëmit të pësuar.

Me ndryshimin e Ligjit për procedurë penale do të mundësohet që gazetarët, përfaqësuesit e publikut shkencor dhe profesional të ndjekin seancat për caktimin e masës së paraburgimit. Në këtë mënyrë do të jetë e pamundur të ndikohet në sistemin prokurorial-gjyqësor që masën e paraburgimit ta përdorë si dënim, e jo si masë për të siguruar praninë në procedurën penale.

Gjyqësori duhet të jetë plotësisht i pavarur dhe i ndarë nga Prokuroria Publike, e cila me ligj paraqet një organ shtetëror unik dhe të pavarur. Prokuroria Publike është palë në procedurë para gjykatave, si dhe avokatët. Pikërisht për këtë duhet të ndahet edukimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, për të parandaluar ndikimet dhe keqpërdorimet e mundshme gjatë zhvillimit të procedurës.

Do të dinamizojmë procesin e digjitalizimit të gjyqësorit, do të futim dorëzimin elektronik dhe dorëzimin elektronik të kërkesave për lëshimin e dokumenteve nga gjykatat.

Do të inicohet një procedurë për auditimin dhe shqyrtimin e ligjshmërisë së gjithë funksionimit të Prokurorisë Speciale Publike, me vëmendje të veçantë rrezikimeve ndaj të drejtave të njeriut në procedurat e PSP-së, shkeljeve të ligjeve procedurale gjatë veprimeve të PSP-së, zbardhjen e abuzimeve të konstatuara të pagesës së burimeve financiare për prokurorët, hetuesit dhe këshilltarët dhe kthimin e tyre në buxhet, si dhe shqyrtimin e nepotizmit, partishmërisë dhe miqësisë në punësimin e PSP-së.

Përbërja aktuale e Këshillit të Prokurorëve Publikë ka humbur besueshmërinë dhe do të shpërndalet. Ndryshimet ligjore do të vendosin kritere strikte dhe objektive për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit. Ne do të përcaktojmë kritere të qarta, strikte dhe të larta të pikëve në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të prokurorëve publikë të cilët zgjidhen në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Procedura do të jetë transparente dhe publike, gjë që do të garantojë përzgjedhjen e kandidatëve më të mirë. Kandidatëve të propozuar do t'u kërkohej të kenë një program pune me tregues të performancës të përcaktuar qartë. Gjatë procesit të reformës ligjore të Këshillit të Prokurorëve Publikë, ne do të kemi parasysh standardet më të larta evropiane.

Prokurorët publikë do të përzgjidhen nga lista e kandidatëve më të mirë që kanë përfunduar me sukses trajnimin në Akademinë për Prokurorë. Me ndryshime ligjore do të ngrisin dhe saktësojmë kriteret për mundësinë e avancimit të prokurorëve publikë, me ç'rast do të bëhet vlerësimi i detyrueshëm i punës së tyre. Me ndryshimin e rregullores ligjore do të parashikohet detyrimi i Këshillit të Prokurorëve Publik pas marrjes së vendimit për shkarkimin e prokurorit, të dorëzojë raport për procedurën e shkarkimit të prokurorit me gjithë dokumentacionin e bashkangjitur në prokurorinë publike kompetente, me qëllim të verifikimit të shkeljeve të mundshme të ligjeve.

Do të përcaktojmë afatet ligjore për të vepruar në hetim paraprak, me përgjegjësi të prokurorëve publikë të cilët nuk kanë vepruar brenda afatit ligjor.

Me ndryshimin e Ligjit për procedurë civile, do të rishikohet dhe rritet numri i arsyeve për paraqitjen e revizionit në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, duke krijuar kushte për drejtësi efektive dhe efikase.

Ligji për procedurën penale do të jetë në përputhje të plotë me parimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në veçanti do të rregullohet procedura për caktimin e masës së paraburgimit, për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj mase. Njëkohësisht do të rriten të drejtat e mbrojtjes, do të rriten afatet për paraqitjen e ankesave për vendimet për të cilat palët nuk pajtohen, të drejtat e viktimave të krimeve dhe viktimave të procedimit penal.

Përmes ndryshimit të Ligjit për procedurë penale, do të parashihet procedura e detyrueshme në të cilën gjykata fillimisht do të vlerësojë nëse ka mundësi për caktimin e garancisë.

Me qëllim të uljes së kostove të proceseve gjyqësore dhe gjyqësore në institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tyre, kompanitë në pronësi dominuese shtetërore, dhe kudo që ka kuadër adekuat, do të ndalohet punësimi i personave të jashtëm për procedurat vlera e të cilave nuk kalon tre milionë denarë.

Qasja në gjykatë do t'u sigurohet kategorive të cënueshme të qytetarëve, përmes vendosjes së një përjashtimi të detyrueshëm nga tarifat gjyqësore për përfituesit e kompensimeve nga Ligji për mbrojtjen sociale, personat që kanë të ardhura më të vogla se paga minimale dhe personat që nuk zotërojnë pasuri të paluajtshme në emër të tyre.

Do të investohet në rindërtimin e **institucionet ndëshkuese**-përmirësuese me synim arritjen e standardeve evropiane gjatë vuajtjes së dënimit.

LUFTA SISTEMIKE KUNDËR KORRUPSIONIT

Prioriteti i Qeverisë së re është lufta e pamëshirshme kundër korrupsionit dhe dënimet për postet e korruptuara publike. Nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve do të reduktohet faktori subjektiv njerëzor në proceset vendimmarrëse. Do të vendoset një sistem efikas për parandalimin, mbikëqyrjen dhe auditimin e funksionimit të institucioneve publike. Një luftë vendimtare, jo selektive dhe pa kompromis kundër korrupsionit dhe sundimit të së drejtës është kusht për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Maqedonisë.

Qeveria do të krijojë një organ koordinues për të luftuar korrupsionin. Trupi do të punojë për të unifikuar përpjekjet kundër korrupsionit të të gjitha institucioneve dhe organizatave qeveritare.

E përforcuar me staf dhe burime cilësore, Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR) do të jetë një institucion që do të parandalojë dhe njohë rreziqet e korrupsionit. Ne parashikojmë një lidhje sistematike të Zyrës së Entit Shtetëror të Revizionit me Prokurorinë Publike, si dhe obligim për Prokurorinë Publike që të shqyrtojë raportet nga ESHR. Si shtyllë e sistemit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) duhet të ketë të gjitha burimet e nevojshme njerëzore dhe materiale për të përmbushur plotësisht dhe me efikasitet detyrën e saj, veçanërisht në fushën e kontrollimit të gjendjes së pasurisë të zyrtarëve të zgjedhur dhe të emëruar. Përmes ndryshimeve ligjore do të parashihet obligim që Prokuroria Publike të veprojë me prioritet në rastet dhe iniciativat që KSHPK-ja i paraqet.

Qeveria do të zhvillojë një program për të shqyrtuar dhe përcaktuar origjinën e pasurisë së gjyqtarëve, prokurorëve publikë, zyrtarëve politikë dhe drejtuesve të lartë në sektorin publik. Në këtë drejtim do të fokusohemi veçanërisht në rritjen e numrit të procedurave për përcaktimin e origjinës së pasurisë ndaj të gjitha niveleve të qeverisjes, institucioneve shtetërore dhe publike dhe drejtuesve të lartë për të cilët ekziston një shkallë e lartë dyshimi për korrupsion. Parashikojmë një rritje të shtrirjes së sanksioneve dhe masës së tyre në lidhje me shkeljen e rregullave për konfliktin e interesit, integritetin dhe parandalimin e praktikave korruptive përmes ndryshimeve në Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit. Ndryshimet do të jenë në drejtim të plotësisht të parakushteve për efikasitet, proporcionalitet dhe efekt parandalues. Do të zhvillohet një program për një revizion gjithëpërfshirës të funksionimit të përgjithshëm të disa institucioneve, funksionimi i të cilave ngre dyshime për korrupsion.

Me programin gjithëpërfshirë do të lidhet sistemi i vetëm për furnizime publike me regjistrin e të punësuarëve në sektorin publik, APRMV ,DAP, kadastra, regjistri qendror, regjistri i popullësisë dhe sistemi të tjera të nevojshme. Në këtë mënyrë, sistemi i vetëm për furnizime publike do të identifikoj, do të paraqes dhe do të publikoj konflikte të interesave dhe rreziqet e korrupsionit në furnizimet publike. Regjistri do të parandalojë abuzimet në lidhje me personat e përfshirë në furnizimet publike për përgatitjen dhe vlerësimin e tyre, si dhe pjesëmarrjen në to nga kompanitë konkurruese. Gjithashtu, transparencja e sistemit të vetëm të furnizimi publik do të rritet duke rritur numrin e të dhënave dhe frekuencën e raporteve të publikuara.

Për të përmirësuar sistemin e revizionit të brendshëm, ne do të rrisim numrin e revizorëve të brendshëm në institucionet shtetërore dhe publike dhe do të krijojmë një Komitet të revizorëve si trup i ri qendror për të monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga revizorët e brendshëm dhe nga Enti Shtetëror i Revizionit. Të gjitha institucionet shtetërore do të kërkohet që të kenë oficer të integritetit, të certifikuar me licenca për zbatimin e standardeve ndërkombëtare për menaxhimin kundër korrupsionit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve. Të gjitha institucionet, ndërmarrjet publike dhe kompanitë në pronësi dominuese shtetërore do të jenë të obliguara të publikojnë publikisht raportet nga Enti Shtetëror i Revizionit dhe raportet e revizionit nga shtëpitë e tjera të revizionit.

Me ligj, do të kufizohen dhe pakësohen autorizimet diskrecionale të udhëheqësve të institucioneve. Çdo institucion do të obligohet të hartojë dhe të shpallë publikisht listë e të gjitha autorizimeve diskrecionale të cilat i kanë strukturat e tij të udhëheqësisë. Do të hartojmë edhe plan me të cilin të gjitha automjetet zyrtare të institucioneve shtetërore do të shënohen me targa të regjistrimit në ngjyrë specifike për njohjen e tyre.

Sipas programit të përcaktuar, do të hartojmë platformë të specializuar digjitale për mbajtjen e trajnimeve për integritetin, njohjen, prevenimin dhe parandalimin e korrupsionit në sektorin publik.

Me ndryshimet ligjore, institucionet shtetërore do të obligohen që të zbatojnë standardin për menaxhimin e anti-korrupsit. Ky standard ndërkombëtar mundëson futjen dhe certifikimin e sistemit për mekanizma efikase, të matshme dhe të dukshme, procedura dhe procese për prevenim, detektim dhe menaxhim të korrupsionit në çdo institucion shtetëror.

III SUNDIMI I SË DREJTËS NË INSTITUCIONET

○ REFORMA NË SISTEMIN POLITIK

Sistemi politik maqedonas ka nevojë urgjente për reformë demokratike. Prandaj, qeveria do të promovojë politikë për mirëkuptim dhe bashkëpunim në këtë proces reformues, duke u përpjekur për parimin e "konsensusit kombëtar". Do të këmbëngulim në udhëheqjen e politikave të arrihet konsensus politik sa më gjithëpërfshirës gjatë hartimit dhe realizimit të projekteve dhe politikave me rëndësi dhe vlerë afatgjatë për shtetin. Në këtë drejtim, Qeveria do të mbështesë diskutimet gjithëpërfshirëse në Kuvend për: amendamentet e Kushtetutës me të cilat do të mundësohet formimin e Kuvendit prej 90 deputetësh, si dhe reformat ligjore sistematike për: futjen e një njësie zgjedhore për zgjedhjen e deputetëve në Kuvendin maqedonas me prag zgjedhor sipas shembullit të vendeve të tjera evropiane, shfuqizimin e censusit zgjedhor për zgjedhjen e Presidentit, në përputhje me rekomandimet e OSBE/ODIHR, shfuqizimi i konceptit Qeveri për zhvillimin e zgjedhjeve (e ashtuquajtura Qeveri Teknike), reforma në Gjykatën Kushtetuese dhe vendosjen e mundësisë së shkarkimit të kryetarit të komunës.

Për të rritur efikasitetin dhe funksionalitetin e punës së organeve të administratës shtetërore, do të bëhet një riorganizim i plotë i ministrive ekzistuese, si dhe reduktimi i organeve dhe institucioneve të administratës shtetërore. Në këtë drejtim, Qeveria do të bëjë përpjekje për optimizimin e institucioneve, në drejtim të heqjes së pozitive zëvendësrejtore, ulje e numrit të bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse dhe krijimit të një sistemi të centralizuar për punë të përbashkët administrative dhe logjistike në institucionet më të vogla.

Duke respektuar plotësisht parimin kushtetues për përfaqësim adekuat dhe të drejtë të qytetarëve që u përkasin të gjitha komuniteteve në Maqedoni, Qeveria do të ndryshojë rregulloren ekzistuese, me qëllim të largimit të mjetit "balancues" gjatë punësimeve. Në këtë mënyrë, në radhë të parë do të respektohen cilësitë personale, ekspertiza, kompetenca dhe sistemi i meritave gjatë punësimit në institucionet shtetërore.

Në procesin e përditësimit të sistemit të regjistrimit elektronik të popullsisë, Qeveria do të krijojë kushte për kryerjen e regjistrimit digjital të popullsisë në vitin 2026.

Qeveria do të punojë në mënyrë aktive për futjen e regjistrimit ligjor i cili do të qaset lehtë, si dhe reduktimin e ligjeve të panevojshme, rregullave dhe procedurave, të cilat e bëjnë më të vështirë udhëheqjen e biznesit dhe në përgjithësi jetesën.

○ SMART MAQEDONI – SHËRBIMET PUBLIKE TË DISPONUESHME

Me një qasje sistematike, do e avancojmë transformimin digjital të sektorit publik. Ministria e Transformimit Digjital do të punojë në krijimin e politikave, rregullimin, inicimin dhe zbatimin e programeve në lidhje me transformimin digjital të shoqërisë dhe shërbimeve publike, si dhe në fushën e komunikimeve elektronike dhe mediave. Me qëllim unifikimin e kapaciteteve dhe rritjen e numrit të aktiviteteve për zhvillimin e shoqërisë informatike dhe promovimin e transformimit digjital, Qeveria do të propozojë Strategji të re Kombëtare për TIK-un. Përveç kësaj, për t'u përballur me kërcënimet kibernetike, parashikojmë miratimin e strategjisë kombëtare për siguri kibernetike dhe ligj për siguri kibernetike.

Do të punojmë në mënyrë aktive në ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme e cila do të jetë bartës i transformimit dhe do të zhvillojmë shërbime në dispozicion të të gjithë qytetarëve. Fokusi do të vendoset në zhvillim të infrastrukturës moderne digjitale, zhvillimi i platformës për inteligjencë artificiale, përforsimi i kapaciteteve të sektorit publik për të punuar me të dhëna, digjitalizimi i plotë i shërbimeve publike, futja e shërbimeve celulare, trajnimi i qytetarëve për përdorimin e shërbimeve digjitale, përfshirja digjitale e personave me aftësi të kufizuara dhe siguria kibernetike. Qeveria do të ndihmojë komunat në digjitalizimin drejt sistemit qyteti i zgjuar. Ky sistem do të kontribuojë kryesisht në përmirësimin e cilësisë së jetës (parkimit, menaxhimit të trafikut, transportit publik, cilësisë së ajrit dhe ujit).

Pas përcaktimit të zonave në të cilat operatorët nuk kanë interes komercial për ofrimin e rrjeteve/shërbimeve të komunikimit elektronik (zona të bardha), Qeveria do të hartojë plan për sigurimin e rrjeteve/shërbimeve të nevojshme për qytetarët. Me qëllim të zvogëlimin të boshllëkut digjital, Qeveria do të sigurojë mundësi për qasje në internet për çdo amvisëri në Maqedoni, duke përfshirë edhe amvisëritë që ndodhen në zona ku nuk ka interes komercial nga operatorët. Do të bëhen përpjekje për nënshkrim të marrëveshjes për uljen e çmimeve të shërbimeve në roaming edhe me vendet e tjera, veçanërisht me vendet anëtare të Bashkimit Evropian.

Qeveria do të shqyrtojë në mënyrë aktive mundësitë e dhënies së radiofrekuencave për një operator celular të tretë të rrjetit. Në këtë mënyrë do të sigurohet rrjet i besueshëm për shërbimet e komunikimit publik, si dhe konkurrencë më e madhe në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në drejtim të zhvillimit të rrjetit 5G, Qeveria do të zbatojë masa dhe aktivitete për të arritur këto rezultatet në vijim: deri në fund të vitit 2025, të gjitha rrugët kryesore rrugore në Maqedoni të mbulohen me 5G; ndërsa deri në fund të vitit 2030, të gjithë qytetarët e Maqedonisë të kenë mundësi për qasje deri te 5G me shpejtësi të qasjes prej së paku 100 Mbps.

Në drejtim të mundësimit të shërbimeve digjitale për qytetarët, përdorimit efikas dhe të lehtë të tyre dhe reduktimit të mundësive për korrupsion, Qeveria parashikon:

- Identitet digjital (elektronik) për çdo qytetar, i cili do të mundësojë njohjen e qytetarëve në hapësirën digjitale (e-ID);
- digjitalizimi i shërbimeve publike më të përdorura nga qytetarët dhe kompanitë, sipas metodologjisë së përcaktuar posaçërisht për digjitalizimin e shërbimeve publike;
- inkuadrimi i një portali Nacional për shërbime në nivel shtetëror dhe lokal, me aplikacion celular për shërbime për qytetarët e disponueshme në telefonat e mençur;
- shpallje publike të katalogut të shërbimeve të çdo institucioni, me afate të detyrueshme për veprim;
- e-rikujtes për rinovimin e dokumenteve;
- ndërveprueshmëri e plotë ndërmjet të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, përmes një reje të dhënash përmes së cilës zyrtarët administrativë do të jenë në gjendje të marrin shpejt të gjitha provat dhe dokumentet e nevojshme dhe të përshpejtojnë dhe automatizojnë ndjeshëm ofrimin e shërbimeve;
- Në lokacione qendrore në disa qytete do të vendosim terminale ku qytetarët, me ndihmën e punonjësve, do të mund të marrin më shumë shërbime dhe dokumente nga institucionet.

○ REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Puna e administratës publike në mënyrë të jashtëzakonshme do të bazohet në parimet e efikasitetit, transparencës, profesionalizmit, llogaridhënies dhe disponueshmërisë së shërbimeve. Qeveria do të angazhohet për administratë efikase, e cila fokusohet plotësisht në ofrimin e shpejtë dhe cilësor të shërbimeve dhe eliminon procedurat e panevojshme burokratike. Masat dhe aktivitetet do të grupohen në fusha kyçe në përputhje me Kornizën strategjike të reformës së administratës publike (SIGMA). Me zbatimin e këtyre reformave, Qeveria e ardhshme synon të krijojë administratë publike e cila do të ndikojë në kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet shtetërore dhe do të jetë katalizator për zhvillimin ekonomik.

Qeveria do t'i përkushtohet forcimit të potencialit të administratës, duke ndërtuar profesionistë të kualifikuar dhe të mirëtrajnuar, të cilët do të përfshihen në një proces gjithëpërfshirës të edukimit të vazhdueshëm. Sistemi i karrierës do të nënkuptojë definimin e rrugëve të qarta dhe objektive për përparimin në karrierë dhe zhvillimin profesional të çdo punonjësi. Në procesin e menaxhimit të burimeve njerëzore, Qeveria do të parashikojë mekanizma për vlerësimin adekuat të punës së zyrtarëve administrativë, mundësitë për avancim dhe shpërblim, duke marrë parasysh kontributin personal të punonjësve, vlerësimin e performancës së tyre, pjesëmarrjen në grupe të punës dhe përvojën e punës. Aktivizimi i Portalit për qarkullimin e lirë të zyrtarëve administrativë do të funksionojë si një sistem i vetëm për menaxhimin e burimeve njerëzore në nivel të të gjithë administratës publike. Për shkak të mungesës së profesionistëve nga profesionet deficitare në sektorin publik, Qeveria do të sigurojë lehtësim për punësim dhe mbajtjen e këtij kuadri, me qëllim të shërbimeve më cilësore dhe në kohë për qytetarët. Do të punohet edhe në promovimin e kategorive të punës së nëpunësve administrativë dhe niveleve të reja të vendeve të punës, me qëllim që të valorizohet në mënyrë adekuate puna e të gjithë punonjësve administrativë.

Duke zbatuar përvojat dhe analizat evropiane, parashikojmë një ulje prej 10% të numrit të përgjithshëm të organeve të administratës shtetërore, institucioneve dhe ndërmarrjeve publike. Institucionet që kanë kompetenca të ngjashme ose të përafërta do të shkrihen në një, me çka do të zvogëlohet numri i drejtorëve, bordeve drejtuese dhe mbikëqyrëse, si dhe kostot e panevojshme. Do të fusim sistem elektronik për menaxhimin e dokumenteve në të gjitha organet e administratës shtetërore dhe digjitalizim të të gjitha proceseve të brendshme, duke përfshirë veprimtarinë arkivore dhe afariste. Do të përgatitet analizë për nevojën e shpërndarjes së një pjese të institucioneve shtetërore në qytete të tjera të Maqedonisë.

Do të punojmë në centralizimin e përpjekjeve për aplikimin dhe menaxhimin e projekteve lidhur me integrimet evropiane maqedonase në Agjencinë Kombëtare për Projekte Evropiane, e cila do të integrojë institucionet dhe departamentet përgjegjëse për programimin e projekteve evropiane, zbatimin e tyre, mbikëqyrjen dhe monitorimin e realizimit të projekteve.

Me qëllim të përmirësimit të punës dhe koordinimin e inspektimit, parashikojmë shndërrimin e Këshillit të inspektorateve në trup koordinues të drejtorëve të shërbimeve inspektuese. Numri i organeve të inspektimit do të korrespondojë me numrin e sistemeve ministrore.

○ РАЗВИЕНИ ЛОКАЛНИ САМОУПРАВИ И РАМНОМЕРЕН РЕГИОНАЛЕН РАЗВОЈ

○ VETËQEVERISJE LOKALE TË ZHVILLUARA DHE ZHVILLIM I BARABARTË RAJONAL

Mbështetje për komunat moderne, transparente dhe financiarisht të qëndrueshme është parim nga i cili do të udhëhiqet Qeveria në punën e saj. Një nga parimet kryesore të Qeverisë do të jetë që në mënyrë të barabartë të zhvillohen të gjitha rajonet, i cili do të realizohet përmes shpërndarjes së balancuar të mjeteve ndërmjet rajoneve planore dhe komunave.

Bashkëpunimi financiar që Qeveria do të mundësojë për komunat është përmes disa fushave dhe modeleve, ku do të respektohen parimet në vijim:

- Investimi i vazhdueshëm i mjeteve nga buxheti qendror për projekte kapitale infrastrukturore në komunat deri në 250 milionë euro në vit;
- Rritja e stabilitetit financiar të komunave përmes mundësimin të shpërndarjes së mjeteve në mënyrë të drejtë, ku do të bëhet kujdes i parimeve të zhvillimit të barabartë rajonal;
- Përfitimet dhe stimujt për komunat të cilat kanë buxhete të planifikuara në mënyrë të shkëlqyer, nivel të lartë të realizimit, si dhe nivel të lartë të mbledhjes së taksave lokale;
- Përmirësimi i metodologjisë për llogaritjen e kostove të mirëmbajtjes së objekteve arsimore në komunat, sipas së cilës mjetet u paguhen përmes bllok dotacioneve.

Në diskutim me pushtetin lokal, Qeveria do të punojë në thellimin e procesit të decentralizimit në Maqedoni, përmes rritjes së vazhdueshme të bartjes së fushëveprimit të kompetencave nga organet shtetërore të administratës në kompetencat e njësive të vetëqeverisjes lokale në përputhje me kapacitetet e ndërtruara të njësive të vetëqeverisjes lokale.

IV SISTEM INSTITUCIONAL FUNKSIONAL

○ SISTEM CILËSOT SHËNDETËSOR

Vizioni i Qeverisë është sistem shëndetësor efikas, efektiv dhe i qasshëm për qytetarët e Maqedonisë. Vizioni ynë e vendos pacientin në qendër të të gjitha proceseve të kujdesit shëndetësor, ndërsa në të njëjtën kohë parashikojmë kujdes shëndetësor sipas nevojave të pacientit. Qeveria do të zhvillojë plan për optimizimin e sistemit shëndetësor dhe investime të konsiderueshme për përforcimin e shëndetit publik, investime në ekipimin kadrovik, pajisje mjekësore dhe infrastrukturë, edukim të vazhdueshëm dhe transferim i njohurive të personelit mjekësor sipas standardeve më të mira botërore dhe metodave të reja, vendosjen e mekanizmave efikas për financim të institucioneve shëndetësore dhe zhvillimin e sistemit informativ shëndetësor në kuadër të përpjekjeve për digjitalizimin e shëndetësisë. Do t'i kushtohet vëmendje rajonalizimit, në mënyrë që shërbimet shëndetësore të jenë të disponueshme në të gjithë territorin e vendit dhe në çdo kohë të jenë të disponueshme për të gjithë siguruesit shëndetësor. Qeveria do të zhvillojë dhe zbatojë program për integrimin dhe riorganizimin funksional të njësive shëndetësore në kujdesin sekondar shëndetësor, përmes pozicionimit të barabartë rajonal të të gjitha institucioneve mjekësore në Maqedoni.

Përmes procesit të integritit dhe riorganizimit funksional të njësive shëndetësore në përputhje me legjislacionin e BE-së, parashikojmë bashkim funksional të klinikave në kuadër të Qendrës Klinike në Shkup. Për të shfuqizuar dualizmin dhe burokracinë në menaxhim, Qeveria do të propozojë ndryshime ligjore për shfuqizimin e drejtorëve operativ (ekonomik) të klinikave.

Me qëllim të përmirësimit të kujdesit social dhe shëndetësor të popullsisë në zonat rurale, Qeveria do të ofrojë masa nxitëse për të inkurajuar punonjësit shëndetësorë të punojnë në zonat rurale në të gjithë vendin.

Qeveria do të përgatisë dhe do t'i propozojë Kuvendit Strategji Nacionale Shëndetësore dhe strategji për mjekët e rinj që do të parasheh metodologji, drejtime dhe mënyra për mbështetjen e mjekëve të rinj dhe do të mundësojë punë të tyre dinjitoze në sistemin shëndetësor. Për unifikim dhe përmirësim të terapisë mjekësore dhe futjen e mjekësisë së bazuar në dëshmi, parashikojmë zhvillim të udhëzimeve klinike dhe procedurave të operimit spitalor në të gjitha institucionet mjekësore në shtet.

Në kuadër të mundësive ekonomike të shtetit do të hartohet plan për punësimin gradual dhe të drejtë të të gjithë punonjësve në institucionet shëndetësore të cilët punojnë prej vitesh pa marrëdhënie pune të zgjidhur, personel mjekësor në profesionet deficitare dhe rritjen e numrit të specializimeve për specializantët e rinj nga fushat deficitare.

Qeveria do të parashikojë rritje të vazhdueshme të kapitacionit të vlerës të mjekët amë dhe stomatologët, si dhe do të rishikojë pakot mjekësore dhe dentare, me qëllim të vlerësimit real të punës. Parashikojmë politika për t'u mundësuar mjekëve nga fushat deficitare të drejtën për të vendosur nëse do të vazhdojnë të punojnë në institucionet

shëndetësore publike, duke mbajtur të drejtën për pension. Në drejtim të përmirësimit të kushteve për personelin mjekësor, Qeveria do të punojë për ngritjen e statusit të personelit mjekësor në përputhje me praktikën evropiane që përfshijnë kodin e praktikës, arsimit, trajnimit, karrierës dhe disiplinës profesionale. Në optimizimin e planifikuar të proceseve do të racionalizohet koha e punës së mjekëve amë, duke rritur efikasitetin dhe efektivitetin, si dhe optimizimin e proceseve me më pak administrim.

Qeveria do të zbatojë plan gjithëpërfshirës për digjitalizimin e sistemit shëndetësor – Shëndetësi pa letra. I njëjti do të përfshijë:

- Transparencë dhe reduktim të listave të pritjes;
- Reduktim të detyrave administrative për punonjësit e mjekësisë;
- Avancim të aplikacionit celular për sistemin Termini Im për të gjitha shërbimet dhe përfitimet shëndetësore;
- Digjitalizimi i plotë i recetave mjekësore, udhëzimeve, raporteve dhe rezultateve;
- Regjistër integral dhe të integruar për të gjithë pacientët në formë të skedarit E-medical i cili do të përmbajë historikun e sëmundjeve për çdo pacient;
- Hartim i regjistrit e-shëndetësor të sëmundjeve, me të cilin do të fitohet pasqyrë për numrin, llojin dhe shpeshësinë e sëmundjeve në Republikën e Maqedonisë;
- Zhvillim të sistemit elektronik shëndetësor plotësisht të integruar me baza të dhënash të unifikuara, së bashku me sektorin informatik të FSSHM nga njëra anë dhe të gjithë ofruesit e shërbimeve private komercijale nga fusha e shëndetësisë. Ky sistem do të ketë për detyrë unifikimin e sistemit shëndetësor, si dhe ndjekjen e rrugëtimit të plotë të pacientit nëpër të gjitha segmentet e sistemit;
- Përforsim të sistemit për transplant të organeve nëpërmjet digjitalizimit të plotë të proceseve dhe listës për transplantimin e organeve.

Me qëllim të përmirësimit të shërbimeve stomatologjike për qytetarët, Qeveria do të hapë departament të ri për stomatologji digjitale, si dhe do të vërë në funksion shërbimin dentar kujdestar të Qendrës Klinike Dentare “Shën Pantelejmon” në Shkup.

Do të përforcojmë skringun e sëmundjeve malinje në të gjithë territorin e vendit, siç janë kanceri i gjirit dhe i mitrës dhe së fundi do të fusim skringun për kancer të prostatës sipas praktikave më moderne evropiane. Do të hapim qendër moderne për fekondim in vitro në Klinikën Universitare për Gjinekologji Obstetrike.

Qeveria do të zhvillojë model për uljen e çmimeve dhe kufizimin e marzheve të barnave dhe pajisjeve mjekësore. Përmes rritjes së konkurrencës në sektorin farmaceutik do të garantohet cilësia e lartë e barnave dhe do të përmirësohen mekanizmat kontrollues për blerjen dhe shpërndarjen e vaksinave më cilësore për imunizimin e popullatës maqedonase.

Lista pozitive e barnave do të rishikohet dhe përditësohet vazhdimisht me përfshirjen e pjesës më të madhe të barnave bazë të cilat qytetarët realisht i përdorin.

Fëmijët nga lindja deri në moshën madhore, në mungesë të sigurimit shëndetësor, do të jenë bartës të veçantë të sigurimit shëndetësor. Efekti i kësaj mase është kujdesi shëndetësor i garantuar për fëmijët. Do të hartohet program i ri për imunizim të detyrueshëm sipas standardeve evropiane, i cili do të përfshijë masa që synojnë tejkalimin e qëndrimit negativ të grupeve të caktuara të popullsisë ndaj procesit të imunizimit.

Do të ndërmerren masa efikase dhe të qëndrueshme për të siguruar terapi adekuate dhe në kohë për kategoritë e pacientëve me sëmundje kronike, sëmundje të rralla, pacientë me aftësi të kufizuara dhe sëmundje malinje.

Për shkak të ndërtimit të sistemit shëndetësor i cili përputhet me nevojat bashkëkohore të qytetarëve, do ta përmirësojmë sistemin në mënyrë infrastrukurore përmes:

- Përfundimit të ndërtimit dhe pajisjes së Spitalit të ri Klinik Universitar në Shtip;
- Analizë gjithëpërfshirëse e të gjitha iniciativave, koncepteve, studimeve dhe projekteve të mëparshme për ndërtimin e objektit të ri për Qendrën Klinike në Shkup, si dhe përmirësimin e kushteve aktuale të punës së Qendrës Klinike "Nënë Tereza";
- Ndërhyrjet infrastrukurore, riekipimi kadrovik dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, si dhe ndërlidhja me Universitetin e Tetovës;
- Ndërhyrjet infrastrukurore, riekipimi kadrovik dhe ngritja e cilësisë së shërbimeve shëndetësore, ndërlidhja me Shkollën e lartë të Mjekësisë dhe Universitetin e Manastirit;
- Modernizimi dhe rikonstruksioni i Spitalit të Përgjithshëm të Qytetit "8 Shtatori";
- Projekt për Klinikën Kirurgjike "Sveti Naum Ohridski" në qendër të Shkupit të shndërrohet në Qendër Urgjente për Traumë "Sveti Naum Ohridski";
- Do të aktivizohet qendra emergjente pediatrike e Klinikës për sëmundje të fëmijëve;
- Vënia në përdorim të krahut spitalor në spitalin e Strumicës;
- Spitali Rajonal në Ohër: riorganizimi i Qendrës së Kardiologjisë "Sveti Stefan" me spitalin special "Sveti Erazmo" në Ohër;
- Rikonstruksioni i Spitalit të Përgjithshëm në Veles;
- Rikonstruksioni i Spitalit të Përgjithshëm në Prilep;
- Përfundimi i ndërtimit dhe pajisjes së Spitalit të Përgjithshëm në Kërçovë; dhe
- Rikonstruksioni i objektit të spitalit psikiatrik në Demir Hisar.

Do të analizohen pajisjet e papërdorura në të gjitha klinikat dhe ISHP dhe do të bëhet plan për përdorimin e plotë efikas të tyre, si dhe program për optimizimin e tyre dhe edukimin e stafit. Gjithashtu, në përputhje me nevojat dhe mundësitë, do të punojmë për modernizimin e pajisjeve mjekësore në të gjitha ISHP.

Fondi për Sigurim Shëndetësor do të përforcojë mekanizmin e tij të kontrollit, nëpërmjet funksionimit të plotë elektronik dhe modernizimit të akteve nënligjore. Në këtë mënyrë do të shmanget dhënia fiktive e barnave, faturimi fiktiv, trajtimi fiktiv i personave, si dhe trajtimi i personave që nuk hyjnë në sistemin shëndetësor. Nëpërmjet ndryshimit të buxhetimit, do të arrihet kalim gradual nga i ashtuquajtimi "buxheti i kushtëzuar" i pagesës së plotë sipas sistemit të grupeve të ndërlidhura diagnostike (GND) deri në qëllimin përfundimtar - braktisje të plotë të buxheteve "të kushtëzuara". Fondi për sigurim shëndetësor do të mundësojë që ato barna që janë në listën pozitive dhe duhet të rimbursohen, të merren nga farmacia me recetë. Parashikojmë rritje të akcizës për alkoolin dhe duhanin, nga e cila do të sigurohen mjete shtesë për trajtimin cilësor të pasojave nga alkooli dhe cigaret.

○ **ОБРАЗОВАНИЕ ЗА ИДНИНАТА**

○ **ARSIM PËR ARDHMËRINË**

Arsimi ka rol kyç në formësimin e personalitetit, identitetit, me theks të veçantë në ruajtjen dhe promovimin e identitetit maqedonas, zhvillimin ekonomik, kohezionin social dhe zhvillimin e demokracisë në një vend. Qeveria do t'i propozojë Kuvendit strategji kombëtare arsimore, të miratuar me konsensus të përgjithshëm, e cila do të përfshijë të gjithë aktorët e procesit arsimor dhe shkencor dhe do të synojë përmirësimin e cilësisë së arsimit në vend. Ajo do jetë udhërrëfyes për zhvillimin e planeve dhe programeve arsimore, metodave të mësimdhënies, librave, përmbajtjeve dhe burimeve digjitale që do të përmirësojnë mësimdhënien dhe mësimin. Strategjia njëkohësisht do të përfshijë arsimin e lartë dhe do të mbështesë dhe stimulojë kërkimet shkencore, zhvillimin e inovacioneve, investimet në infrastrukturën shkencore dhe tërheqjen e studiuesve të talentuar. Qëllimet e Qeverisë në ndërtimin e sistemit arsimor do të garantojë të ardhme më të mirë janë:

- Rritja e mjeteve buxhetore për arsimin nga 3.4% në 5% të bruto prodhimit të vendit;

- Në bashkëpunim me sektorin real, rritje të mjeteve për shkencën e aplikuar në 1% të bruto prodhimit të vendit;
- Përshtatja e arsimit maqedonas me nevojat e tregut të punës dhe me nevojat kombëtare të Maqedonisë;
- Përmirësimi gjithëpërfshirës i infrastrukturës arsimore;
- krijimi i parakushteve që studentët të avancohen në renditjen botërore të dijes;
- zhvillim i përshpejtuar i shkencës dhe pozicionimi i konsiderueshëm i së paku një universiteti maqedonas në renditjen botërore; dhe
- Mbajtja e të rinjve dhe realizimi i potencialit të tyre në Maqedoni.

Arsimi parashkollor do të bëhet nënsistem i sistemit arsimor sepse ka ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për arsim fillor. Programet parashkollore dhe programet e arsimit fillor duhet të jenë të ndërlidhura ngushtë dhe të vazhdueshme.

Do të punohet në revizion gjithëpërfshirës të Konceptit për Arsimin Fillor, si dhe të planeve mësimore dhe programeve për përmirësimin e tyre, për të siguruar gjithëpërfshirje më të madhe në arsim dhe integrim ndëretnik në arsim, të sigurohen kushte për arsim të zbatueshëm teorik dhe praktik sipas nevojave të tregut të punës, duke përforcuar arsimin e dyfishtë.

Qeveria do të krijojë në vazhdimësi kushte infrastrukturore për mësimin me një turn në shkollat dhe qëndrim të zgjatur (mësim gjithëditor), si dhe sigurimin e librit për çdo nxënës për çdo lëndë në arsimin fillor dhe të mesëm, duke filluar nga viti shkollor 2025/2026. Për vitin akademik 2024/2025, Qeveria merr përsipër që librat e gatshme t'ua dorëzojë nxënësve në kohën e duhur.

Për realizimin e suksesshëm të arsimit praktik është e nevojshme përfshirja më e madhe e punëdhënësve, si dhe intensifikimi i bashkëpunimit ndërmjet arsimit dhe sektorit të biznesit. Orientimi profesional dhe këshillimi për karrierë në arsimin fillor do t'u sigurojë nxënësve dhe prindërve informacione përkatëse për mundësitë dhe trendet e ndryshme të karrierës në tregun e punës. Me qëllim të nxitjes së frymës sipërmarrëse tek nxënësit dhe për të lehtësuar kalimin nga shkolla në punësim/vetëpunësim ose arsimim të mëtejshëm, do të mbështesim hapjen e kompanive reale në shkollat e mesme. Në shkollat e mesme vend të rëndësishëm do të kenë qendrat moderne të karrierës, të cilat në mënyrë reale do t'i udhëzojnë nxënësit në mënyrë profesionale.

Qeveria në periudhën 2025 - 2028, do të mundësojë pilot aplikimin e STEM konceptit në sistemin arsimor, sipas kërkesave të prindërve dhe nxënësve, në një numër të caktuar të shkollave fillore dhe të mesme, si dhe në fakultete. Gjithashtu parashikojmë formimin e

qendrave të posaçme për mbështetje të punës me nxënës që kanë dhunti dhe që janë të talentuar.

Si motivim shtesë, por edhe me theksimin e cilësisë dhe performancës, shteti do të përzgjedhë dhe shpërblejë shkollat e suksesshme, respektivisht shkollat shembullore. Shkollat do të zgjidhen për një periudhë të caktuar dhe do të marrin mjete më të mëdha se ato të rregullta, të cilat duhet t'i përdorin në aktivitete që kanë të bëjnë me zhvillimin profesional dhe personal të punonjësve të shkollës dhe në dobi për nxënësit.

Sipas shembujve të vendeve evropiane do të zhvillohen Programe për parandalimin e dhunës në shkolla dhe për mjedis të sigurt shkollor. Programet e parandalimit të dhunës do të nxisin zhvillimin e inteligjencës emocionale, ndjeshmërinë, mbështetjen për shëndetin mendor të nxënësve, komunikimin efektiv dhe mënyrat për të parandaluar shqetësimet, keqkuptimet dhe dhunën tek bashkëmoshatarët. Fokusi i qeverisë do të jetë në parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve si burimi ynë shoqëror më i vlefshëm. Për këto arsye, parashikojmë, për dallim nga tani kur shkollat ruhen nga agjenci private për siguri, që shteti të marrë përgjegjësinë për të garantuar sigurinë e shkollave dhe të të rinjve tanë – nëpërmjet krijimit të një Agjencie të Sigurimit Shtetëror.

Stafi i motivuar mësimdhënës është kusht i domosdoshëm për përmirësimin e cilësisë së arsimit, me ç'rast Qeveria merr përsipër të respektojë partnerët socialë që përfaqësojnë të drejtat e mësimdhënësve. Do të avancojmë avancimin në karrierë të mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional. Në bashkëpunim me fakultetet e mësimdhënies, të cilat do të shndërrohen në fakultete bashkëkohore, jemi të përkushtuar që të krijojmë kuadro sa më kompetente me cilësi të lartë, kompetenca dhe aftësi, të aftë për arsim kreativ dhe modern të të rinjve. Edukimi plotësues i mësuesve dhe bashkëpunëtorëve profesional në studimet e mëtutjeshme pasuniversitare dhe doktoraturës do të vlerësohet në mënyrë të përshtatshme. Qeveria do të krijojë kushte për hapjen e Qendrës për trajnim dhe zhvillim të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve profesional me qëllim të zhvillimit të trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të tyre, mësimin e aftësive të reja dhe qasjeve për punë për stimulim më të madh dhe për sukses gjatë punës.

Do të avancojmë arsimin joformal duke afirmuar, promovuar publikisht dhe duke informuar të rinjtë për llojet e programeve dhe mundësive që ofron arsimi joformal, duke u kujdesur për cilësinë në ofertën e kualifikimeve, duke thjeshtuar procedurat dhe duke shkurtuar afatin kohor për verifikimin e programeve dhe institucioneve.

Qeveria do të punojë në mbështetje sistematike për rivitalizimin e plotë të institucioneve të arsimit të lartë maqedonas. Parashikojmë formimin e Trupit Nacional Koordinues për reformat në arsimin e lartë, shkencën dhe hulumtimin dhe zhvillimin me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të universiteteve dhe institucioneve shkencore, ASHAM,

MASH, komunitetit të biznesit dhe sektorit civil, të udhëhequr nga Qeveria. Në këtë mënyrë do të rimendojmë plotësisht sistemin e arsimit të lartë. Ai duhet të bazohet në inovacione dhe zhvillimin dinamik teknologjik, bashkëpunimin ndërkombëtar me institucionet e arsimit të lartë evropian dhe botëror për të mundësuar standard më të mirë dhe motivim të stafit mësimdhënës për punë kërkimore-shkencore. Nëpërmjet procesit gjithëpërfshirës të digjitalizimit, do të mundësojmë që i gjithë arsimit i lartë të zhvillohet përmes sistemit elektronik.

Vizioni i Qeverisë është që të lidh arsimin e lartë me tregun e punës, veçanërisht nëpërmjet: mbështetjes së modernizimit të programeve të studimit dhe metodave të mësimdhënies dhe mësimi; zhvillimin e punës praktike të studentëve në kompanitë dhe në institucione gjatë studimeve të tyre; përforcimit të programeve për diploma të dyfishta në institucionet e arsimit të lartë; dhe masa inkurajuese për regjistrimin e studentëve në fakultetet e shkencave natyrore-matematikore, tekniko-teknologjike, bioteknike me përjashtim nga participimi dhe pagesa mujore e shtuar.

Pas analizës së bërë gjithëpërfshirëse të profesioneve deficitare, në bashkëpunim me sektorin privat, do të konceptohet program për **vendosjen e kuotës së bursave** për mbështetje të studentëve në të gjitha ciklet e arsimit. Më pas studentët që kanë përfunduar studimet do të punësohen në sektorin publik dhe privat të vendit, gjë që do të reduktojë emigracionin e tyre dhe do të inkurajojë përzgjedhjen e këtyre profesioneve deficitare.

Shkenca duhet të luajë rolin kyç në rritjen e ekonomisë dhe zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë duke krijuar kushte për inovacione dhe përmirësimin e produktivitetit. Me qëllim të nxitjes së veprimtarisë shkencore me vlerë aplikative për Maqedoninë, do të stimulojmë punimet hulumtuese. Sipas një metodologjie të përcaktuar me kujdes, për punimet e botuara në revista me faktor të ndikimit që janë pjesë e *Eeb of Science* (Thompson Reuters) publikimi i tyre do të financohet. Për më tepër, Qeveria merr përsipër t'i paguajë autorit të përmendur kompensim mujor në lartësi prej 50% nga paga e tij aktuale mujore për një periudhë njëvjeçare. Parashihet edhe krijimi i bazës elektronike e të dhënave me revista dhe punime, si dhe subvencionim për qasje falas në revista të shumta shkencore, ku do të kenë qasje të gjithë studentët dhe shkencëtarët nga universitetet në Maqedoni.

Qeveria do të bëjë hartografimin e kushteve infrastrukturore në të gjitha institucionet arsimore. Gjatë mandatit, godinat e Fakultetit të Kulturës Fizike dhe FSHKIK do të përfundojnë dhe do të vihen në përdorim, në përputhje me nevojat e Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi". Rikonstruimi i infrastrukturës do të promovojë efikasitet të energjisë dhe përdorim të burimeve të rinovueshme të energjisë, qasje të shkollave dhe fakulteteve, në mënyrë që të sigurohen kushte dhe qasje më të mirë për studentët dhe punonjësit, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara. Do të investohen mjetet e parashikuara për

rinovim dhe rikonstrukcion të plotë të konvikteve studentore, me qëllim për të siguruar kushte dinjitoze për jetesë dhe mësim studentëve.

Edukimi i personave me aftësi të kufizuara, personave me nevoja të veçanta arsimore dhe kategorive të cenueshme të personave është e drejtë themelore e njeriut dhe shoqëria ka për detyrë ta sigurojë atë. Do të avancojmë arsimin inkluziv përmes mbështetjes së përmirësuar dhe të shtuar për nxënësit me aftësi të kufizuara, asistencë arsimore, teknologji asistuese, staf të trajnuar arsimor dhe mjedis shkollor inkluziv. Shkollat e mesme shtetërore për fëmijët me aftësi të kufizuara do të shndërrohen në shkolla të mesme shtetërore me qendër me resurse ndërsa shkollat e mesme shtetërore për fëmijët me aftësi të kufizuara komplekse në shkolla të mesme shtetërore me qendër ditore për punë të okupuar.

Gjatë mandatit, Qeveria do të rrisë përfshirjen e fëmijëve romë në arsimin fillor dhe të mesëm. Do të vazhdojmë të mbështesim fëmijët romë përmes ndërmjetësve arsimorë dhe bursave.

○ MJEDIS JETËSOR I PASTËR

Mbrojtja e mjedisit jetësor është mënyrë se si të mbrojmë të ardhmen e Maqedonisë. Sfidat ekologjike me të cilat përballemi si shtet na lidhin me sfidat reale kudo në botë. Vizioni ynë është të krijojmë kushte për industrinë të mund të krijojë produkte ekologjike me gjurmë më të pakta të ndotjes dhe vlerë më të madhe të shtuar. Jemi të përkushtuar për zhvillim të gjelbër, i cili përbën vendosjen e rregulloreve ekonomike dhe ligjore që nxisin zhvillimin ekonomik që është i qëndrueshëm për mjedisin jetësor.

Përcaktimet programore prioritare të Qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit do të jenë:

- Plani për sigurimin e ajrit të pastër për të gjithë;
- Menaxhimi dhe trajtimi i mbeturinave;
- Liqenet maqedonase - hapësirë jetësore me rëndësi të lartë nacionale;
- Menaxhimi i burimeve ujore, ujit të pastër dhe rrjedhave lumore;
- Parandalimi dhe mbrojtja e parqeve nacionale;
- Gjelbërimi i qyteteve dhe maleve maqedonase;
- Lufta kundër zhurmës urbane;
- Mbrojtja e të gjitha burimeve natyrore dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike;
- Mbështetja e kërkimeve dhe eko-inovacioneve.

Qeveria do të krijojë një Fond për mjedisin jetësor në të cilin do të depozitohen të gjitha mjetet e paguara nga qytetarët dhe personat juridikë si tarifa mjedisore, kompensimet për mjedisin jetësor dhe kompensime të tjera ekologjike. Fondi i Gjellbër i Maqedonisë do të mbështesë programe speciale për mbështetjen e kompanive startup dhe inovacioneve që do të punojnë në projekte për më pak ndotje, zvogëlimin e pasojave nga ndotja ose zgjidhje pa ndotje të mjedisit jetësor.

Qeveria do të krijojë mekanizma për formimin e organit qendror inspektues me kompetenca në të gjitha nivelet, përgjegjës për trajtimin e ndotjes së mjedisit jetësor dhe mbeturinave. Vendosja e këtillë e mbikqyrjes së mjedisit jetësor do të mundësojë inspektim efikas dhe të drejtë të ndotësve të mjedisit jetësor.

Për të arritur progres në përmirësimin e cilësisë së ajrit, do të investojmë në mënyrë sistematike në zgjerimin dhe mirëmbajtjen dhe funksionimin e rregullt të rrjetit të monitorimit të cilësisë së ajrit, duke përfshirë revizionin e rregullt të rrjetit të sistemit shtetëror për monitorim të automatizuar për cilësinë e ajrit të ambientit, i cili përbëhet nga 21 fiks dhe 1 stacion të lëvizshëm për monitorim automatik për cilësinë e ajrit të ambientit. Zgjerimi i metodave laboratorike të Laboratorit Qendror të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe rritje të kapaciteteve të laboratorit. Do të vendosim sistem gjithëpërfshirës për të mbështetur përdorimin e karburanteve të pastra në transportin e taksi shërbimeve në mënyrë të tillë që operatorët e taksive të lirohen financiarisht për blerjen e automjeteve pa emetim të grimcave të ngurta dhe pa zhurmë (gaz natyror dhe automjete elektrike). Gjithashtu, do të mbështesim komunat gjatë ndërtimit të shtigjeve për biçikleta, zonave për këmbësorë, zonave për trafik të qetë (zona 20), etj.

Qeveria do të inkurajojë përdorimin e numrit më të madh të automjeteve elektrike në trafik. Në këtë drejtim, importi dhe blerja e automjeteve elektrike për pasagjerë do të përjashtohen nga pagesa e taksave dhe doganave me 50% ulje të kostove të regjistrimit të automjeteve, karikuesit të automjeteve elektrike dhe detyrimi për të paktën 5% të pozicioneve për parkim të parashikuara për automjetet elektrike në çdo parking publik i menaxhuar nga kompani publike ose private.

Qeveria ka prioritetin kryesor për trajtimin e ndryshimeve klimatike. Në procesin e trajtimit të këtij problemi, ekziston mundësia për përparim teknologjik, modernizim të proceseve të prodhimit, transportit dhe energjisë. Katër parqet nacionale Pelister, Galiciçë, Mavrovë dhe Mali i Sharrit do të marrin mbështetje financiare sistematike për të përmbushur qëllimin themelor të funksionimit të tyre – mbrojtjen e mjedisit jetësor. Përveç programeve të pyllëzimit të Pyjeve të Maqedonisë, me të cilat do të sigurohen 10 milionë fidanë në vit në zonat rurale dhe malore, në dhe rreth qendrave urbane do të nxiten aktivitetet për mbjelljen e 500.000 fidanëve joalergjenë çdo vit.

Qeveria do të përgatisë plan gjithëpërfshirës për mbrojtjen e ujit të pijshëm dhe hartografin e tyre, si dhe trajtimin e ujërave të ndotura përmes impianteve të trajtimit të ujërave të zeza për të arritur mbulimin prej 80% të shtetit me sisteme për trajtimin e ujërave të zeza. Qeveria do të përgatisë analizë të plotë dhe një plan veprimi për liqenet e Ohrit, Dojranit dhe Prespës, si dhe liqenet e tjerë artificiale.

Në periudhën e mandatit 2024-2028 do të zhvillojmë metodologji për të mbështetur qendrat rajonale për menaxhimin e mbeturinave. Do të mbështesim qendrat rajonale për ngritjen e qendrave të përpunimit të cilat në mënyrë të organizuar do të merren me përzgjedhje dytësore, fitimin e energjisë dhe materialeve nga përpunimi i mbeturinave, fitimin e biokarburanteve dhe reduktimin e sasisë së mbeturinave që depozitohen.

○ KUJDESI SOCIAL

Çdo qytetar meriton mundësinë të jetojë jetë dinjitoze dhe të përmbushur, pavarësisht nga mosha apo statusi i tij shoqëror. Fokusi i programit për mbrojtje sociale ka të bëjë me tre fusha kryesore: lufta kundër varfërisë përmes politikave gjithëpërfshirëse ekonomike dhe sociale; kujdesi për pensionistët; dhe përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara. Qeveria do të jetë plotësisht e përkushtuar për t'u përballur me këto sfida dhe për të ndërtuar sistem më të fortë dhe më të drejtë të kujdesit social.

Për përfituesit e pensionit familjar dhe invalidor, pensioni i tyre llogaritet vetëm nga fondi i parë shtetëror. Prandaj do të vendosim formulë të drejtë për llogaritjen e këtyre pensioneve që të mos dëmtohen të siguarit.

Qeveria do të rrisë kompensimin financiar për të rrezikuarit nga aspekti social dhe fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë rritjen e ndihmës minimale të garantuar, rritjen e shtesës së veçantë, rritjen e ndihmës financiare për kuadriplegji, rritjen e ndihmës financiare për personat plotësisht të shurdhër, rritje të së drejtës së kompensimit të pagës për punën me kohë të shkurtër për prindërit për shkak të kujdesit ndaj fëmijës ose personit me aftësi të kufizuara fizike ose mendore dhe sëmundjeve kronike më të rënda.

Për të siguruar nivel më të lartë të jetës së pavarur për njerëzit me shikim dhe dëgjim të dëmtuar dhe lëvizjen e tyre të papenguar dhe plotësimin e nevojave të tyre të përditshme, do të zbatojmë plan gjithëpërfshirës për mbështetjen dhe ndihmën e tyre.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara fizike gjatë kryerjes së detyrave të tyre të përditshme, do të ndërmerren masa dhe aktivitete për ndërtimin e rampave hyrëse për personat me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha organet e administratës shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe organet e tjera dhe institucionet. Personat me aftësi të kufizuara do të mbështeten për blerjen e mjeteve

speciale dhe të përshtatura, teknologjisë dhe materialeve ndihmëse për arsim, si dhe punësimin në institucionet publike.

Qeveria do të sigurojë program për punësimin e fëmijëve pa prindër dhe kujdes prindëror pas mbushjes së moshës 18 vjeç.

○

○ **KUJDES I DEDIKUAR PËR PENSIONISTËT**

Në vitin e parë të mandatit do t'i rrisim pensionet për 5000 denarë. Në vend të zgjidhjes së mëparshme të nëntë grupeve të pensioneve minimale, do të vendosim një vlerë të vetme të pensionit minimal. Me këtë do të kontribuojmë për një jetë më të mirë dhe më cilësore për qytetarët më të moshuar.

Parashikojmë ndërtimin ose sigurimin e hapësirës për të paktën pesë shtëpi dhe tetë qendra ditore për të moshuarit sipas nevojave. Gjithashtu, Qeveria do të ofrojë mbështetje direkte dhe indirekte për hapjen e shtëpive për të moshuarit. Qeveria do të punojë edhe për hapjen e qendrave të reja ditore në disa lokacione për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara, ku aktiviteti kryesor do të jetë kujdesi ditor, rehabilitimi psiko-social dhe risocializimi.

Me ndryshimet në Ligjin për sigurimin pensional dhe invalidor do t'u mundësohet personave të cilëve u mungon deri në 24 muaj shërbim pensional ta shlyejnë atë dhe të ushtrojnë të drejtën e pensionit të pleqërisë në përputhje me kushtin për minimumin 15 vite sigurim pensional. Për pensionistët që kanë qenë në punë me kohë të plotë deri në kufirin më të lartë të moshës për punë, ne do t'u mundësojmë ligjërisht pjesëmarrjen në tregun e punës pa hequr dorë nga e drejta e pensionit. Gjithashtu, të rinjtë që janë përfitues të pensionit familjar do të mund të punësohen ligjërisht deri në gjashtë muaj gjatë vitit deri në moshën 26 vjeç, me kusht që të jenë studentë ose nxënës të rregullt.

V PRIORITETET NACIONALE

○ **PRIORITETET NË POLITIKËN E JASHTME**

Qëllimi kryesor strategjik i Qeverisë së ardhshme është që Maqedonia të jetë anëtare e plotë e Bashkimit Evropian. Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të jetë partner i

përgjegjshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare, faktor i stabilitetit në rajon dhe më gjerë, si dhe aktor aktiv në zhvillimet globale dhe vendosjen e marrëdhënieve në skenën ndërkombëtare. Në simbiozë ndërmjet politikës së brendshme dhe asaj të jashtme, Republika e Maqedonisë duhet të ndërtojë, por edhe ta përmirësojë vazhdimisht rolin e saj si demokraci e suksesshme evropiane, e cila jep kontribut pozitiv për paqen rajonale dhe botërore, për stabilitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Prioritetet e jashtme-politike të Republikës së Maqedonisë duhet të bazohen në parimet e barazisë, besimit të ndërsjellë, solidaritetit, ndërtimit të unitetit kombëtar për çështjet kyçe për shtetin, dialogut, respektit të ndërsjellë dhe reciprocitetit. Për këtë arsye, Qeveria do të propozojë Strategji të re Nacionale për Politikën e Jashtme. Strategjia do t'i avancojë aktivitetet për realizimin e prioriteteve të politikës së jashtme të Maqedonisë me konsensus të aktorëve politik dhe social, me çka do të sigurohet vazhdimësia në realizimin. Qëllimet kryesore të Strategjisë do të jenë ndërtimi i shtetit për respekt, mbrojtje e interesave kombëtare të Maqedonisë në organizatat multilaterale, ekipimi i plotë kadrovik dhe përparimi profesional i MPJ-së, si dhe ndërtimi i politikës së jashtme konsistente.

Qeveria do të mbetet e përkushtuar ndaj kornizës së sigurisë evropiane dhe euroatlantike dhe përafrimit të plotë të politikës së vendit me politikën e përbashkët të jashtme, të sigurisë dhe mbrojtjes të BE-së, duke kontribuar vazhdimisht në misionet e BE-së për menaxhimin e krizave dhe operacionet e drejtuara nga NATO.

Qeveria do të bëjë përpjekje maksimale për të arritur progres real të dukshëm në procesin e integritit evropian dhe anëtarësimin e plotë në BE. Do të ndërtojë strategji konsistente të politikës së jashtme, e bazuar në radhë të parë në interesin shtetëror dhe me respekt të fortë për vlerat evropiane. Qeveria do të avokojë veçanërisht për shfrytëzimin sa më të shpejtë të përfitimeve të potencialit të tregut të përbashkët evropian, në drejtim të lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit.

Arritja e qëllimit strategjik të anëtarësimit në Bashkimin Evropian duhet të jetë në baza të barabarta dhe reciproke, të bazuara në kritere të matshme dhe objektive. Çdo përpjekje për të hapur diskutim në nivel politik bilateral ose multilateral në lidhje me çështjet identitare dhe karakteristikat e popullit maqedonas konteston vetë-rëndësinë dhe veçantinë maqedonase.

Qeveria do të avokojë fuqishëm për gjetjen e zgjidhjes së përshtatshme krahas lëvizjes reale të procesit të integritit evropian, pa pranuar diktatet e vendeve të treta. Për gjetjen e zgjidhjeve të mundshme lidhur me çështjen e ndryshimeve kushtetuese, e cila tashmë është vënë si kusht për fillimin e negociatave me BE-në, Qeveria do të ofrojë mundësi dhe propozime ligjore dhe legjitime në përputhje me të drejtën dhe parimet ndërkombëtare. Këto propozime do të krijojnë kushte për parashikueshmëri më të madhe të procesit

integruet evropian, të mbrojtur nga kërkesat joparimore, që i njëjti të rezultojë me anëtarësimin e plotë të Maqedonisë në BE. Garantimi i parashikueshmërisë dhe sigurisë që nuk do të vendosen kushte shtesë bilaterale gjatë procesit të negociatave, do ta bëjë më të sigurt rrugën tonë të integritit drejt BE-së. Në angazhimin e ardhshëm diplomatik, Qeveria do të bëjë përpjekje maksimale për të ofruar garanci të mjaftueshme përveç mbrojtjes së identitetit shumë shekullor maqedonas, gjuhës dhe veçantisë maqedonase dhe në këtë drejtim do të kërkojë mbështetje të menjëhershme nga institucionet evropiane, nga fqinjët tanë, aleatët dhe partnerët strategjikë.

Qeveria do të avancojë bashkëpunimin në suazat e organizatave rajonale, iniciativat dhe proceset, avancimin e perspektivave evropiane dhe zhvillimin e marrëdhënieve të bazuara në parimet e besimit të ndërsjellë, rritjes së bashkëpunimit ekonomik dhe tregtar, dialogut të vazhdueshëm dhe respektit të ndërsjellë. Do të vazhdojmë të marrim pjesë në mënyrë proaktive në të gjitha nismat rajonale, por edhe do të insistojmë në zgjerimin e tyre duke përfshirë më shumë vende nga rajoni dhe duke reduktuar zonat ku këto nisma mbivendosen.

Anëtarësimi i plotë në NATO është një shtyllë kyçe për stabilitetin afatgjatë, sigurinë dhe prosperitetin e Maqedonisë. Si vend anëtar i NATO-s, do të vazhdojmë kontributin tonë aktiv në misionet e sigurisë, përfshirë ato të BE-së dhe OKB-së. Në të njëjtën kohë, do të vazhdojmë pjesëmarrjen aktive në operacionet ndërkombëtare që kontribuojnë në sigurimin e paqes dhe sigurisë globale. Përmes këtyre aktiviteteve, Maqedonia do të ndërtohet si një partner i besueshëm dhe i sigurtë në zgjidhjen e sfidave komplekse ndërkombëtare si lëvizjet e paligjshme të migracionit, pasojat e luftërave në territorin evropian dhe më gjerë, kërcënimet globale terroriste, luftërat hibride dhe rreziqet për të drejtat e njeriut dhe demokracisë.

Qeveria do të forcojë aleancat strategjike, veçanërisht në politikë, mbrojtje dhe siguri kibernetike, siguri, migracion, kundër-terrorizëm, ekonomi, investime të qëndrueshme, energjetikë, ndryshime klimatike, zhvillim demokratik, antikorrupsion dhe fusha të tjera.

Diplomacia ekonomike do të jetë një nga prioritetet e politikës së jashtme të Republikës së Maqedonisë, duke promovuar dhe mbrojtur interesat ekonomike të shtetit, me qëllim të integritit tonë më të suksesshëm në rrjedhat ekonomike rajonale dhe globale. Qeveria do të forcojë aktivitetet ekonomike të përfaqësive diplomatike-konzulare maqedonase, veçanërisht në sferën e tërheqjes së investitorëve në Maqedoni. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tërheqjes së investimeve inovative, investimeve shumë produktive dhe atyre që do të ngrisin nivelin e bashkëpunimit të kompanive të huaja me industrinë vendase dhe do të ndihmojnë në nxitjen e rritjes ekonomike dhe zhvillimit ekonomik të shtetit.

Obligim i shtetit është kujdesi i vazhdueshëm për pakicën maqedonase në shtetet fqinje në përputhje me rregulloret pozitive të brendshme juridike dhe respektimin e plotë të obligimeve të përfshira në Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare të Këshillit të Evropës dhe Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.

Qeveria do të hapë një kapitull të ri të marrëdhënieve dhe politikave ndaj diasporës maqedonase. Globalizimi i përshpejtuar, përmirësimi i komunikimeve dhe lidhjeve në komunikacion hapin një mundësi të re për integrimin e diasporës maqedonase në sfidat e përditshme, nevojat dhe mundësitë e shtetit. Me rëndësi të veçantë është përmirësimi i prezencës së Republikës së Maqedonisë kudo ku ekziston diaspora maqedonase, rritja e komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme të maqedonasve në mbarë botën. Në këtë drejtim do të zhvillohet Strategji Nacionale për bashkëpunim me diasporën. Me përmirësimin e punës e rrjetit të përgjithshëm të misioneve diplomatike-konzulare, do të përmirësojmë cilësinë dhe numrin e shërbimeve konzulare për shtetasit maqedonas me qëllim të realizimit efektiv të të drejtave të tyre sociale dhe qytetare.

Qeveria do të formojë Këshillin për Diplomaci Ekonomike dhe Këshillin për Diplomaci Shkencore, me qëllim të shfrytëzimit të potencialit të përgjithshëm të mërgimtarëve maqedonas. Këshillat do të synojnë rrjetëzimin e potencialeve shkencore dhe kahjen e tyre drejt ideve dhe projekteve për përmirësimin e gjendjes së përgjithshme në Republikën e Maqedonisë, veçanërisht në sferën e arsimit, teknologjisë dhe digjitalizimit, ekonomisë dhe biznesit.

Do të zyrtarizohen mekanizmat për angazhimin e diasporës në diplomaci, duke i mundësuar Maqedonisë të shfrytëzojë ekspertizën, rrjetet dhe resurset e diasporës. Kujdesi për maqedonasit dhe qytetarët maqedonas që jetojnë jashtë vendit dhe ndërtimi i lidhjeve të forta me ta janë prioritetet kryesore në punën e qeverisë së ardhshme.

Qeveria do të sigurojë sasi të shtuar të bursave shtetërore për studentët më të mirë maqedonas nga diaspora dhe fqinjësia. Këto bursa do të synohen për studime universitare dhe pasuniversitare në universitetet shtetërore.

Qeveria do të bëjë plan për themelimin e qendrave të reja kulturore dhe informative në fqinjësi, nëpër qendrat më të mëdha në Evropë dhe në botë me qëllim të përforcimit dhe promovimit të artit, kulturës dhe veçorive maqedonase.

Do t'i qasemi revizionit të rrjetit diplomatik-konzular të Republikës së Maqedonisë dhe do ta përshtatim me resurset dhe nevojat që disponon Ministria e Punëve të Jashtme dhe nevojat tona përveç përmbushjes së qëllimeve dhe prioriteteve të përcaktuara në kuadër të një strategjie të re të politikës së jashtme.

Në kontekst të përfaqësimit adekuat të vendit, do të përforcohen kapacitetet diplomatike të shtetit, do të përmirësohet cilësia e përfaqësive diplomatike-konzulare, përfaqësimi jorezident i vendeve nga ambasadat ekzistuese, pra ambasadorët tanë jashtë vendit, përfaqësimi jorezident i vendeve të caktuara nga ambasadorët në Ministrinë e Punëve Jashtme dhe paralelisht do të përforcohen kapacitetet njerëzore, materiale dhe teknike në PDK tona jashtë vendit. Ministria për Punë dhe Tregti të Jashtme do të përpiqet të rrisë shkallën e digjitalizimit të proceseve diplomatike dhe të ekzekutimit të numrit më të madh të shërbimeve konzulare, duke i bërë ato shumë më të qasshme për përdoruesit e tyre, duke aplikuar dhe përdorur në mënyrë më efektive përfitimet e teknologjisë moderne e cila në të njëjtën kohë do të krijojë kushte për përmirësimin e procesit të përgjithshëm të menaxhimit, veprimit, angazhimit, përgjegjësisë dhe efikasitetit të rrjetit tonë diplomatik-konsullor dhe diplomacisë në përgjithësi.

Në lidhje me negociatat për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian, do të bëhen përpjekje për intensifikimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Maqedonisë dhe institucioneve të Bashkimit Evropian, shfrytëzimin më të mirë të fondeve evropiane nga institucionet dhe subjektet maqedonase, forcimin e kapaciteteve të institucioneve shtetërore dhe palëve të tjera të interesuara në mënyrë që të jenë të gatshëm të marrin përsipër të gjitha detyrimet e anëtarësimin në BE dhe të mbështesin ekonominë vendase për të marrë pjesë në flukset ekonomike evropiane.

Gjatë mandatit, do të përmirësohet dukshëm struktura për negociata ndërmjet Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian, duke pasur parasysh Planin e ri për Rritje të Bashkimit Evropian. Ky proces do të përfshijë fuqizimin dhe avancimin e resurseve njerëzore dhe ristrukturimin e proceseve negociuese, si dhe përfshirjen e profesorëve nga universitetet më të mira të Maqedonisë dhe ekspertëve në procesin e negociatave. Gjithashtu do të përforcohen kapacitetet përkthimore dhe interpretuese të gjuhës maqedonase, me qëllim të përgatitjes me kohë dhe në mënyrë cilësore të versionit kombëtar të legjislacionit evropian dhe ofrimin e mbështetjes cilësore gjatë negociatave për anëtarësim. Do të praktikojmë dinamikë të shpejtë reformash, të cilat do të zhvillohen paralelisht me negociatat, por të pavarura prej tyre. Do të udhëhiqemi nga praktikat evropiane gjatë reformimit të gjyqësorit, trajtimit të korrupsionit, ndërtimit të rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe reformat strukturore shoqërore.

Qendra e trajnimit në kuadër të Sekretariatit për Çështje Evropiane do të zgjerohet dhe forcohet në Akademinë e BE-së. Akademia e BE-së do të synojë monitorimin dhe forcimin e vazhdueshëm të kapaciteteve në procesin e anëtarësimin për shfrytëzim më të mirë të fondeve evropiane, si dhe shkëmbimin e praktikave dhe njohurive të mira me Qendrat e Trajnimit të BE-së të vendeve kandidatë dhe vendeve anëtare të BE-së.

Qeveria do të bëjë përpjekje për të përsheptuar aktivitetet bilaterale për hapjen e më shumë pikave kufitare, duke përfshirë:

- PK Berovë – Sandanski;
- PK Markova Noga (Prespë);
- PK Pulevac Kavadar – Voden;
- PK Strezimir – Restelicë;
- PK Xhepisht – Trebisht.

○ **SIGURI DHE MBROJTJE**

Sistem i fortë dhe i mirëkoordinuar i sigurisë nacionale është themeli i një Maqedonie të qëndrueshme dhe të prosperuar. Ai sistem përfshin sigurinë e brendshme, mbrojtjen sipas standardeve më të larta, mbrojtjen civile dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Programi i Qeverisë si prioritet kryesor e vendos mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve të Maqedonisë. Prioritetet e Qeverisë në këtë drejtim janë:

- Masat për të inkurajuar transparencën gjatë punës së institucioneve të sigurisë, duke siguruar mbikëqyrje publike dhe llogaridhënie;
- Programe të përhershme për trajnimin dhe zhvillimin profesional të personelit në të gjitha institucionet e sigurisë, duke i pajisur ata me aftësi dhe njohuri për t'u përballur me kërcënimet moderne të sigurisë;
- Përmirësimi i kushteve të punës, për të tërhequr dhe mbajtur stafin më cilësor, duke ndërtuar një shërbim profesional, cilësor dhe dinjitoz;
- Ndërtimi i një sistemi për siguri të qëndrueshme dhe të integruar.

Ndërtimi i sistemit efikas të sigurisë nacionale nuk ekziston vetvetiu, dhe për këtë arsye ne e njohim rëndësinë e partneriteteve të forta ndërkombëtare për të trajtuar në mënyrë efektive kërcënimet transnacionale dhe përforcimin e stabilitetit rajonal. Në këtë drejtim, do të thellojmë bashkëpunimin me NATO-n dhe BE-në, bashkëpunimin bilateral dhe rajonal, duke ndërtuar partneritete për përgjigje të përbashkët ndaj çështjeve kryesore të sigurisë dhe duke kontribuar në përpjekjet e mbrojtjes kolektive.

Parashikojmë zhvillimin e strategjive për punë policore e orientuar drejt komunitetit, me qëllim forcimin e besimit dhe bashkëpunimit mes policisë dhe qytetarëve. Nëpërmjet qasjes proaktive dhe të përbashkët midis policisë dhe komunitetit, do të punojmë për të zgjidhur problemet e sigurisë lokale, për të reduktuar krimin dhe për të ndërtuar një mjedis jetese të sigurt. Qeveria do të avancojë sistemin “Qytet i sigurt”. Në këtë mënyrë do të rritet

siguria e qytetarëve. Do të vendosim mbikëqyrje me video në disa lokacione, veçanërisht në qytetet e mëdha, korridoret kryesore rrugore dhe pikat kufitare.

Bashkëpunimi ndërinstucional do të forcohet dhe promovohet ndërmjet të gjithë aktorëve, fokusi i të cilëve është lufta dhe zbulimi i terrorizmit në nivel nacional, rajonal dhe ndërkombëtar.

Respektimi i sovranitetit territorial, integritetit, rëndësisë së vetes, autonomisë dhe pavarësisë së shtetit janë të një rëndësie të jashtëzakonshme. Do të luftojmë sistematikisht kundër mohimit të së drejtës për ekzistencë të popullit maqedonas, gjuhës, kulturës dhe identitetit të tij.

Nëpërmjet masave dhe aktiviteteve sistematike, sistemi i sigurisë do të përditësohet në mënyrë që të ketë kapacitet për t'iu kundërvënë të gjitha formave të krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë edhe brenda radhëve të veta. Do të bëhen përpjekje për reduktimin dhe shtypjen e korrupsionit në mesin e personave me kompetenca policore dhe zyrtare, duke forcuar mekanizmin e kontrollit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtorinë Doganore, Policinë Financiare, Policinë e Burgjeve dhe Pyjeve, me qëllim të zhvillimit të hetimeve kundër personave me kompetenca policore. Do të përditësohen kapacitetet për bashkëpunim dhe veprim të përbashkët me Prokurorinë Publike për ndjekjen e krimit të organizuar dhe korrupsionit. Në këtë drejtim parashikohet formimi i organit koordinues për luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, i cili do të përfshijë: Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Financave, Agjencinë e Zbulimit dhe Agjencinë e Sigurisë Kombëtare, Drejtorinë Doganore, Drejtorinë e të Ardhurave Publike, Drejtorinë e Policisë Financiare dhe Agjencia e Zbulimit Financiar.

Në bashkëpunim me ekspertët vendas dhe sektorin civil me qëllim arritjen e mbështetjes së gjerë qytetare dhe eksperte, është planifikuar bashkimi i Agjencisë për Zbulim dhe Agjencisë së Sigurisë Nationale në një shërbim të vetëm modern për siguri dhe zbulim. Agjencia do të udhëhiqet nga profesionistë të lartë të përzgjedhur sipas kriterëve rreptësisht të përcaktuara sipas standardeve të BE-së dhe NATO-s. Për funksionimin e duhur të Agjencisë, parashikojmë ndërtimin e një objekti krejtësisht të ri për këtë qëllim, bazuar në standardet strikte të sigurisë së NATO-s, jashtë kompetencave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Forcimi i kuadrove të Ministrisë së Punëve të Brendshme për t'u përballur me krimin kibernetik dhe sulmet dhe mashtrimet e shpeshta me të cilat ekspozohen qytetarët në internet. Edukimi i vazhdueshëm i ekspertëve të organeve gjyqësore dhe ligjzbatuese në fushën e sigurisë kibernetike, krimit kibernetik dhe dëshmive elektronike.

Parashikojmë reformimin e Byrosë së Sigurisë Publike me qëllim rritjen e efikasitetit të punës së policisë dhe afrimin e policisë me qytetarët. Nëpërmjet të digjitalizimit të

sistemit të të gjitha proceseve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, do të inkuadrojmë procedura digjitale të menaxhimit të dokumenteve, menaxhim elektronik të rasteve (e-case management) dhe lidhjen kriptokomunikuese të subjekteve të sigurisë nacionale. E njëjta reformë do të kryhet edhe në shërbimet drejtuese në fushën e rritjes së efikasitetit në dhënien e dokumenteve personale. Për të eliminuar problemet si pritja e tepërt për termin, abuzimet me ndikime për të favorizuar qytetarë gjatë marrjes së termineve pa rend, pritjet në turma, do të krijohet një sistem funksional, i cili do të lidhet me sistemin elektronik të dhënies së dokumenteve personale në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Do të vendoset sistem elektronik për parashtrimin dhe monitorimin e kërkesave për marrjen e lejes për mbajtjen dhe përdorimin e armëve.

Do të inkuadrojmë sisteme të avancuara efikase dhe të integruara për mbikëqyrjen dhe kontrollin online të kufirit shtetëror, sigurimin teknik të kufirit përmes instalimit të sensorëve dhe kamerave, patrullimet e shpeshta të përziera me policinë kufitare të shteteve fqinje, mbulimin e plotë të të gjitha pikave të rrezikut përmes hartografimin e saktë, si dhe krijimin e një sistemi efikas nacional për kontroll të migracionit.

Parashikohet rikonstrukcioni dhe përditësimi i vazhdueshëm i komisariateve policore dhe objekteve të tjera policore për të siguruar kushte moderne për punën e punonjësve të policisë, si dhe modernizimin e uniformave të punës në polici.

Do të bëhet qasje drejt riorganizimit të Qendrës së Trajnimit, i cili duhet të mundësojë ngritjen e vazhdueshme të njohurive dhe aftësive të pjesëtarëve të strukturave të sigurisë. Do të futen programe moderne dhe trajnime të specializuara në fushën e sigurisë, zbulimit, mbrojtjes dhe mbrojtjes civile. Do të bëhet rikonstruimi i objekteve ekzistuese akomoduese dhe administrative, rikonstruimi dhe ndërtimi i klasave dhe amfiteatrit të ri, ndërtimi i poligoneve të gjuajtjes të tipit të mbyllur dhe të hapur, rikonstruimi dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja sportive dhe objekteve për simulim dhe ushtrime. Do të vendoset bashkëpunim me institucionet e arsimit të lartë në fushën e sigurisë dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë në përputhje me nevojat e institucioneve shtetërore, me të cilën do të mundësohet ofertë për studentët më të mirë të punësohen në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në shërbimet e sigurisë. Gjithashtu parashikohet të përmirësohet sistemi ekzistues për evidencë dhe monitorim të nivelit të trajnimit të të gjithë punonjësve policorë, si dhe përmirësimin e strukturës organizative të njësive në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe BSP-së përgjegjëse për trajnime.

Me ndryshimet në procedurën e punësimit, personat që kanë kryer shërbimin vullnetar ushtarak do të marrin pikë shtesë në procesin e punësimit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Armatën e Republikës së Maqedonisë, strukturat e sigurisë, shërbimet e mbrojtjes dhe shpëtimit, zjarrfikësit dhe shërbime të tjera përkatëse.

Departamenti i Policisë së Pyjeve do të transformohet dhe transferohet në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme me qëllim parandalimin dhe zbulimin e autorëve të krimeve kundër mjedisit jetësor dhe natyrës.

Do të vendosim kritere objektive, transparente, të qarta dhe strikte për punësimin në Armatë, bazuar në ekspertizën, cilësinë dhe sipas nevojave të vendit të punës. Do të sigurojmë zhvillim profesional cilësor të oficerëve dhe nënoficerëve në ARM. Do të vendosim kritere transparente dhe të qarta për përzgjedhjen dhe referimin e punonjësve në trajnime profesionale, në misione diplomatike jashtë vendit dhe në misione paqësore bazuar në ekspertizën, meritën dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare dhe të NATO-s.

Prioriteti ynë është zgjidhja e çështjes së banimit për punonjësit e armatës, përmes një programi për ndërtimin e banesave për personelin e armatës, si dhe përfitime për marrjen e shtëpisë apo banesës personale në kuadër të programeve ekzistuese të shtetit. Qeveria do të punojë për përmirësimin e standardit të jetesës së punonjësve dhe familjeve të tyre gjatë përdorimit të pushimeve vjetore dhe për praktikimin e aktiviteteve rekreative që janë pjesë e planeve të njësive dhe specialistëve me rëndësi të veçantë për mbrojtjen. Do të krijojmë kushte për të mundësuar mbështetje cilësore gjatë procesit të përgatitjes për kthimin në jetën civile të ushtarëve profesionistë duke i lidhur ata me institucionet e tjera shtetërore që kanë nevojë për personel të përgatitur dhe të arsimuar për sigurinë.

Do të krijojmë mundësi për shfrytëzimin kreativ të kapaciteteve të Armatës në kushte paqësore me qëllim që resurset që investohen në sektorin e mbrojtjes të shfrytëzohen për mbrojtjen civile të qytetarëve maqedonas.

Do të zhvillojmë plan për investim shumëvjeçar për përmirësimin e kushteve të punës, nëpërmjet rikonstruksionit dhe rinovimit të kazermave. Armatën maqedonase do ta pajisim me armatimin e nevojshëm të këmbësisë, mjete për transport, sisteme për komunikim, pajisje mbrojtëse dhe zhvillimore dhe do të modernizojmë sistemet e komunikimit dhe informimit, me qëllim të një armate efikase, moderne dhe të digjitalizuar.

Forcimi i rolit të grave është një nga parimet themelore të demokracisë. Përfaqësimi adekuat i grave në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe institucionet e tjera nga sektori i zbulimit dhe sigurisë do të garantojë respektimin e vërtetë të parimeve të barazisë gjinore.

Do të hapim një diskutim të gjerë ekspertësh dhe debat publik për nevojën e funksionalizimit të sistemeve për mbrojtjen civile dhe menaxhimin e krizave, me synim

shfrytëzimin optimal të këtyre sistemeve dhe rritjen e efikasitetit dhe kohezionit të aktorëve të ndryshëm në funksionim.

Do t'i përkustohemi përmirësimit të standardit të jetesës dhe kushteve të punës të punonjësve në njësitë e zjarrfikësve. Në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes lokale do të zhvillojmë plan shumëvjeçar për investime në mjete dhe pajisje zjarrfikëse për rritjen e efikasitetit dhe kushteve të punës së njërive zjarrfikëse. Zhvillimi i shuarjes vullnetare të zjarrit është një nga prioritetet, duke ndjekur ekskluzivisht shembullin e vendeve evropiane.

Në njësitë republikane të mbrojtjes territoriale nga zjarri do të formohen njësi specialistike për ndërhyrje nga alpinizmi, kërkim në terren nga rrënojat dhe ortekët, ndërhyrjet në ujë dhe nën ujë, ndërhyrjet për mbrojtjen nga kafshët e rrezikshme dhe do të jenë në koordinim me institucionet e tjera me kompetenca të ngjashme.

○ KULTURA – SHTYLLË E SHTETIT

Kultura, si bartëse kryesore e identitetit dhe zhvillimit, kultura me të gjitha mekanizmat institucionale i mbron interesat kombëtare maqedonase dhe i vë në funksion të avancimit të shoqërisë. Kultura është gjithashtu faktor integruar i shoqërisë, popullit dhe shtetit. Objektivat kryesore të programit të kulturës janë:

- Kthimi i kulturës nacionale si shtyllë bazë shoqërore, në funksion të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, promovimit dhe afirmimit të identitetit nacional dhe vlerave kulturore me shumë shtresa, materiale dhe shpirtërore të Maqedonisë;
- Kujdesi dhe mbrojtja e gjuhës maqedonase;
- Reforma e sistemit të financimit dhe burimeve financiare shtesë për të mbështetur kulturën;
- Nxitja e cilësisë dhe lirisë në krijimtarinë artistike;
- Forcimi i kapaciteteve kadrovike në institucionet në fushën e kulturës në të gjitha nivelet, kujdesi për vlerësimin dinjitoz të punës dhe statusit të artistëve dhe punonjësve të kulturës;
- Krijimi i programeve të përshtatshme kulturore dhe kulturore-edukative për zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve dhe të rinjve në drejtim të nxitjes së krijimtarisë së tyre;
- Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe privat, shoqërisë civile dhe bashkësive lokale për avancimin kolektiv të zhvillimit kulturor;
- Digjitalizimi i plotë i institucioneve në fushën e kulturës, krijimtarisë artistike dhe trashëgimisë kulturore;
- Krijimi i politikave për përfshirjen shoqërore, sociale dhe kulturore të personave të marginalizuar dhe personave me aftësi të kufizuara;

- Vizibilitet dhe njohje më e madhe e kulturës maqedonase në suaza ndërkombëtare.

Mirëmbajtja e gjuhës maqedonase si simbol i identitetit nacional është një nga prioritetet e Qeverisë. Për këtë qëllim do të financohen projekte shkencore dhe do të zbatohen aktivitete për përdorimin korrekt të tij. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet mësimin të gjuhës maqedonase si gjuhë e përbashkët e mirëkuptimit në vend dhe përforcimit të kohezionit social. Në bashkëpunim me universitetet vendase, bashkësitë lokale dhe sektorin privat, planifikojmë organizimin e shkollave verore ndërkombëtare dhe kampeve. Qeveria do të punojë në konsolidimin e pozitës së gjuhës maqedonase në nivel global, do të promovojë përdorimin dhe mësimin e saj në vendet ku jetojnë dhe qëndrojnë qytetarët maqedonas dhe pjesëtarët e diasporës, do të mirëmbajë ato ekzistuese dhe do të hapë lektorate dhe kurse të reja në gjuhën maqedonase në universitetet jashtë vendit, si dhe do të bëjë përpjekje për rritjen e bashkëpunimit shkencor në fushën e kulturës.

Prioritet për Qeverinë është ruajtja dhe konsolidimi i identitetit kulturor të popullit maqedonas dhe të bashkësive tjera etnike. Mbështetja financiare për ansamblet folklorike në qytetet anembanë Maqedonisë do të rritet për funksionimin e tyre, sigurimin e mjeteve bazë, kujdesin, prodhimin dhe riprodhimin e këngëve dhe valleve origjinale nga Maqedonia, si dhe të veprave qytetare të vjetra tradicionale muzikore dhe instrumenteve.

Do të punojmë për sigurimin e kushteve më moderne hapësinore për Institucionin Nacional “Tanec” si ansambël i parë folklorik profesional shtetëror në Maqedoni. Do të mbështesim në vazhdimësi ri-ekipimin dhe edukimin e mëtejshëm të ansamblit dhe orkestrës.

Do të formohet Komision Nacional i cili do të synojë vendosjen e standardeve të emrave gjeografikë. Ky komision do të ketë obligim që të zhvillojë program për mbrojtjen e emrave gjeografikë maqedonas dhe markave tregtare të produkteve.

Do të ofrohet mbështetje e vazhdueshme për kultivimin e formës së folur dhe të shkruar të gjuhëve të bashkësive etnike në krijimtarinë artistike në Maqedoni, si dhe promovimin e vazhdueshëm të diversitetit të pasur kulturor, ndërkulturalizmit dhe specifikave kulturore identitare.

Mbrojtja e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale do të sigurohet nëpërmjet:

- Valorizimit dhe rivlerësimit të vazhdueshëm të trashëgimisë kulturore;
- Kërkimi arkeologjik, konservimi dhe restaurimi i arkitekturës profane dhe sakrale në komplekset urbane dhe bërthamat e qytetit, sipas shkallës së rrezikshmërisë së tyre;
- Mbrojtja dhe restaurimi i pasurisë së tundshme;

- Identifikimi i vazhdueshëm, valorizimi dhe regjistrimi i pasurive jomateriale në Regjistrin Nacional të Trashëgimisë Kulturore;
- Laboratori i ri Qendror i Konservimit për trashëgiminë kulturore të tundshme dhe të patundshme;
- regjistrimi i pasurive kulturore në listën e trashëgimisë kulturore botërore dhe në listat e tjera të trashëgimisë kulturore të UNESCO-s; dhe
- Krijimi i politikave dhe zhvillimi i programeve për promovimin dhe popullarizimin e trashëgimisë kulturore.

Parashikojmë rritje të mbështetjes dhe stimulimit të krijimtarisë bashkëkohore muzikore dhe muzikore-skenike, dramatike, artistike, filmike dhe letrare. Do të stimulojmë krijimtarinë artistike duke shpallur konkurse për blerjen e veprave më të mira të artit në fushën e muzikës, dramës, filmit, artit dhe botimeve letrare. Do të rrisim mjetet për prodhimin e filmave të rinj maqedonas dhe serialeve dramatike në gjuhën maqedonase.

Do të zhvillohet program për shpërndarjen e vazhdueshme të kulturës në nivel rajonal dhe lokal për të pasuruar jetën kulturore në komunat dhe për të mundësuar pjesëmarrje më të madhe kulturore të popullatës lokale.

Do të rrisim dukshëm mbështetjen e produksionit muzikor, filmik dhe televiziv për fëmijë dhe të rinj në gjuhën maqedonase.

Promovimi i statusit të artistëve dhe punës së tyre, si dhe të gjithë punonjësve të kulturës do të jetë fokusi ynë. Do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë përmirësimit të kushteve të tyre për krijimin dhe punën.

Qeveria do të punojë për të njohur dhe stimuluar dimensionin ekonomik, prodhues dhe fitimprurës të industrisë kreative dhe kulturore, përmes Këshillit Nacional për Industrinë Kulturore dhe Kreative (IKK) dhe mbështetjes për krijimin e brendeve të njohura maqedonase.

NDËRTIMI I INFRASTRUKTURËS NË KULTURË 2025 _ 2034:

- Sigurimi i kushteve hapësinore më të përditësuara për IN "TANEC";
- Përfundimi i kompleksit Pllaoshnik në Ohër, i Sallës Universale në Shkup, si dhe i teatrove në Strumicë dhe Tetovë dhe objekti i Teatrit Turk në Shkup;
- Rikonstruimi i objekteve të Qendrave të Kulturës në Manastir, Shtip dhe Kumanovë;
- Rikonstruimi me rindërtim dhe zgjerim të objekteve të Qendrës së Kulturës "Marko Cepenkov" - Prilep dhe Qendrës për Kulturë "Grigor Prliçev" - Ohër, me qëllim të ofrimit të objekteve të reja të destinuara për Teatrin "Vojdan Chernodrinski" - Prilep dhe Teatrit Kombëtar "Grigor Prliçev" - Ohër;

- Rivitalizimi i monumentit të kulturës "Havzipashini konaci" dhe përdorimi i tyre për qëllime kulturore, arsimore dhe turistike;
- Rikonstruimi i kompleksit muzeor të Muzeut të Maqedonisë;
- Rikonstruimi dhe rehabilitimi i hapësirës administrative dhe sallave artistike për prova të Operës dhe Baletit të Maqedonisë dhe sigurimi i instrumenteve të reja për prova;
- Projektimi dhe ndërtimi i objekteve moderne për Teatrin e Dramës, Teatrin e Komedisë dhe Teatrin për Fëmijë dhe të Rinj;
- Përgatitja e dokumentacionit të projektit për ndërtimin e objektit të ri modern të Galerisë Kombëtare të Maqedonisë;
- Rikonstruimi i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare "Shën Kliment Ohridski" – Shkup.

○ TURIZMI I ZHVILLUAR

Qëllimi kryesor i Qeverisë në zhvillimin e turizmit është rritja e vazhdueshme e numrit të turistëve përmes ndërtimit të modeleve të reja për zhvillimin e turizmit, krijimin e formave të reja të turizmit, brendimin e produkteve, përforcimin e burimeve njerëzore në sektorin e hotelarisë dhe turizmit dhe promovimin e Maqedonisë si një destinacion tërheqës turistik me përmbajtje të pasur turistike.

Maqedonia posedon potenciale natyrore dhe kulturore për zhvillimin e llojeve selektive të turizmit, autenticitetin, ambientin, ushqimin dhe specialitetet autoktone, zanatet unike dhe manifestimet autentike kulturore. Në të njëjtën kohë, zhvillimi i turizmit duhet të përfshijë aspektet më të rëndësishme të Qëllimeve Botërore për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Në bashkëpunim me fakultetet e specializuara në fushën e turizmit dhe komunitetin profesional në Maqedoni, do t'i qasemi përgatitjes së një Strategjie nacionale për zhvillimin e turizmit, e cila do të përmbajë plane konkrete veprimi me një model të ri të mbështetjes shtetërore të turizmit dhe kritereve objektive për kategorizimin e të gjitha objekteve turistike.

Me qëllim inkuadrimit të zbatimit uniform të ligjeve në turizëm dhe për të shmangur mbivendosjen e kompetencave të inspektiveve të ndryshme, krijohet organ qendror që do të ketë rol parandalues, kontrollues dhe mbikëqyrës në turizëm.

Në kuadër të projektit shtetëror për transformimin e plotë digjital, do të reduktojmë procedurat administrative edhe në turizëm. Turistët do të regjistrohen në mënyrë elektronike përmes një sistemi të lidhur: objekte akomoduese - Ministria e Punëve të

Brendshme - komunat, për të monitoruar realisht numrin e turistëve, vendin ku ata qëndrojnë, kohëzgjatjen e qëndrimit etj.

Qeveria do të punojë për zhvillimin e infrastrukturës turistike, zhvillimin e strukturuar të produkteve me vlerë të shtuar më të madhe dhe zhvillimin e formave të veçanta të turizmit, me qëllim krijimin e kushteve për një zhvillim më të ekuilibruar dhe të qëndrueshëm të turizmit. Në këtë drejtim do të promovojmë turizmin urban, turizmin rural, etnoturizmin, turizmin dimëror, turizmin malor, turizmin liqenor, turizmin tranzit, turizmin e gjuetisë, turizmin e banjës, turizmin e kampingut dhe turizmin e aventurës.

Me investime gjithëpërfshirëse në infrastrukturë, Ohri do të pozicionohet në hartën e qendrave botërore për turizëm konferencial (MICE) për organizimin e konferencave ndërkombëtare dhe ngjarjeve të biznesit.

Qeveria do të nisë fazën e dytë të zbatimit të projektit të teleferikut Vodno, duke nisur nga piedestali i parkut pyjor.

Për të arritur turizmin në 365 ditë të vitit, do të nisim bisedimet me Shqipërinë dhe Greqinë për të formuar një zonë të përbashkët turistike mes të tre vendeve, në zonën e liqenit të Ohrit, Prespës dhe Kosturit dhe ski qendrave ekzistuese dhe potencialisht të reja.

Qeveria do të zhvillojë një program gjithëpërfshirës për promovimin e objekteve vendore turistike dhe hotelierike për qytetarët maqedonas, si dhe aktivizimin e udhëtimeve rinore dhe udhëtimeve për pensionistët me qëllim të rritjes së numrit të vizitave në vendet turistike vendore.

Do të përkrahet organizimi i panairit ndërkombëtar të turizmit që do të promovojë potencialin e përgjithshëm turistik të Maqedonisë. Do të inkurajojmë pjesëmarrjen në panairët ndërkombëtare të turizmit.

Qeveria do të punojë për përmirësimin e arsimit profesional në turizëm, përmes punës praktike në shkollat e mesme, bashkëpunimit me kompani nga ekonomia, modernizimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve mësimore. Me qëllim për të rritur interesin për degë të veçanta shkencore, si dhe për të pasuruar stafin që merret me turizmin, do të inkurajojmë krijimin e një grupi studimor të specializuar për punën në kulturë për qëllime turistike.

○ **SPORTI: KRENARI NACIONAL**

Qeveria do të investojë shumë në infrastrukturën sportive për suksese të larta, por edhe do të inkurajojë përfshirjen e fëmijëve dhe të rinjve në angazhim të përhershëm sportiv. Qeveria do të hartojë një Strategji nacionale afatgjate për sport me qëllim për të identifikuar

situatën në sport dhe problemet me të cilat përballen aktualisht sportistët dhe subjektet sportive në vend. Këto masa dhe aktivitete gjithëpërfshirëse do të sjellin suksese të reja në sportin maqedonas. Qëllimet tona në mandatin katërvjeçar janë:

- Mundësi për çdo fëmijë të merret me sport;
- Kombëtares tona të jenë vazhdimisht të pranishme në garat ndërkombëtare sportive;
- Infrastruktura sportive të jetë e modernizuar dhe e aksesueshme;
- Të ushqejë kulturën e sportit dhe të lojës së ndershme.

Qeveria do të propozojë një Ligj të ri për sportin, i cili do të synojë të përcaktojë qartë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve sportive, mënyrën e financimit, kompetencat mbi objektet sportive, çmimet dhe mirënjohjet, sportet shkollore dhe universitare, si dhe mbikëqyrjen e punës së organizatave në fushën e sportit. Mbështetja e shtuar financiare, sipas kriterëve të qarta, do të përfshijë federatat sportive, klubet, sportistët dhe ekipet profesionale.

Do t'u mundësojmë të gjithë sportistëve që mund të dëshmojnë se kanë qenë sportistë profesionistë në të kaluarën, në kushte të caktuara, të shlyejnë përvojën e tyre për të ushtruar të drejtën e pensionit. Në të njëjtën kohë, do të zhvillohet një Program për punësimin e sportistëve individualë të suksesshëm në sektorin publik (ushtri, polici apo institucion tjetër) për të siguruar punësim të qëndrueshëm gjatë dhe pas përfundimit të karrierës sportive. Për këtë qëllim do të planifikohen trajnime për mbikualifikim dhe rikualifikim të ish sportistëve.

Qeveria do të sigurojë kushte adekuate për ruajtjen e edukatës fizike në çdo shkollë fillore dhe të mesme, të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin më të mirë psikofizik të fëmijëve. Gjithashtu, përmes programeve mbështetëse për klubet sportive, do të stimulohen sa më shumë fëmijë që të marrin pjesë aktive në aktivitete sportive profesionale. Për herë të parë, qeveria do të vlerësojë rezultatet e arritura nga nxënësit nga shkollat e sportit në kampionatet ndërkombëtare zyrtare dhe rezultatet e arritura nga studentët e universiteteve sportive në kampionatet ndërkombëtare.

Qeveria do të nisë ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës sportive, e cila do t'ju mundësoje sportistëve të stërviten dhe të garojnë në kushtet më moderne. Qeveria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

- Ndërtimi i Qendrës Nacionale Sportive në Shkup;
- Kompleksi sportiv me shumë qëllime në Manastir;
- kompletimi dhe vënia në punë e pishinës në Ohër;
- rikonstruktuimi i sallave dhe rehabilitimi energjetik efikas i sallave sportive ku luhen sportet më të mira;
- plan infrastrukturor dhe strategji shumëvjeçare për ndërtimin e objekteve sportive në ato qytete ku do të konstatohet mangësi;
- modernizimi i disa stadiumeve të futbollit në të gjithë vendin;
- plani për investime vjetore në fusha sportive nën qiell të hapur; dhe
- shenjimi dhe nënvizimi i shtigjeve malore më të frekuentuara.

Со сеопфатна програма за овозможување максимална достапност на спортот за сите, ќе се постават рампи со цел олеснување на пристапот до спортските објекти за сите лица со попречености, поливалентна сала за лицата со попреченост, како и дополнителна поддршка за оние спортски клубови коишто во својата работа ќе опфатат и лица со попречености.

Me një program gjithëpërfshirës për të mundësuar akses maksimal të sportit për të gjithë, do të vendosen rampa për të lehtësuar aksesin në ambientet sportive për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, një sallë shumëfunktionale për personat me aftësi të kufizuara, si dhe mbështetje shtesë për ato klube sportive që në punën e tyre do të përfshijë edhe personat me aftësi të kufizuara.

VI TË DREJTAT DHE LIRITË

○ MARRËDHËNIET MES BASHKËSIVE ETNIKE

Qeveria do t'i kushtojë vëmendje të veçantë zhvillimit dhe avancimit të marrëdhënieve ndërmjet bashkësive në Maqedoni. Në frymën e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, për të realizuar prioritetet më të larta për të drejtat etnike, kulturore dhe qytetare të përcaktuara në Kushtetutë, do të punojmë në zhvillimin e kohezionit multikulturor dhe do të mbështesim vlerat multikulturore të cilat përfaqësojnë pasurinë shumëngjyrëshe të bashkësive etnike në shtetin maqedonas. Ky do të jetë prioriteti ynë të cilit do t'i

përkushtohemi dhe përmes të cilit do të mundësojmë ballafaqimin me diskriminimin pozitiv i cili do të ofrojë mundësi të barabarta për të gjitha bashkësitë etnike në Maqedoni.

○ GRUAJA NË QENDËR TË SHOQËRISË MAQEDONASE

Barazia e grave dhe burrave është e drejtë themelore e njeriut, element thelbësor i demokracisë dhe një imperativ i drejtësisë sociale. Qeveria do të jetë e fokusuar fuqishëm në forcimin e pozitës së gruas në çdo segment të veprimit shoqëror, si bazë e nevojshme për prosperitet dhe qëndrueshmëri, sepse gra të forta kanë domethënien e shoqërisë së fortë.

Qeveria do të udhëhiqet nga parimi i tolerancës zero për format e ndryshme të dhunës ndaj të cilave gratë ekspozohen. Në këtë drejtim, do të mbështesim në mënyrë aktive masat për mbrojtjen e grave viktimat të dhunës, do të përpiqemi të përmirësojmë qasjen deri te shërbimet e specializuara mbështetëse për të gjitha gratë dhe fëmijët e tyre, për të rritur numrin dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbështetje.

Do të ofrohet mbrojtje shëndetësore efikase dhe preventive për parandalimin e sëmundjeve malinje tek gratë, të drejtat e qasjes në shërbimet e duhura shëndetësore që do t'u mundësojnë grave një shtatzëni dhe lindje të sigurtë, ndërsa çiftëve do t'ju ofrohet mundësia të kenë të porsalindur të shëndetshëm. Në veçanti, ne do të avokojmë për qasje në kujdesin shëndetësor cilësor, veçanërisht për grupet e cënueshme sociale të popullsisë për HIV/SIDA dhe infeksione të tjera seksualisht të transmetueshme, për abort, për infertilitet, për sëmundjet malinje të gjirit dhe mitrës.

Do të hapen dhjetë qendra të reja të kujdesit dhe mbështetjes për gratë viktimat të dhunës me bazë gjinore. Një grup ndërinstytucional i Qeverisë do të punojë për të mbrojtur gratë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje përmes përforsimit të rregullores ligjore, përmes koordinimit më të fortë dhe të rregullt të institucioneve shtetërore dhe lokale dhe organizatave joqeveritare, si dhe përmes zbatimit të qëndrueshëm të marrëveshjeve, konventave dhe rezolutave ndërkombëtare të nënshkruara për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave. Grupi do të punojë për masat për të përfshirë plotësisht në procesin arsimor ato vajza të reja që nuk janë ende pjesë e tij.

Nëpërmjet dialogut social do të bëhen përpjekje për të reduktuar diferencat në paga midis burrave dhe grave, duke vendosur një plan neutral për klasifikimin e profesioneve të dominuara nga femrat.

Institucionet do të zhvillojnë plane dhe programe në kuadër të aktiviteteve të Agjencisë së Punësimit për përfshirje më të madhe të grave nga zonat urbane dhe rurale në tregun e punës, përgatitjen e programeve vjetore për sipërmarrjen femërore dhe rritje të vazhdueshme të buxheteve për këtë qëllim në nivel vjetor.

○ TË RINJT NË FOKUS

Qeveria do të angazhohet fuqishëm për të krijuar një shoqëri në të cilën të rinjtë mund të përparojnë. Qëllimet e Qeverisë janë të krijojë kushtet e nevojshme për të rinjtë nga Maqedonia që të ndërtojnë të ardhmen në shtëpi, t'i forcojë ata përmes edukimit dhe zhvillimit të aftësive, të inkurajojë pjesëmarrjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe të promovojë sipërmarrësinë dhe inovacionin.

Prioritet i Qeverisë së re është që të rinjve në Maqedoni tu ofrojë punë të sigurt dhe të paguara mirë. Duke krijuar klimë më të mirë për biznes, do të krijohen vende pune me vlerë të shtuar më të lartë, të disponueshme për të rinjtë. Për përfshirje më të lehtë të të rinjve në tregun e punës, do të përmirësohen programet arsimore në arsimin e mesëm dhe të lartë, si dhe do të ofrohen trajnime për kualifikim të mëtejshëm dhe përvetësim të aftësive të reja për punësim më të madh të të rinjve përmes programeve të ndryshme të Agjencisë për Punësim.

Në drejtim të nxitjes së punësimit dhe punësimi i të rinjve, parashikohet:

- program për 500 studentë me sukses më të lartë akademik nga studimet deridiplomike në universitetet publike me qëllim që çdo vit t'ju ofrohet punë në sektorin privat dhe publik;
- Ndryshimet ligjore për krijimin e mundësisë që çdo student të punojë me orar të shkurtë pa e humbur statusin e studentit me kohë të plotë;
- deri në 5000 trajnime njëvjeçare për aftësi të avancuara digjitale sipas nevojave të kompanive vendase për TIK;
- bashkëfinancim për certifikim ndërkombëtar të profesionistëve të rinj të TIK-ut me qëllim rritjen e produktivitetit të punëtorëve;
- mjete financiare për nismat për sipërmarrësi të të rinjve si program gjithëpërfshirës për mbështetjen e punësimit të të rinjve;

- Bashkëfinancimi i trajnimeve nëpërmjet sistemit të vauçerëve, në platformat e njohura të edukimit online për studentët e talentuar;
- Institucionet publike do të jenë të hapura për punë vullnetare dhe praktike;
- rritja e mbështetjes financiare fillestare për të rinjtë që do të fillojnë të merren me bujqësi;
- shërbime këshillimore për të rinjtë që do të fillojnë biznes në fushën e legjislacionit, financave dhe taksave, punës administrative, mjeteve të TI-së, marketingut dhe programeve të tjera të përshtatshme mbështetëse gjatë fillimit me bizneset e tyre.

Qeveria do të mbështesë formimin e qendrave të inovacionit digjital, qendrave rinore për inovacion me resurse arsimore dhe teknike dhe hapësirë për punë. Internet falas do të ofrohet në të gjitha konviktet e studentëve, bibliotekat, sallat e leximit, qendrat rinore dhe fakultetet.

Qeveria do të punojë për rinovim të gjithanshëm të të gjitha konvikteve studentore dhe të nxënësve në shtet, gjë që do të mundësojë përmirësimin e kushteve të përgjithshme të qëndrimit, si dhe ngritjen e standardit studentor.

Do të shtohen mjetet e destinuara për bursa për studentët dhe gjimnazistët, ndërsa përmes digjitalizimit të procesit të aplikimit do të bëhet i pamundur korrupsioni. Për profesionet deficitare dhe të paguara në shumë më të lartë do të ofrohen bursa të plota për studim, do të ulet participimi për studim për të gjithë studentët deri në 25 vjeç, që janë prindër; dhe do të ofrohen bursa për studentët që arrijnë rezultate në olimpiadën botërore, ndërkombëtare, gara shtetërore në dije në lëndë të ndryshme.

○ TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA E QEVERISË

Transparenca e Qeverisë do të jetë prioritet kryesor në funksionimin e saj. Roli parandalues i transparencës në punën e institucioneve është një nga mekanizmat për përmirësimin e punës së tyre, si në drejtim të rritjes së efikasitetit të tyre, ashtu edhe në drejtim të zvogëlimit të mundësive për çdo formë abuzimi dhe korrupsioni.

Institucionet qeveritare do t'i bashkohen shërbimit të përbashkët të internetit, për të përmirësuar komunikimin me qytetarët. Do të zhvillohet një standard për minimumin e informacioneve të nevojshme, të cilat çdo institucion shtetëror duhet ta publikojë dhe përditësojë në platformën e internetit. Qëllimi është që qytetarët të mund të marrin të gjitha informacionet për punën e institucioneve në çdo kohë, në mënyrë të thjeshtë.

Numri i të dhënave të hapura në format të përpunueshëm kompjuterik do të rritet. Të dhënat e hapura do të përditësohen rregullisht dhe do të mund lirshëm të përdoren,

ripërdoren dhe rishpërndahen pa kufizime. Do të intensifikohet angazhimi në kuadër të Partneritetit për Qeverisje të Hapur dhe portaleve për publikimin e rregulloreve dhe të dhënave.

Në bashkëpunim me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Entin Shtetëror të Revizionit, duke përdorur praktikën më të mirë evropiane, do të përgatitet analizë e faktorëve të rrezikut për abuzime dhe korrupsion në institucionet shtetërore. Në bazë të kësaj analize do të hartohet një plan për publikimin e informacioneve nga institucionet si parandalim adekuat nga korrupsioni dhe abuzimet.

Përmes ndryshimeve ligjore do të mundësohet qasje e plotë në faqet e internetit të institucioneve shtetërore për personat me aftësi të kufizuara, sipas rekomandimeve të shoqatave për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara.

○ СЛОБОДНИ И НЕЗАВИСНИ МЕДИУМИ

○ MEDIA TË LIRA DHE TË PAVARURA

Qëllimi i Qeverisë është mbrojtja dhe promovimi i diversitetit të shprehjeve kulturore në hapësirën mediatike, përfshirë portalet e internetit, përmes politikave të qarta mediatike të cilat do të ndërtohen, punohen dhe mbështeten nga institucionet adekuate dhe shoqatat e pavarura të mediave, punonjësve të medias dhe gazetarëve. Është e nevojshme të mbështetet sigurimi, qëndrueshmëria e shërbimeve të pavarura dhe profesionale publike mediatike me zhvillim të mëtijshëm të kushteve transparente dhe të barabarta tregtare për të gjithë aktorët privatë dhe publikë.

Qëllimet e Qeverisë në këtë fushë do të jenë:

- Zhvillimi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale;
- Zhvillimi i mediave online;
- Promovimi i lirisë së shprehjes;
- Zhvillimi i shkrim-leximit mediatik;
- Zhvillimi i pavarur audio, vizual dhe internet produksionit;
- Inkurajimi, promovimi dhe mbrojtja e identitetit kulturor, gjuhës dhe traditës së popullit maqedonas dhe komuniteteve në Republikën e Maqedonisë, respektimi i dallimeve kulturore dhe fetare, nxitja e kulturës së dialogut publik ndërmjet qytetarëve me qëllim të përforcimit mirëkuptimi dhe toleranca për avancimin e marrëdhënieve mes komuniteteve të ndryshme;
- Nxitja e krijimtarisë, zhvillimit arsimor dhe shkencor;

- Mbrojtja e interesave të përdoruesve, veçanërisht të miturve;
- Zhvillimi tekniko-teknologjik i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizive, mediave onlajn, konvergjenca me shërbimet e komunikimeve elektronike dhe të shoqërisë së informacionit;
- Lufta efikase kundër dezinformatave dhe lajmeve të rreme në media dhe në hapësirën e internetit.

Duke pasur parasysh se nevojitet reformë e mëtejshme e shërbimit të transmetimit publik për të vazhduar forcimi i pavarësisë së tij, standardeve profesionale dhe qëndrueshmërisë financiare, Qeveria do të mbështesë diskutim gjithëpërfshirës në drejtim të kësaj reforme.

Do të mbështesim futjen e mekanizmave efektive vetërregullues dhe bashkërregullues, të kombinuara me vendosjen e analizave të rregullta të pluralizmit mediatik. Do të hapim debat me të gjitha palët e interesuara për ndryshimet në dispozitat ligjore për të garantuar konkurrencë, qëndrueshmëri dhe pluralizëm në tregun mediatik, përmirësimin e statusit social dhe ekonomik të gazetarëve, siguri juridike, barazi dhe mosdiskriminim, promovim i pluralizmit mediatik dhe qëndrueshmëria e mediave, nxitje e zhvillimit të tyre dhe harmonizimi i suazës ligjore për shërbimin publik të transmetimit me standardet evropiane.

○ ПОДДРШКА НА ГРАЃАНСКИОТ СЕКТОР

○ MBËSHTETJE PËR SEKTORIN CIVIL

Për një shoqëri dinamike dhe gjithëpërfshirëse që do të paraqet reflektim i nevojave dhe interesave qytetare, është e nevojshme ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve dhe ngritja profesionale e organizatave joqeveritare. Liria dhe pavarësia në veprimin e tyre duhet të jetë një imperativ kryesor, sepse në këtë mënyrë organizatat e shoqërisë civile do të mund të zënë vendin e tyre të merituar në shoqëri.

Qeveria do të ndërtojë marrëdhëniet me organizatat e shoqërisë civile bazuar në parimet e mëposhtme:

- Gjithëpërfshirja dhe planifikimi me pjesëmarrje - sektori civil do të konsultohet dhe përfshihet në krijimin e politikave për zhvillimin e shtetit;
- Siguria dhe përgjegjësia - siguria juridike dhe reforma e ligjeve që kanë të bëjnë me organizatat e shoqërisë civile;
- Çiltërsia dhe transparenca - çiltërsia dhe transparenca janë instrumente të nevojshme për ndërtimin e barazisë para ligjit dhe përgjegjësisë së vendimmarrësve.

Vizioni ynë është të mbështesim sektor civil gjithëpërfshirës, të pavarur dhe profesional, i cili është partner i institucioneve në krijimin dhe realizimin e synimeve strategjike të shtetit.

Qeveria do të sigurojë mjete nga buxheti për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile me qëllim të zhvillimit cilësor të shoqërisë civile. Qëllimi i fondit të garancisë do të jetë mbështetja financiare për organizatat e shoqërisë civile që aplikojnë dhe fitojnë projekte nga fondet evropiane dhe të tjera, siç janë fondet IPA, Horizont Evropë, Kllajmet Kik, InvestEU, Digital Evropa dhe të tjera, për të cilat nevojitet përqindje e pjesëmarrjes, të bashkëfinancimit.

Nëpërmjet futjes së mjeteve digjitale në punën dhe bashkëpunimin me sektorin e OJQ-ve, do të funksionojë portali i bashkëpunimit me shoqërinë civile, i cili do të shërbejë si qendër e resurseve onlajn. Do të zbatohet reformë gjithëpërfshirëse e sistemit të sponsorizimit të organizatave që kryejnë veprimtari publike, që do të nënkuptojë organizata civile të përforcuara, por edhe mekanizma konsistent, të hapur dhe transparent për dhënien e donacioneve dhe sponsorizimeve.

Qeveria do të punojë në zhvillimin e sipërmarrjes sociale që kontribuon në kohezionin social, zhvillimin rajonal dhe rural, mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konsumatorëve, bujqësinë dhe sigurinë sociale.

Qeveria do të organizojë konferencë vjetore të organizatave të shoqërisë civile, me qëllim prezantimin e punës së organizatave të shoqërisë civile, si dhe aktivitetet e ndërsjella dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare në formë të panairit civil.